



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**INSTITUCIONIN AVOKATURA E SHTETIT**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

(Auditim Përputhshmërie)

**AVOKATURA E SHTETIT**

**Tiranë, shtator 2023**

## Përmbajtja

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	3
1.	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-9
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	9-10
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	11
1.	Objekti i auditimit	11
2.	Qëllimi i auditimit	11
3.	Identifikimi i çështjes	11
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12
5.	Përgjegjësitë e audituesve	12
6.	Kriteret e vlerësimit	12-13
7.	Standardet e auditimit	13
8.	Metodat e auditimit	13
9.	Dokumentimi i auditimit	13-14
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	14
<b>1.</b>	<b>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin</b>	14
<b>2.</b>	<b>Përshkrimi i auditimit sipas drejtiveve të auditimit</b>	23
2.1	Mbi çështjet e shqyrtuara në Arbitrazhin Ndërkombëtar	14-28
2.2	Mbi çështjet e shqyrtuara në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut	28-66
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET</b>	66-73

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Avokaturën e Shtetit, më poshtë e emërtuar “ASH”, për periudhën nga data 01.01.2021 deri në 31.12.2022 me objekt “Auditim Përputhshmërie”. Auditimi sipas programit të miratuar kishte në fokus stokun e detyrimeve dhe rakordimi i detyrimeve të prapambetura gjendje në 31.12.2022. Detyrimet sipas vendimeve të Gjykatave Ndërkombëtare, në të u angazhuan 2 (dy) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), u konstatuan anomali që lidhen kryesisht me detyrimet që institucioni ka në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave ndërkombëtare dhe të huaja por u cek edhe sa i përket mirëmenaxhimit të veprimtarisë së tij.

Si problematika të evidentuara mund të citojmë mosgarantimin e zbatimit të vendimeve të Gykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) brenda afateve përkatëse dhe në vlerën e përcaktuar të tyre, mungesa e ngritjes së Këshillit Konsultativ, mungesa e ndërveprimit të mirë ndërinstitucional me qëllim mirëmenaxhimit e parasë publike, si dhe mungesën e një analize paraparake përpara nisjes së këtyre procedurave etj.

### 1.2 Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REF. ME RAPORTIN PËRFUND	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi ka rezultuar se, për proceset gjyqësore të përfunduara në GJEDNJ dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar, nga të cilat kanë rezultuar detyrime e pagesa të fondeve të buxhetit të shtetit, si dhe në disa raste penalitete për mos likuidimin e detyrimeve në afatet e parashikuara, ka munguar një analizë e çështjeve gjyqësore të humbura nga ana e institucioneve shtetërore pjesë e këtyre proceseve dhe Avokatura e Shtetit. Për pasojë, në asnjë rast nuk konstatohet adresim i problematikave të rezultuara prej tyre, mungon analiza e thelluar e shkaqeve dhe e masave që duhet të ndërmerren ndaj shkaktarëve, apo sugjerime/propozime për Këshillin e Ministrave mbi hapat e nevojshëm me qëllim kryerjen me korrektesi të procedurave të përfaqësimit ligjor dhe shmangies, për aq sa është e mundur, e ngarkimit të kostove abuzive shtesë për financat publike, të cilat impaktojnë buxhetin e shtetit gjatë periudhave të ardhshme.	62 - 66	E lartë	Nga ana e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit dhe institucioneve shtetërore përgjegjëse, (pjesë në proceset e ngritura pranë gjykatave ndërkombëtare dhe të huaja), të merren masat për: <ul style="list-style-type: none"><li>• Koordinimin, bashkërendimin e punës dhe mbikëqyrjen dhe kryerjen e një analize të thelluar të çështjeve gjyqësore të humbura nga ana e institucioneve shtetërore, për të identifikuar shkaqet që kanë sjellë për pasojë humbjen e tyre dhe dëmtimin e interesave shtetërore;</li><li>• programimin në këtë kuadër të masave që duhet të ndërmerren ndaj shkaktarëve, si dhe hartimin e propozimeve për Këshillin e Ministrave për ndërmarrjen e nismave ligjore për plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi, apo</li><li>• hapat e nevojshëm që duhen ndërmarrë me qëllim mbrojtjen interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave</li></ul>

				ndërkombëtare dhe të huaja, dhe evitimin e veprimeve të pakoordinuara dhe/ose kostot abuzive shtesë, që impaktojnë financat publike në të ardhmen.
2	<p>Nga auditimi rezulton se, për periudhën 2021-2022, mungon gjurma e rikrijimit dhe e funksionimit të Këshillit Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së.</p> <p>Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së evidentohet të ketë ushtruar veprimtarinë e tij deri në shkurt të vitit 2021, ndonëse ai ka si funksion orientimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë me Avokaturën e Shtetit mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), përcaktimin e planit të punës/veprimit me afate konkrete për realizimin e detyrave në kuadër të ekzekutimit të vendimeve, apo paraqitjes së rekomandimeve/zgjidhjeve të mundshme, në kuadër të këtij plani, etj. Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e nenit 19/8, “Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së”, Kreu V/I, i Ligjit nr.10018, datë 13.11.2018 “Për avokaturën e shtetit, i ndryshuar me ligjin Nr. 86/2018.</p>	51 - 53	E lartë	<p>Për shkak të rolit që ka Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së, si dhe faktit që domosdoshmëria e funksionimit të tij është përcaktuar në kuadrin ligjor përkatës, (neni 19/8, i Ligjit nr.10018, datë 13.11.2018, i ndryshuar), kërkohet që, të merren masat nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, që, pas një procesi transparent të përzgjedhjes së kandidatave për në Këshillin Konsultativ, të dërgohen propozimet e tij pranë Kryeministrit të Shqipërisë, me qëllim kompozimin e këtij organi dhe përmbushjen e funksioneve dhe qëllimit të parashikuar nga ligjvënësi.</p>
3	<p>Sa i takon dokumentimit dhe regjistrimit fizik të çështjeve gjyqësore, si dhe informacionit mbi ndjekjen e tyre, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Sa i takon regjistrin të GJEDNJ-së ky regjistër ka filluar të plotësohet fizikisht nga viti 2022 dhe nuk ka një databazë zyrtare të çështjeve të trajtuara në GJEDNJ. Nga auditimi i formatit fizik të tij, u konstatua se regjistri në trajtën e një dokumenti zyrtar përmban korrektive, (specifikisht në çështjen nr.4, në pretendim dhe objekt).</li> <li>✓ Sa i takon regjistrin të Arbitrazhit Ndërkombëtar ky regjistër ka filluar të plotësohet fizikisht nga viti 2022 dhe mungon një databazë zyrtare të çështjeve të trajtuara në Arbitrazhin Ndërkombëtar, nuk ka gjurmë mbi të dhënat dhe vlerat reale (totale) të efekteve financiare për të gjitha çështjet që kanë përfunduar shqyrtimin e Arbitrazhit Ndërkombëtar dhe ato që janë ende në proces shqyrtimi.</li> </ul>	19 - 24	E mesme	<p>Institucioni i Avokaturës së Shtetit të marrë masat për miratimin dhe mbajtjen e Regjistrin Modelar (në formë fizike) si një dokument zyrtar me rëndësi të veçantë në garantimin e vijueshmërisë së ndjekjes së çështjeve dhe përfaqësimit por dhe garantimin e një gjurme auditimi sipas kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm,. Këto regjistra duhet të përshtaten dhe modifikohen sipas kërkesave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr.10018, datë 13.11.2018 i ndryshuar, si dhe përcaktimet e Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” i ndryshuar dhe normat tekniko profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, për shkak të rëndësisë që ka ky dokument administrativ për këtë institucion shtetëror.</p>
4	<p>-Në lidhje me 4 (katër) çështjet në proces gjyqësor në Arbitrazhin Ndërkombëtar, nga auditimi rezulton se, janë 3 (tre) padi të nisura për 2021 dhe 1 (një) e nisur në vitin 2022 të cilat vijojnë të kenë këtë status. Efektet potenciale të tyre rezultojnë të jenë, 3 (tre) me dëm të mundshëm për buxhetin e shtetit në vlerën 160,224,810 EURO, dhe 2,788,933 lekë, si dhe 1 (një) me të ardhura të mundshme potenciale të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 2,405,682.4 EURO dhe 14,630,050,747</p>	24 - 25	E lartë	<p>Avokati i Përgjithshëm i Shtetit të koordinojë veprimet me drejtuesit e institucioneve shtetërore- palë në proceset gjyqësore, për mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave ndërkombëtare dhe të huaja, ndjekjen e procedurës së ekzekutimit për njohjen e vendimit në Gjykatën e Apelit Vendas, në mënyrë të tillë të</p>

	<p>lekë. (Më hollësisht trajtuar në faqe 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)</p> <p>-Në lidhje me 2 (dy) çështjet e përfunduara në Arbitrazhin Ndërkombëtar me një vendim, ku kanë lindur detyrime dhe të drejta për institucionet e shtetit shqiptar, por nuk kanë vijuar kërkesat për njohje vendimi në Gjykatën e Apelit Vendas, rezultoi përkatësisht:</p> <p>Në 1 (një) rast me efektin e dëmit të mundshëm për buxhetin e shtetit (ku palë e paditur është “A.R.Sh” me një detyrim të shtetit shqiptar sipas Tribunalit të Arbitrazhit në vlerën 44,262,681.77 USD dhe 573,081,13 Euro, si dhe</p> <p>Në 1 (një) rast me efektin e të ardhurave të munguara për buxhetin e shtetit (ku palë e paditur është “M.T.M” me një detyrim të palëve të treta sipas Tribunalit të Arbitrazhit kundrejt Republikës së Shqipërisë në vlerën 2,407,000 Euro, 427,488.72 USD dhe 106,755 £.</p>			<p>përfitohet në kohë vlera e të ardhurave të përcaktuara në vendimin e Tribunalit të Arbitrazhit, si dhe të tregohet kujdesi i duhur për minimizimin e efekteve negative në buxhet që shkaktohen prej interesave nga penalitetet e mos përmbushjes së afateve të ekzekutimit të këtyre vendimeve.</p>
5	<p>Nga auditimi rezultoi se, nga ana e institucioneve shqiptare pjesë e procesit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), nuk rezulton të kenë gjetur zbatim afatet 3 (tre) mujore për zbatimin e këtyre Vendimeve, sipas parashikimeve të dispozitivit të këtyre vendimeve si dhe të nenin 19/4, të Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, që shpreh se “Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë”.</p> <p>Në total gjatë periudhës nën auditim, (vitet 2021-2022), evidentohen 5 (pesë) vendime të pa ekzekutuara me një vlerë financiare (vetëm principal) prej 17.911.600 Euro, pa përfshirë këtu interesat e pagueshëm në rast vonesash, referuar pikës 3, të nenit 19/5 në ligjin e sipërcituar. Vlera e referuar më lartë mund të rritet për shkak të penaliteteve si rrjedhojë e vonesave dhe mosrespektimit të afateve të ekzekutimit të vendimit.</p> <p>(Referuar likuidimit të dy çështjeve përgjatë vitit 2023, kosto aktuale potenciale, e vitit 2023, që ekspozohet buxheti shtetit nga moszbatimi i 3 (tre) prej vendimeve të GJEDNJ-së rezulton të jetë 17,880,650 Euro e cila do të vijojë të rritet edhe më për shkak të penaliteteve të shtuara si rrjedhojë e vonesave).</p> <p>Vendimet e pazbatuara datojnë që prej vitit 2015 deri në vitin 2021, dy prej tyre përbëjnë dhe peshën kryesore të vlerës financiare për tu përballuar nga buxheti i shtetit, përkatësisht:</p> <p>Peshën më të lartë e mban çështja “Sh. k. Sh.”, mbartur prej vitit 2018, (me 75% të totalit të vlerës), e cila vijon të jetë në</p>	49 - 53	E lartë	<p>- Avokatura e Shtetit, edhe në rolin e njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së si dhe rolin e përfaqësuesit përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës lidhur me ekzekutimin e këtyre lloj vendimeve, të informojë Këshillin e Ministrave për vendimet ende të pa ekzekutuara si dhe të intensifikojë marrëdhënien me MEF-në për sa i takon vlerës së interesave financiare që vjen për moszbatim të afatit të likuidimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë që ekspozojnë buxhetin e shtetit në vlera të konsiderueshme.</p> <p>- Për shkak të impaktit të lartë të çështjes, (pasi preket buxheti i shtetit), me qëllim ndërtimin dhe funksionimin e një sistemi proaktiv të menaxhimit financiar dhe nga ana tjetër mirë menaxhimin me sa më efektivitet të parasë publike, ASH të ndjekë procesin nëpër të gjitha hallkat me qëllim finalizimin me sukses të tij, duke evidentuar shkeljet dhe mosveprimet e institucioneve respektive vendase, të cilat duhen adresuar me qëllim nxjerrjen e përgjegjësisive përkatëse.</p> <p><i>Në këtë kuadër, ASH të koordinojë veprimet me institucionet e mëposhtme për sa vijon:</i></p> <p>✓ Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ndërmarrë në mënyrë urgjente masa për programimin dhe shlyerjen e vlerave të detyrimeve që</p>

	<p>proces për shkak të mungesës së fondeve të buxhetit të shtetit, ku vetëm vlera e shpërblimit të drejtë të akorduar rezulton të jetë 13,447,300 Euro, vlerë e cila pritet të shtohet për shkak të interesave.</p> <p>Çështja “D. k. Sh.” mbartur prej vitit 2015, vijon në proces pretje të miratimit të VKM-së ku vetëm vlera e shpërblimit të drejtë të akorduar rezulton të jetë 15.600 Euro, vlerë e cila pritet të shtohet për shkak të interesave.</p> <p>Mosekzekutimi në afat i këtyre detyrimeve krijon risk për aplikim interesash të pagueshme në vlera të konsiderueshme.</p> <p>Mosveprimi ose veprimet me vonesë nga ana e institucioneve respektive në këtë çështje krijojnë risk të lartë për efekte të tjera shtesë në dëm të buxhetit të shtetit, gjë që kërkon vëmendje të shtuar në vijim nga ana e ASH-së si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre vendimeve, por veçanërisht nga MFE e cila vijon në mospërputhje me qëndrimet ligjore të njësive të specializuara, siç është Avokatura e Shtetit.</p>			<p>mbarten prej vitit 2015 e 2018, dhe që zënë peshë të lartë në këto detyrime, qoftë edhe përmes shlyerjeve pjesore të tyre.</p> <p>✓ Kryeministria në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave të marrin masa urgjente për nxjerrjen e VKM me qëllim shlyerjen e vlerës së detyrimeve të mbartura prej vitit 2015, me qëllim frenimin e pagesës së mëtejshme të interesave nga buxheti i shtetit.</p>
6	<p>Nga auditimi i dosjeve fizike të vendimeve të GJEDNJ-së u konstatua se, në tërësi këto dosje mbartnin parregullsi në mënyrën e mbajtjes së tyre, mungonte fleta e inventarit për çdo dosje respektive, e për pasojë nuk është bërë numërimi i fletëve dhe inventarizimi/numërimi total i tyre, sipas ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, Normat Tekniko-Ligjore dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor, neni 30 “Inventari i brendshëm i dosjes” që për shkak të sensitivitetit të informacionit, gjykohet si risk i shtuar dhe duhet vlerësuar nga ASH.</p>	35 - 40	E lartë	<p>Avokatura e Shtetit të marrë masa, për inventarizimin e dosjeve për të gjitha vendimet e GJEDNJ-së dhe të mbajë në konsideratë që ruajtja dhe dokumentimi i tyre duhet ti nënshtrohet kërkesave të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Normave Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.</p>
7	<p>Procesi i arbitrazhit, i regjistruar me nr. “ICSID ARB/14/26” ka përfunduar me Vendimin e Tribunalit të datës 3 mars 2020, i cili i ka dhënë të drejtë pretendimeve të RSH dhe ka rrëzuar të gjitha kërkesat e paditësve. Kjo çështje ka përfunduar në Arbitrazh Ndërkombëtar me vendim, por nuk ka ende asnjë kërkesë për njohje vendimi në Gjykatën e Apelit Vendas. Detyrimi i vendosur nga Tribunali i Arbitrazhit është në vlerën e 2,407,000 Euro; 427,488.72 USD dhe 106,755 £.</p> <p>Dispozitivi ka përcaktuar njohjen e llogaritjeve si penalitet, nëse do të ketë vonesa në pagimin e këtyre kostove dhe interesi do të shtohet mbi shumat që mbeten të papaguara në normën prej 2% të interesit të përbërë, derisa të paguhen kostot, duke filluar nga dita e 28-të e dorëzimit të vendimit.</p> <p>Si pasojë e mosveprimit në kohë nga autoritetet shtetërore si palë të interesuara, për njohje të vendimit nga Gjykata e Apelit, nuk janë arkëtuar për llogari të buxhetit të shtetit shumat prej 2,407,000 Euro; 427,488.72 USD dhe 106,755 £.</p>	39 - 43	E lartë	<p><i>Në këtë kuadër, ASH të koordinojë veprimet me institucionet e mëposhtme për sa vijon:</i></p> <p>- M. T. dhe M. të marrë masa të menjëhershme si palë në proces për ndjekjen e procedurës së ekzekutimit për njohjen e vendimit në Gjykatën e Apelit Vendas, në mënyrë të tillë të përfitojë në kohë vlerën e të ardhurave të përcaktuar në vendimin e Tribunalit të Arbitrazhit.</p>
8	<p>Në lidhje me çështjen e iniciuar në vitin 2017, me nr.22676/ dhe palë të paditur M., A. dhe A. sha, vendimi i arbitrazhit është lëshuar më datë 06.07.2020 dhe i është</p>	62 -66	E mesme	<p><i>Në këtë kuadër, ASH të koordinojë veprimet me institucionet e mëposhtme për sa vijon:</i></p>

	<p>përcjellë M. dhe A. me shkresën nr. 1526/3 prot., datë 29.07.2020 të Avokaturës së Shtetit. Avokatura e Shtetit përmes shkresës nr. 2886/1 Prot., datë 07.06.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është njohur me vendimmarrjen e kësaj gjykate e cila me vendimin nr.49, datë 04.05.2021 ka vendosur të pranojë kërkesën e Shoqërisë "G. C. O. C" për njohjen dhe dhënien fuqi juridike të vendimit të arbitrazhit. Avokatura e Shtetit ka informuar MIE me shkresën nr. 1526/23 prot., datë 07.07.2021 dhe Avokatura e Shtetit ka paraqitur në Gjykatë të Lartë Rekursin ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.49, datë 04.05.2021 në dispozitivin e tij urdhëron që M. dhe A. duhet ti paguajë paditësit 12,557,852 USD si dëmshpërblim për shkeljen e detyrimeve, po ashtu urdhëron që të paditurit të paguajnë shumat prej 292,760 USD dhe 14,451.68 EURO, me interes me normën 5% që nga data e këtij vendimi deri sa të bëhët pagesa e plotë. Totali i interesave të pagueshme deri në 31.12.2022 sipas përlloraritjeve të grupit të auditimit rezulton të jenë 1,042,411 USD; 24,263 USD; 1,198 Euro, që i shtohen vlerës së principalit të vendosur në vendimin e arbitrazhit.</p>			<p>MIE, AKBN dhe A. sha të vlerësojnë dhe marrin masat për provigjonimin e shumave sipas vendimit të Gjykatës së Apelit, dhe planifikimin e fondeve në PBA dhe Buxhetin Vjetor për likuidim e tyre, në mënyrë të tillë që të shmangët rritja e interesave sipas vendimit të arbitrazhit.</p>
9	<p>Nga auditimi u konstatua se, pranë GJEDNJ-së janë edhe 30 çështje me statusin "Kërkesa në shqyrtim, por pa vendim", ku praktika më e hershme daton prej vitit 2011, për të cilat Gjykata nuk është shprehur ende. Vlera ekonomike sipas pretendimit të palëve paditëse rezulton të jetë rreth 151,914,617 Euro dhe 115,300,417 ALL, por këto vlera mund të jenë të ndryshueshme në varësi të ecurisë së çështjes në gjykim, rast pas rasti.</p>	56 - 60	E lartë	<p>Avokatura e Shtetit, në rolin e njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së si dhe rolin e përfaqësuesit përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës të marrë masat në vijim, që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Të intensifikohen veprimet me zyrat e avokatëve dhe të përfaqësive të saj, me qëllim fitimin e çështjeve dhe mbrojtjen e interesave pasurorë të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë publikë.</li> <li>✓ Të informojë Këshillin e Ministrave për ecurinë e çështjeve si dhe të intensifikojë marrëdhënien me MEF për sa i takon provigjonimit të vlerave që ekspozojnë buxhetin e shtetit.</li> </ul>
10	<p>Nga auditimi i praktikave lidhur me ato çështje ku në vendimet e formës së prerë të nxjerrë nga GJEDNJ është akorduar shpërblim i drejtë me vlerë principal mbi vlerën 10,000 (dhjetë mijë) Euro, e rrjedhimisht pagesa e të cilave ekzekutohet përmes nxjerrjes së një VKM përkatëse pas njoftimit nga ana e Avokaturës së Shtetit, rezultoi se, për 5 nga 6 çështjet e trajtuara, këto ekzekutime janë kryer me vonesë dhe impakti financiar në trajtën e interesave të shkaktuara nga vonesat ka qenë rreth 148,731 lekë, respektivisht: 5 prej tyre për shkak se VKM respektive kanë dalë përtej afatit të cituar në vendimin</p>	59 - 62	E lartë	<p>Këshilli Ministrave, Ministria për Financat dhe Ekonominë si dhe institucionet e tjera bashkëpunuese me Avokaturën e Shtetit, të marrin masa për njohje dhe zbatim të Vendimeve të nxjerra nga gjykatat e huaja, konkretisht nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut brenda afateve kohore të shprehura në këto vendime, në mënyrë që të shmangët rëndimi i buxhetit të shtetit me kosto të tepërta.</p>

	e formës së prerë si datë finale për t'u ekzekutuar vlera financiare, megjithëse nga ana e ASH shkresat janë nisur në përputhje të afateve kohore të caktuara) dhe 1 rast vonesa është shkaktuar si rrjedhojë e MFE-së, ngaqë ekzekutimi i vlerës ka ndodhur me vonesë.			
11	Nga auditimi i praktikave ku vlera e detyrimit financiar të vendosur në trajtën e shpërblimit të drejtë me vendim të GJEDNJ-së ishte deri 10 (dhjetë) mijë Euro, pagesa e të cilave ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ministria përgjegjëse për financat (MFE) pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit, u konstatuan 2 (dy) raste të ekzekutimit të vlerave me penalitet, sipas nenit 19/5 "Pagesa e dëmeve/kompensimeve", pika 2 të ligjit nr.10018, datë 13.11.2018, i ndryshuar.	62 - 63	E mesme	Avokatura e Shtetit, të koordinojë punë me institucionet e shtetit pavarësisht në përbushje të detyrave funksionale, me qëllim menaxhimin sa më me efektivitet të fondeve publike, duke ndjekur në vijimësi procesin e finalizimit të likuidimit të vendimeve gjyqësore nga Gjykatat Ndërkombëtare e të huaja me qëllim realizimin në kohë të shpërblimit të drejtë dhënë në vendimet e GJEDNJ-së.
12	a. Nga auditimi i ekzekutimit dhe shlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga Arbitrazhi Ndërkombëtar rezulton se, sipas Raportit Vjetor për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2022, të hartuar nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, (fq.61): • Qeveria ka regjistruar totalin e detyrimit fillestar më 1.1.2022 për 12 institucione shpenzuese, në vlerën 192.6 milionë Euro; Detyrimet e faturuara janë për 62,6 milionë Euro; Likuiduar gjithsej 18,2 milionë Euro, (nga e cila, pjesa e likuiduar gjatë vitit 2022 është vetëm 7,9 milionë Euro); Detyrimi i mbetur 63 milionë Euro; Detyrimet kontigjente janë vendosur për 111 milionë Euro, duke arritur në totalin e detyrimit të mbetur dhe kontigjent (së bashku) për 174 milionë Euro, gjë që tregon për një nivel shumë të lartë të këtyre detyrimeve me impakt ndaj buxhetit të shtetit. Nga ana e MFE në këtë raport është vendosur shënimi se, "informacioni bazohet në të dhënat më të fundit që janë të muajit maj 2023, të raportuara nga Avokatura e Shtetit dhe Ministrinë e Linjës/institucionet buxhetore. Për pasojë, vlerësimet tona janë të sakta për aq sa informacion disponojmë. Tagrin për validimin e tyre e ka vetëm Avokatura e Shtetit". • Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave për totalin e detyrimit të mbetur/faktik dhe kontigjent për vendimet e Tribunalit të Arbitrazhit, sipas Raportit të Mesvitet të Buxhetit, ato evidentohen për 161,938,494 EURO, ndërsa më datën 31.12.2022 për 173,914,609 EURO, ose me një rritje prej 11.976.115 EURO. • Në vlerësimin e grupit të auditimit të KLSH-së, në përlllogaritjen e kontigjencave nuk janë përfshirë interesat e pagueshme në vlera të konsiderueshme pas njohjes së vendimit nga Gjykata e Apelit, por që rezultojnë të jenë pjesë e stokut të detyrimeve të papaguara në ngarkim të buxhetit të shtetit.	26 - 29	E lartë	Nga ana e institucioneve përgjegjëse, Avokatura e Shtetit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë të merren masa për rakordim me saktësi të vlerave faktike të detyrimeve në mbyllje të çdo viti kalendarik përsa u takojnë vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar dhe GJEDNJ-së.



	<p>b. Nga auditimi u konstatua se, mes të dhënave të vendosura në dispozicion nga Avokatura e Shtetit dhe atyre të pasqyruara në raportin vjetor mbi zbatimin e buxhetit të shtetit, publikuar nga MFE për vitin 2022 rezultojnë mospërputhje në totalin e vlerës së detyrimit faktik më 31.12.2022 nga vendimet e GJEDNJ-së (për 30,950 EURO). Më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• “Detyrimet faktike nga vendimet e GJEDNJ-së (në EURO)” sipas ASH rezultojnë për 17,911,600 Euro, ndërkohë në raportin e MFE-së (raporti zbatimit të buxhetit të shtetit 2022, fq. 59), janë evidentuar për 17,880,650 Euro, me një diferencë prej 30,950 Euro, (si rrjedhojë e mos pasqyrimin në raportin e MFE-së të dy vendimeve, konkretisht “P. k. Sh.” me vlerë 13,450 Euro dhe “S. k. Sh.” me vlerë 17,500 Euro, të cilat janë likuiduar më datën 26.1.2023 dhe nga MFE janë konsideruara të likuiduara gjatë v.2022).</li> <li>• Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave për totalin e detyrimit të mbetur/faktik dhe kontigjent për vendimet e GJEDNJ, sipas Raportit të Mesvitet të Buxhetit të MFE, ato evidentohen për 21,796,565 EURO, ndërsa me 31.12.2022 për 21,717,665 EURO, ose me një pakësim prej vetëm 78.900 EURO.</li> </ul>			
--	--	--	--	--

### 1.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

#### **Opinion mbi përputhshmërinë (Opinion i pakualifikuar)<sup>1</sup>**

Në përputhje me programin e auditimit, grupi i auditimit ka audituar përputhshmërinë mbi zbatimin e dispozitave ligjore përsa i takon detyrimeve shtetërore për vendime të formës së prerë të GJEDNJ-së dhe Arbitrazhit dhe vlerat e ekspozimit të buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi, për të vlerësuar nëse çdo aspekt material, është në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin mbi të cilën ushtron veprimtarinë ASH, të përshkruar në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit, ku është siguruar evidencë e mjaftueshme dhe e plotë.

Audituesit nën gjykimin profesional e të pavarur japin një opinion të pa kualifikuar, ku nuk rezultojnë devijime materiale të përhapura. Gjithashtu ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e Opinioneve të pakualifikuar.

#### **Baza për opinion mbi përputhshmërinë**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-t). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e raportit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 130- Kodi Etik, të cilat janë

<sup>1</sup> - Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 245, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit të përputhshmërisë”, të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.102), Kapitulli VII, pika 7.3.3: “Opinion i pa modifikuar/ i pa kualifikuar : Kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mospërputhjeve materiale në një angazhim të siguri së arsyeshme, audituesi shpreh opinion të pamodifikuar ose të pakualifikuar që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme.”

përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë” si dhe në mbështetje të Kodit të Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 27, datë 20.04.2018. Dokumentacioni administrativ, procedurat prokuruese, janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të vendimmarrjes nga Avokatura e Shtetit, me kriteret e parashikuara.

Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, përfshirë marrjen në konsideratë të risqeve të mospërputhshmërisë materiale të transaksioneve me kriteret e parashikuara.

**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:**

Drejtimi i Avokaturës së Shtetit është përgjegjës për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara.

Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi.

**Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:**

Përgjegjësia jonë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të ASH-së, përsa i takon detyrimeve shtetërore për vendime të formës së prerë të GJEDNJ-së dhe Arbitrazhit dhe vlerat e ekspozimit të buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 384/1 prot., datë 08.05.2023, nga data 02.05.2023-23.06.2023 për periudhën nga 01.01.2021 deri më 31.12.2022, u krye auditimi i përputhshmërisë financiare në Avokaturën e Shtetit, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. Znj. A. K., (përgjegjës grupi)
2. Znj. A. H., auditues

### **A. Objektivat e auditimit:**

Objekti i këtij auditimi është marrja e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga Avokatura e Shtetit, gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Vlerësimi i saktësisë së informacioneve në aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator, nëse janë zbatuar parimet e profesionalizimit, të efijencës dhe sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

### **B. Qëllimi i auditimit:**

Qëllim i auditimit tonë është dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional, e të pavarur mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar i ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë Avokatura e Shtetit. Hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Vlerësimin e përputhshmërisë së veprimeve procedurale dhe administrative, të kryera më kriteret dhe kërkesat e legjislacionit. Evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efijencë, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vijim. Raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin apo lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

### **C. Identifikimi i çështjes:**

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit, për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, në përputhje me aktet ligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni e konkretisht: Ecuria e detyrimeve shtetërore për Vendime të formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi. (Stoku i detyrimeve dhe rakordimi i detyrimeve të prapambetura, gjendje në datën 31.12.2022. Detyrimet sipas vendimeve të Gjykatave Ndërkombëtare).

Nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka një rëndësi të veçantë, për shkak të ndikimit në publik mbi transparencën dhe efektivitetin në përdorimin e fondeve publike dhe për shkak të rëndësisë së veçantë që ky institucion disponon.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit 384/1 datë 08.05.2023.

**D. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:**

Avokatura e Shtetit (ASH) përfaqëson dhe mbron interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë.

Avokatura e Shtetit (ASH) është institucion qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike. Asistenca juridike përfshin shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit dhe jepet ekskluzivisht nga avokatët e shtetit për personat juridik të mëposhtëm: a) institucionet shtetërore; b) entet publike; c) shoqëritë e krijuara ose që veprojnë sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ku aksioneri shtetëror ka të drejtë të emërojë shumicën e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë ose zotëron më shumë se gjysmën e aksioneve apo kuotave. Personi juridik bashkëpunon me Avokatin e Shtetit dhe merr pjesë në procesin gjyqësor, në të cilin është palë ndërgjyqëse. Personi juridik vë në dispozicion të avokatit të shtetit çdo informacion të dhënë, apo dokumentacion që disponon, si dhe qëndrimin e tij me shkrim mbi çështjen në gjykim. Avokati i Shtetit, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të personit juridik, vendos lidhur me qëndrimin dhe mbrojtjen e çështjes, si dhe bën përfaqësimin në gjykim. Është detyrim i menaxherëve të njëjësive që, në kryerjen e veprimtarive të respektojnë parimet e profesionalizmit, të efikasitetit, të konfidencialitetit, të përgjegjshmërisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësitë sipas përcaktimeve në Ligjin nr.10018, datë 13.11.2018, i ndryshuar.

**E. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:**

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vendosjen në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

**F. Kriteret e vlerësimit:**

Kriteret e vlerësimit do të bëhen në bazë të procedurave të përcaktuara nga Ministria e Financave në funksion të vetëvlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar nga Ministri i Financave.

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

- Ligji nr.154/2014 “ Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Ligji nr.10018 datë 13.11.2018 “ Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.
- Ligji nr.9000/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore”.
- Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Kodi Procedurës Civile, miratuar me ligjin nr.8431, datë 14.12.1998 i ndryshuar.
- Konventa e New York-ut.
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- VKM nr.392, datë 08.04.2009 “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me Institucionet Shtetërore dhe Entet Publike, Rolin e Avokatëve të Shtetit në gjykim, si dhe Normat e Posaçme Procedurale”.
- Rregullore e Brendshme për Organizimin dhe Funksonimin e Avokaturës së Shtetit miratuar me Urdhrin nr.68 datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
- Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.

#### **G. Standardet e auditimit:**

- Standardet e zbatuara gjatë kryerjes së auditimit:
- ISSAI100 (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
- ISSAI400 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë.
- ISSAI4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë";
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”.
- ISSAI-n 10 Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t.
- ISSAI 30 Kodi Etikës.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve.
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.

#### **H. Dokumentimi i auditimit:**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, rezultateve të akt

konstatimeve dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Raporti i Auditimit.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Avokatura e Shtetit (ASH) është një person juridik në varësi të Kryeministrit, është institucion qendror i administratës publike, *i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike*, i cili përfshin shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit për personat juridik shtetëror. Ajo drejtohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe organizohet në dy nivele në nivel qendror dhe vendor. Në nivel qendror përbëhet nga: a) zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare; b) zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror; c) *zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar*; ç) zyra e inspektimit; d) Kolegji i Avokaturës së Shtetit. Detyrat dhe funksionet parashikohen në Rregulloren e Brendshme të institucionit. Ndër funksionet bazë të institucionit janë mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, ku Republika e Shqipërisë është palë. Këtu përmendim Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe Arbitrazhin Ndërkombëtar.

#### Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:

**a. Objekti i këtij auditimi** është marrja e garancive për besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga Avokatura e Shtetit, gjatë procesit të realizimit të objektivave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

**b. Qëllimi i auditimit:** Garantimi i sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të ASH-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të parasë publike.

**c. Fushëveprimi i auditimit:** Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit, për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, në përputhje me aktet ligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni e konkretisht: ecuria e detyrimeve shtetërore për Vendime të formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi. (Stoku i detyrimeve dhe rakordimi i detyrimeve të prapambetura, gjendje në datën 31.12.2022. Detyrimet sipas vendimeve të Gjykatave Ndërkombëtare).

#### 2. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

##### ➤ *Mbi çështjet e shqyrtuara në Arbitrazhin Ndërkombëtar*

##### - *Detyrimet e ardhura nga Gjykatat e Arbitrazhit Ndërkombëtar*

Çështjet në arbitrazhin ndërkombëtar janë kryesisht çështje që lindin nga mosmarrëveshje investimesh ose mosmarrëveshje kontraktore. Objekt i arbitrazheve të investimeve janë pretendimet për të drejtat e cenuara të investitorit nga shteti pritës, të drejta si trajtimi i drejtë dhe

i barabartë, të drejta të cilat sigurohen dhe mbrohen nga marrëveshje bilaterale investimi të lidhur midis shtetit shqiptar dhe shteteve të huaja. Ndërsa në arbitrazhet tregtare objekt janë mos marrëveshjet e lindura si pasojë e implementimit dhe/ose zgjidhjes së marrëveshjeve të koncesionit, kontratave FIDIC etj.

Në arbitrazhe ndërkombëtare vendimet përfundimtare, të cilat gjejnë shkelje përcaktojnë vetëm dëmshpërblime pasurore, të cilat janë me pasoja negative në buxhetin e shtetit dhe nuk sjellin ndikim në legjislacionin e brendshëm. Pra deri më tani asnjë nga vendimet e gjykatave të arbitrazhit ndërkombëtar nuk ka sjellë si pasojë ndryshim të legjislacionit të brendshëm, sikundër ka ndodhur me vendimet e GJEDNJ të cilat kanë qenë indicie për rregullime dhe përmirësime ligjore, por sjellin vetëm pasoja në buxhetin e shtetit.

**- *Mënyra e llogaritjes së interesit mbi vendimet e formës së prerë që nuk janë ekzekutuar ende.***

Avokatura e Shtetit është përgjegjëse për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar në procese arbitrazhi ndërkombëtar, por nuk është në fushën e përgjegjësisë së saj ekzekutimi në Shqipëri i vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar.

Ndërkohë nëse vendimi nuk është në favor të RSH, analizohen të gjitha mundësitë për të kërkuar anulimin e vendimit të Arbitrazhit apo çdo mjet ligjor ‘ankimi’ ndaj këtij vendimi. ASH dërgon kopjen e vendimit tek ministria përkatëse dhe insitucionet e tjera nëse janë palë në gjykim në arbitrazhin ndërkombëtar.

**- *Ekzekutimi i vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar.***

Për çdo vendim arbitrazhi ndërkombëtar në mënyrë të tillë të bëhet i ekzekutueshëm, ky vendim do duhet të njihet nga Gjykata e Apelit Tiranë mbi bazën e rregullave të Kodit të Procedurës Civile (KPRC). Në rastet kur vendimet janë në favor të shtetit shqiptar edhe për ato të cilat janë kundër, bëhet njohja e vendimit nga Gjykata e Apelit Tiranë në të njëjtën mënyrë sipas rregullave të KPRC.

Në kreun IV “Njohja e Vendimeve të Shteteve të Huaja”, të KPRC parashikohet se:

***Neni 393*** Kushtet për zbatimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja

*Vendimet e gjykatave të shteteve të huaja njihen dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë, në kushtet e parashikuara në këtë Kod ose në ligje të veçanta. Kur për këtë qëllim ka marrëveshje të posaçme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj zbatohen dispozitat e marrëveshjes.*

***Neni 397*** Gjykata e apelit nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi i paraqitur nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394. Për kërkesën e paraqitur gjykata e apelit jep vendim.

***Neni 398*** Zbatimi i vendimit të një gjykate të huaj

*Vendimi i gjykatës së shtetit të huaj zbatohet në Republikën e Shqipërisë vetëm në bazë të vendimit të gjykatës të apelit që i jep fuqi këtij vendimi dhe ekzekutohet në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij Kodi.*

***Neni 399*** Vendimi i gjykatës së arbitrazhit

*Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe për njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi të shtetit të huaj.*

Pra në thelb, që një vendim arbitrazhi ndërkombëtar të bëhet i ekzekutueshëm ai duhet të njihet në Republikën e Shqipërisë nga Gjykata e Apelit Tiranë. Në mënyrë të tillë ngelet ende e paqartë

dhe nuk ka një unifikim të gjithë praktikës në rastet e vendimeve që përveç dëshmëpërblimeve kanë dhe një normë interesi të përcaktuar. Nuk është e qartë se kur do të fillojë të llogaritet interesi. Llogaritja e interesit do të ngelet në diskrecion të gjykatës duke mos qenë e unifikuar si praktik.

Konventa e New York e cila hyri në fuqi në 07.06.1959, ku Republika e Shqipërisë është palë në këtë konventë për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit, në nenin 2 të Konventës shprehet se secila nga shtetet kontraktuese do ta njohë marrëveshjen e shkruar, sipas së cilës palët marrin përsipër ti paraqesin Arbitrazhit të gjitha ose një pjesë të mosmarrëveshjes, e cila ka lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre lidhur me një marrëdhënie juridike të caktuar, kontraktore ose jo kontraktore. Kjo mosmarrëveshje ka lidhje me një çështje e cila mund të rregullohet me anë Arbitrazhit.

Në nenin 5 të Konventës, përsa i përket njohjes dhe ekzekutimit të vendimit, mund të refuzohen me kërkesën e palës kundër së cilës drejtohet, vetëm në qoftë se ajo palë i paraqet autoritetit kompetent ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi provën që palët në marrëveshjen që i referohet nenit 2, në bazë të ligjit të zbatueshëm për to. Në rast se ishin të paafta për të vepruar, ose marrëveshja në fjalë nuk është e vlefshme sipas ligjit të cilit i janë nënshtruar palët ose mungon ndonjë përcaktim sipas ligjit të vendit ku është dhënë vendimi ose palës kundër së cilës jepet vendimi nuk i është dhënë njoftimi i rregullt për caktimin e arbitrit ose të procedurës së arbitrazhit, ose ka qenë e paaftë për të paraqitur rastin e saj, ose vendimi trajton një mosmarrëveshje të paparashikuar në marrëveshjen për arbitrazh, ose nuk hyn në klauzolën mbi arbitrazhin, ose përmban vendime për çështjet që kalojnë fushën që i nënshtrohet arbitrazhit. Megjithatë në qoftë se vendimet për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit mund të veçohen nga ato që nuk i janë nënshtruar, ajo pjesë e vendimit e cila përmban vendime për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit, mund të njihet dhe të ekzekutohet, ose përbërja e autoritetit të arbitrazhit ose e procedurës së arbitrazhit nuk ishte në përputhje me marrëveshjen e palëve, ose mungon një marrëveshje e tillë, nuk është në përputhje me ligjin e vendit ku është zhvilluar, ose në rastet kur vendimi nuk ka marrë formën përfundimtare për palët, ose është anuluar ose pezulluar nga organi kompetent i vendit në të cilin, ose sipas ligjit të cilit është dhënë vendimi. Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi të arbitrazhit mund të refuzohen në qoftë se autoriteti kompetent i vendit ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi konstaton se, objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet në rrugë arbitrazhi sipas ligjit të atij vendi, ose kur njohja dhe ekzekutimi i vendimit do të vinte në kundërshtim me rendin publik të këtij vendi.

Në këtë mënyrë Konventa e New York e konsideron se në bazë të legjislacionit të brendshëm, vendimi i arbitrazhit do të bëhet i ekzekutueshëm vetëm pas njohjes së tij.

***- Raste kur paditësi, qoftë person fizik/ojftj. është fitues më vendim të gjykatave të huaja apo të Arbitrazhit ndërkombëtar, kërkojnë ekzekutimin e vendimit në një vend tjetër.***

Në rastin e çështjes së arbitrazhit ICSID Case no. ARB/15/28 H. dhe kundër R. së SH., pala paditëse ka iniciuar procedura ekzekutimi në vende të tjera. Për këto procedura, ASH vendoset në dijeni përmes Ministrisë së Drejtësisë, së cilës i transmetohen kërkesat për njoftim aktesh nga autoritetet e vendeve të tjera.

Aktualisht, RSH po përfaqësohet në Itali, Mbretëri e Bashkuar dhe Belgjikë në procedurat e kundërshtimit të vendimit të arbitrazhit, një rast i cili është ICSID Case No. ARB/15/28.



**- Korrespondenca e mbajtur nga Avokatura e Shtetit me institucione të tjera deri në shlyerjen e detyrimit të përcaktuar në vendim.**

Prej Avokaturës së Shtetit specifikohet se janë mbajtur korrespondenca me institucionet në rastet e procedurave të njohjes dhe ekzekutimit të disa vendimeve, ku ASH i kërkohet dërgimi i dokumentacion plotësues të kërkuar nga Gjykata e Apelit Tiranë (si p.sh. certifikime të ndryshme për marrjen formë të prerë të vendimit), por nuk rezulton të paktën për vitin 2021 - 2022 të ketë gjurmë dokumentacioni lidhur me pagesat e detyrimeve të caktuara.

Nga auditimi u konstatua se sa i takon regjistrin fizik të Arbitrazhit Ndërkombëtar, ky regjistër ka filluar të plotësohet fizikisht nga viti 2022 dhe nuk ka një databazë zyrtare (regjistër) të çështjeve të trajtuara në Arbitrazhin Ndërkombëtar. Kjo në kundërshtim me nenin 17 të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit.

Regjistri duhet të përshtatet dhe rregullohet sipas Ligjit nr.9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe specifikisht të hartohet dhe mbahet në përputhje me normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë duke formatizuar dokumentin për shkak të rëndësisë që ai mbart.

***Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 384/5 prot., datë 28.08.2023, në lidhje me akt konstatimin nr. 30, datë 31.05.2023, ku janë shprehur pretendimet si më poshtë:***

***Pretendimi i subjektit:*** Sikurse është parashtruar nga ana jonë, në kundërshtimet e akt konstatimeve, regjistri elektronik dhe fizik, i cili mbahet konform Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, nr.68, datë 28.03.2019, rekomandimeve të mëparshme të KLSH-së, Urdhri nr.375/2 prot., datë 16.11.2022 i Avokatit të Përgjithshëm, nuk i nënshtrohet mënyrës dhe procedurës së mbajtjes së ligjit “Për Arkivat”. Ai është një regjistër informues dhe lehtësues, i cili përmbledh të dhëna dhe ka informacion të përpunuar, në mënyrë që këto të përdoren lehtësisht nga avokatët e shtetit, me qëllim ecurinë e punës në këtë institucion. I gjithë informacioni për çështjet e Arbitrazhit apo ekzekutimin e tyre mbahet konform Ligjit “Për Arkivat”, në mënyrë të rregullt në protokollin e Avokaturës së Shtetit, ku regjistrohen të gjitha shkresat/dokumentat hyrëse dhe dalëse. Është e pamundur që ky informacion të humbasë, sikurse përcaktohet tek ndikimin/efekti i gjetjes. Mënyra e mbajtjes së tyre sipas ligjit “Për Arkivat” vetëm do të vështirësonte, publikonte dhe treplikonte punën, duke kërkuar punonjës të tjerë specifik për mbajtjen e tyre, dhe pa asnjë përfitim në rritjen e cilësisë së punës.

Për të gjitha sa sqaruam, duke respektuar dhe gjetjet e mëparshme të KLSH është vlerësuar, duke u sanksionuar në aktet rregullatore të sipërcituara, mënyra e mbajtjes së këtyre dy regjistrave, në të cilin shënohen vetëm si referencë nr. e shkresave që përmbajnë informacionin më të rëndësishëm për një çështje dhe që ndihmojnë më pas avokatët e shtetit, por dhe organet kontrolluese si KLSH të përftojnë informacionin që duhet.

Në mënyrë të vecantë, dëshirojmë të theksojmë se nga institucioni ynë, në hartimin e regjistrave respektivë, janë mbajtur në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e mëparshme të KLSH. Konkretisht, me shkresën nr.1114/9 prot., datë 14.10.2021, protokolluar në ASH me nr.4425/16, datë 15.10.2021. Një nga Rekomandimet e mëparshme të KLSH është se duhet të miratohet formati tip i regjistrin fizik dhe elektronik të çështjeve gjyqësore në gjykatat e huaja, ku RSH është palë, me qëllim regjistrimin e plotë të të gjithë hapave procedurale të ndërmarra në këto

processe si dhe ecurinë e njohjes dhe zbatimit të këtyre hapave procedurale të ndërmarra në këto procese si dhe ecurinë e njohjes dhe zbatimit të këtyre vendimeve në vendin tonë. Urdhri i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për miratimin e formatit Nr.375/2, datë 16.11.2022 (i ndryshuar) dhe mbajtja e regjistrit ka dalë pikërisht në zbatim të këtij rekomandimi.

***Qëndrimi i grupit të auditimit:***

*Mangësitë e regjistrit, të cilat u diskutuan me subjektin gjatë fazës së punës në terren dhe u dakortësua mbi to, përmbledhtazi po jua parashtrojmë:*

*Ritheksojmë se, ashtu sikundër dhe ju vet shpreheni, ky regjistër shërben si referencë gjatë punës së përditshme të avokatëve të shtetit të kësaj zyre. Si një dokument tek i cili ju bazoheni për punën tuaj, nevojitet të plotësohen kriteret e dokumentit zyrtar, në mënyrë të tillë shmang gabimet përgjatë plotësimit.*

*Sa i takon regjistrit të hyrje/daljeve të protokollit nuk jemi dhe nuk mund të shprehemi, pasi ky dokument nuk ka qenë pjesë e dokumenteve të audituara.*

*Si një dokument tek i cili Avokatura e Shtetit bazohet për vazhdueshmërinë e punës nevojitet plotësimi me të gjitha çështjet të cilat vazhdojnë të mbarten ndër vite, duke pasur në vëmendje se shumë nga çështjet janë të mbartura ndër vite dhe të hershme në kohë dhe ato të cilat lindin të reja. Plotësimi dhe përditësimi i regjistrave me të gjitha elementet e tyre nuk lejon gabimet përgjatë punës në plotësim.*

*Përsa më sipër, observacioni paraqitur **nuk merret në konsideratë.***

***- Zbatimi i vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar***

Vendimi i arbitrazhit është i detyrueshëm për zbatim, pavarësisht vendit në të cilin është marrë. Pala e interesuar për zbatimin e vendimit, duhet të paraqes origjinalin apo kopjen të njëzësuar me origjinalin të vendimit të arbitrazhit, dhe marrëveshjes së arbitrazhit. Nëse vendimi apo marrëveshja janë në gjuhë të huaj, pala duhet të paraqes një përkthim të vërtetuar të tyre në gjuhën shqipe.

Në një formë dhe përmbajtje krejt tjetër nga vendimet e GJEDNJ përsa i përket zbatimit, pasi njohja e këtyre vendimeve lidhet domosdoshmërisht vetëm me kërkesën e palës së interesuar për njohje dhe ekzekutim vendimi.

Gjatë auditimit janë konstatuar çështjet e mbartura gjatë viteve 2021 dhe 2022, të cilat janë ende në proces gjyqësor në Arbitrazhin Ndërkombëtar, po ashtu dhe dëmi i mundshëm potencial. Në disa nga çështjet është përcaktuar që në fazat e para të kërkesës dëmi i mundshëm potencial me iniciativë të paditësit, por në disa disa çështje të tjera nuk janë ende të përcaktuara se sa mund të jetë dëmi potencial i mundshëm.

***a) Çështje të filluara gjatë periudhës 2021-2022, të cilat 2 çështje janë të reja të nisura për 2021 dhe një çështje e filluar në 2022.***

- Në vitin 2021, “I. H. G.” ngre një padi kundër R. së Sh.. Detyrimi potencial është 37,224,810 Euro, kjo vlerë është një detyrim paraprak i pretenduar nga pala paditëse.

- Po ashtu në vitin 2021, “D. G.” sh.p.k ngre një padi kundër M. I. E.. Detyrimi potencial i kërkuar nga pala paditëse është 2,788,933,741 Lekë, ndërkohë që vlera e kërkuar nga R. së Sh. në kundërpadi është 14,630,050,747 Lekë.

- Në vitin 2021, K. E. Sh. ngre padi kundër “L. T.”. Shoqëria është në procedurë falimenti dhe aktualisht është njohur edhe në regjistrin e procedurave të falimentit. Shuma e pretenduar nga K. E. Sh. në vlerën prej 2,405,682.40 Euro. Ndërkohë janë ndërmarrë një sërë veprimesh për vlerësimin e aseteve të “L. T.”, por procesi vazhdon të jetë ende në pritje.
- Në vitin 2022, personi fizik znj. M. N. ngre padi kundër R. së Sh., dhe vlera e pretenduar prej saj si një detyrim potencial është 123,000,000 Euro.

**b) Çështjet që kanë përfunduar në Arbitrazh Ndërkombëtar me një vendim, por nuk ka ende asnjë kërkesë për njohje vendimi në Gjykatën e Apelit Vendas:**

Nr	Iniciuar çështja	Titulli	Pala Paditëse	Palë e Paditur	Statusi Aktual	Detyrimi i vendosur nga Tribunali i arbitrazhit
1	2018	ICC Case no.23998/MHM (C-24011/MHM)	Bashkimi i shoqërive “J. C. C. E. & A. T. S. A.”, shoqëria “C. C. E.” dhe “A. T. S. A.”	A. Rr. Sh.	Pa paguar Detyrim për RSH	30,264,019. USD + 13,998,662.77 USD + 261,556.75 Euro + 161,524.38 Euro +150,000 Euro
2	2014	ICSID ARB/14/26	Shoqëria “A. A.” sh.p.k., A. N., shoqëria “C.” s.r.l,	R. e Sh. M. e T. dhe M.	Pa paguar Detyrim kundrejt RSH	Pagesën e menjëhershme të: 1,857,000 Euro; 427,488.72 USD 106,755 £. 550,000 EUR Penalitet: Nëse ka vonesa në pagimin e këtyre kostove interesi do të shtohet mbi shumat që mbeten të paguara në normën prej 2% të interesit të përbërë, derisa të paguhen kostot, duke filluar nga dita e 28-të e dorëzimit të vendimit.

Burimi: Avokatura e Shtetit, përpunoi Grupi Auditimit

Detyrimi pa paguar për R. e Sh. është 44,262,681.77 USD + 573,081.13 Euro.

Detyrimi pa paguar kundrejt R. e Sh. është 2,407,000 Euro; 427,488.72 USD dhe 106,755 £.

Për këto vendime nuk ka kërkesë për njohje në apelin vendas, rrjedhimisht nuk ka asnjë shumë të paguar as në favor as kundër R. e Sh.. Përsa kohë nuk ka një vendim njohje nuk ka asnjë arkëtim. **Konstatim:** Duke pasur në vëmendje se ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Ku në këtë rast janë tituj ekzekutivë vendimet e gjykatave të arbitrazheve të shteteve të huaja që u është dhënë fuqi sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile.

Përsa i përket dispozitivit të vendimit, Tribunali i Arbitrazhit vendosi më 3 mars 2020 edhe mbi kostot, duke urdhëruar paditësit t’i paguajnë R. e Sh.. Kostot dhe shpenzimet në total brenda 28 ditëve nga dhënia e këtij vendimi. Nëse do të ketë ndonjë vonesë në pagimin e kostove të tilla, atëherë interesi do të rritet mbi shumat që mbeten të papaguara në normën 2% të interesit të përbërë, derisa kostot dhe shpenzimet të paguhen tërësisht.

Si pasojë e mosveprimit në kohë nga autoritetet shtetërore si palë të interesuara për njohje të vendimit nga gjykata e apelit vendase, nuk janë arkëtuar për llogari të buxhetit të shtetit shumat 2,407,000 Euro; 427,488.72 USD dhe 106,755 £.

Më 12.06.2022, Avokatura e Shtetit ka informuar me *e-mail* zyrtar M. T. M. (MTM, institucioni shtetëror përgjegjës për këtë vendim) mbi vendimin e datës 6 maj, duke theksuar se duhen ndërmarrë hapa për të ekzekutuar vendimin, si dhe sa i përket kostove të çështjes kryesore të arbitrazhit, ashtu edhe kostot në Vendimin e Anulimit.

***Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 384/5 prot., datë 28.08.2023, në lidhje me akt konstatimin nr. 30, datë 31.05.2023, ku janë shprehur pretendimet si më poshtë:***

***Pretendimi i subjektit:***

*Duke marrë parasysh faktin se këto vendime prodhojnë efekte financiare në favor të palës shqiptare duke patur komunikim të vazhdueshëm me Ministrinë dhe nga ana jonë janë përcjellë vendimet e arbitrazhit për vijimin me procesin e njohjes dhe dhënies fuqi juridike, Avokatura e Shtetit do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të adresuar rekomandimin tek M. T. M..*

***Qëndrimi i grupit të auditimit:***

*Përsa i përket observimit tuaj, ritheksojmë faktin se mungesa e kërkesës nga insitucioni përgjegjës (MTM) i cili ka qenë palë në gjykim, për njohje të vendimit të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit Vendas duke qenë se RSH është fituese sjellë të ardhura të munguara në buxhet.*

*Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa të menjëherëshme si palë në proces për ndjekjen e procedurës së ekzekutimit për njohjen e vendimit në Gjykatën e Apelit Vendas, në mënyrë të tillë të përfutojë në kohë vlerën e të ardhurave të përcaktuar në vendimin e Tribunalit të Arbitrazhit. E trajtuar në raport në mënyrë narrative rëndësia e njohjes së vendimit në mënyrë të tillë të bëhet titull ekzekutiv, duhet të përcjellë ky rekomandim pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në mënyrë të tillë të marrë masa. Ky rekomandim dhe gjetje nuk i adresohet ASH si insitucion përgjegjës për të vijuar me procesin e njohjes dhe dhënies fuqi juridike vendimit të Arbitrazhit Ndërkombëtar dhe si e tillë observacioni paraqitur **nuk merret në konsideratë.***

◆ **16 maj 2022**

Avokatura e Shtetit i ka ripërcjellë *e-mailin* e datës 12 maj M. T. M., duke e informuar se studioja ligjore që ka përfaqësuar R. e Sh. në procesin e anulimit, ka përgatitur kërkesën për ekzekutimin e vendimit drejtuar paditësve. Në këtë kontekst, Avokatura e Shtetit i kërkon MTM-së të dhënat e një llogarie bankare, ku do të derdheshin shumat e akorduara nga vendimet e Arbitrazhit. Të dhënat e llogarisë bankare, MTM i ka bërë të ditura më **31 maj 2022.**

◆ **1 qershor 2022**

Avokatët e R. e Sh. të kontraktuar për përfaqësimin në procesin e arbitrazhit lidhur me anulimin i dërguan palës paditëse, kërkesën formale për:

*1. Pagesën e menjëhershme të:*

- a. USD 427,488.72 së bashku me interesin prej USD 273,851.84, në përputhje me paragrafët 576 deri 576 të Vendimit;
- b. EURO 1,857,000, së bashku me interesin prej EURO 1,189,605.33, në përputhje me paragrafët 576 deri 576 të Vendimit; dhe
- c. GBP 106,755 së bashku me interesin prej GBP 68,387.89, në përputhje me paragrafët 576 deri 576 të Vendimit.

2. Pagesën e shumës prej EURO 550,000 deri më 3 qershor 2022, në përputhje me paragrafin 320(c) të Vendimit mbi Anulimin.

◆ **Korrik 2022**

Avokatët e R. e Sh. të kontraktuar për përfaqësimin në procesin e arbitrazhit lidhur me anulimin, informojnë ASH se një nga paditësit, shoqëria italiane “C.”, ka kthyer një përgjigje kërkesës formale për ekzekutimin e vendimit. Në përgjigjen e saj, C., përmend arbitrazhin ICSID Case No. ARB/15/28, ku C. është një nga Paditësit kundër R. e Sh., si dhe vendimin e këtij procesi, si dhe procesit përkatës të anulimit, të cilat dënojnë RSH t’u paguajë paditësve shuma më të larta se procesi i A..

**Bazuar në këtë referencë, C. shpreh se “Shqipëria ka dështuar të paguajë shuma të konsiderueshme, të detyruara në bazë të vendimit të arbitrazhit dhe vendimit të procedurës për anulim në arbitrazhin ARB/15/28, të cilat tejkalojnë çdo shumë që i detyrohet nga procesi ARB/14/26. Asnjë pagesë nuk do të bëhet në procedurën ARB/14/26, derisa Shqipëria të paguajë përfundimisht dhe plotësisht shumat që detyrohet sipas arbitrazhit ARB/15/28”.**

◆ **Tetor 2022**

Avokatura e Shtetit i ka dërguar MTM shkresën nr. 307/9, datë 20.10.2022, ku i kërkon informacion nëse janë marrë masa për njohjen dhe kryerjen e procedurës për dhënie fuqi juridike të vendimit të datës 6 maj 2022 pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

<b>Titulli i gjetjes 1:</b>	<b>Arbitrazhi Ndërkombëtar</b>
<b>Situata:</b>	<p><b>1. Gjetje nga auditimi:</b></p> <p>Procesi i arbitrazhit, i regjistruar me nr. “<b>ICSID ARB/14/26</b>” përfundoi me një Vendim të Tribunalit të datës <b>3 mars 2020</b>, i cili i dha të drejtë pretendimeve të R. e Sh. dhe rrëzoi të gjitha kërkesat e paditësve. Kjo çështje ka përfunduar në Arbitrazh Ndërkombëtar me një vendim, por nuk ka ende asnjë kërkesë për njohje vendimi në Gjykatën e Apelit Vendas.</p> <p>Detyrimi i vendosur nga Tribunali i Arbitrazhiti cili është në favor të RSH. Ky detyrim potencial është në vlerën e 2,407,000 Euro; 427,488.72 USD dhe 106,755 £ .</p> <p>Ku përcaktohet si penalitet se nëse do të ketë vonesa në pagimin e këtyre kostove interesi do të shtohet mbi shumat që mbeten të papaguara në normën prej 2% të interesit të përbërë, derisa të paguhen kostot, duke filluar nga dita e 28-të e dorëzimit të vendimit.</p> <p>Përsa i përket dispozitivit të vendimit, Tribunali i Arbitrazhit vendosi më 3 mars 2020 edhe mbi kostot, duke urdhëruar paditësit t’i paguajnë RSH: <i>Kostot dhe shpenzimet në total brenda 28 ditëve nga dhënia e këtij Vendimi. Nëse do të ketë ndonjë vonesë në pagimin e kostove të tilla, atëherë interesi do të rritet mbi shumat që mbeten të papaguara në normën 2% të interesit të përbërë, derisa kostot dhe shpenzimet të paguhen tërësisht.</i></p> <p>Si pasojë e mosveprimit në kohë nga autoritetet shtetërore si palë të interesuara për njohje të vendimit nga gjykata e apelit vendase, nuk janë arkëtuar për llogari të buxhetit të shtetit shumat 2,407,000 Euro; 427,488.72</p>

	USD dhe 106,755 £.
<b>Kriteri:</b>	- Ligji nr.10018 datë 13.11.2018 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar; - Rregullore e Brendshme e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr.68 datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit; - Vendimi i datës 03.03.2020 i Tribunalit të Arbitrazhit.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Të ardhura të munguara në buxhet.
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e kërkesës nga insitucioni përgjegjës (MTM) i cili ka qenë palë në gjykim, për njohje të vendimit të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit Vendas duke qenë se R. e Sh. është fituese.
<b>Rekomandimi:</b>	M. T. M. të marrë masa të menjëherëshme si palë në proces për ndjekjen e procedurës së ekzekutimit për njohjen e vendimit në Gjykatën e Apelit Vendas, në mënyrë të tillë të përfitojë në kohë vlerën e të ardhurave të përcaktuar në vendimin e Tribunalit të Arbitrazhit.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Afati i zbatimit:</b>	Menjëherë.

- *Njohur nga Gjykata e Apelit në 04.05.2021, por është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë nga A.SH në datën 07.07.2021 (kërkesë për pezullim ekzekutimi)*

Nr	Iniciuar çështja	Titulli	Pala Paditëse	Palë e Paditur	Statusi Aktual	Detyrimi i vendosur nga Tribunali i arbitrazhit
1	2017		G. O. C.	M. I. E., A. K. B. N., A..	Pa paguar Detyrim për RSH	12,577,852.1 USD + 292,760 USD + 14,451.68 Euro  Me interes me normë 5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.

*Burimi: Avokatura e Shtetit, përpunoi Grupi i Auditimit*

### **ICC Case nr. 22676/GR G. O. v. M. I. E., A. K. B. N.**

Vendimi i Arbitrazhit është lëshuar më datë **06.07.2020** dhe i është përcjellë M. I. E. dhe A. K. B. N. me shkresën nr. 1526/3 Prot., datë **29.07.2020** të Avokaturës së Shtetit.

Avokatura e Shtetit përmes shkresës nr. 2886/1 Prot., datë 07.06.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është njohur me vendimmarrjen e kësaj gjykate e cila me vendimin nr.49, datë 04.05.2021 ka vendosur të pranojë kërkesën e Shoqërisë G. O. C. për njohjen dhe dhënien fuqi juridike të vendimit të arbitrazhit. Avokatura e Shtetit ka informuar M. I. E me shkresën nr. 1526/23 Prot., datë 07.07.2021 dhe ndërkohë Avokatura e Shtetit ka paraqitur në Gjykatë të Lartë Rekursin ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, ndërkohë që cëshja për rekursin vazhdon të jetë në pritje.

***Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, është paraqitur observacioni me shkresën nr. 384/5 prot., datë 28.08.2023, në lidhje me akt konstatimin nr. 30, datë 31.05.2023, ku janë shprehur pretendimet si më poshtë:***

***Pretendimi i subjektit:***

*Lidhur me cëshjten e arbitrazhit G. O. v M.I.E./A.K.B.N. dhe A. ka pasur disa zhvillime të*

mëtejshme të fundit, për të cilat ju informojmë si më poshtë :

Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë me shkresat nr.2597/2 prot., / D.S, datë 31.07.2023 dhe nr.2597/2 prot., datë 16.08.2023 është përcjellë kërkesa e personit juridik O. B. L. me objekt njoftimin dhe dorëzimin e akteve M. I. E., A. K. B. N. dhe personit juridik A.Sh.A, mbështetur në Konventën e Hagës “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare, të vitit 1965”. Shoqëria O. B. L. është paraqitur si shoqëria së cilës i janë transferuar të drejtat (sipas Marrëveshje Transferimi datë 8 Maj 2023) nga Shoqëria G. O. C. dhe aktualisht ka depozituar një kërkesë në Gjykatën e Distriktit të Columbia-s SHBA, për njohjen e vendimit të arbitrazhit të datës 06.07.2020 (ICC Case No.22676/GR). Në kuadër të këtyre zhvillimeve nga ana jonë po realizohen komunikimet e nevojshme ndër institucionale për të bërë të mundur mbrojtjen sa më të mirë të interesave të shtetit shqiptar.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.49, datë 04.05.2021 në dispozitivin e tij urdhëron që M. I. E dhe A.K.B.N duhet t'i paguajë paditësit 12,557,852.1 USD si dëmshpërblim për shkeljen e detyrimeve, po ashtu urdhëron që të paditurit të paguajnë shumat prej 292,760 USD dhe 14,451.68 EURO, me interes me normën 5% që nga data e këtij vendimi deri sa të bëhet pagesa e plotë. Po ashtu, ju ritheksojmë se Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar kërkesën për ekzekutim të vendimit, në këtë mënyrë vendimet e Gjykatës së Apelit quhen të formës së prerë për efekt ekzekutimi edhe nëse kundër tyre bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë.

Panvarësisht faktit se ka një marrëveshje transferimi të datës 08.05.2023 nga shoqëria G. O. C. tek personi juridik O. B. L. ku janë transferuar të drejtat, ku rrjedhimisht një e drejtë është vjelja e detyrimeve. Përsa më sipër, observacioni paraqitur **nuk merret në konsideratë.**

**Konstatim:** Totali i interesave të arkëtueshëm deri në 31.12.2022 sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit rezulton të jenë 1,042,411.02 USD; 24,262.98 USD; 1,197.72 Euro. Këto vlera do ti shtohen vlerës së principalit të vendosur në vendimin e arbitrazhit.

<b>Titulli i gjetjes 2:</b>	<b>Arbitrazhi Ndërkombëtar</b>
<b>Situata:</b>	<b>2. Gjetje nga auditimi:</b> Cështje e iniciuar në vitin 2017 me nr.22676/GR “G. O. C.” dhe palë të paditur M. I. E., A. K. B. N. dhe A.. Vendimi i arbitrazhit është lëshuar më datë <b>06.07.2020</b> dhe i është përcjellë M. I. E., A. K. B. N. me shkresën nr. 1526/3 Prot., datë <b>29.07.2020</b> të Avokaturës së Shtetit. Avokatura e Shtetit përmes shkresës nr. 2886/1 Prot., datë 07.06.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është njohur me vendimmarrjen e kësaj gjykate e cila me vendimin nr.49, datë 04.05.2021 ka vendosur të pranojë kërkesën e Shoqërisë G. O. C. për njohjen dhe dhënien fuqi juridike të vendimit të arbitrazhit. Avokatura e Shtetit ka informuar M. I. E me shkresën nr. 1526/23 Prot., datë 07.07.2021 dhe ndërkohë Avokatura e Shtetit ka paraqitur në Gjykatë të Lartë Rekursin ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Totali i interesave të arkëtueshëm deri në 31.12.2022 sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit rezulton të jenë 1,042,411.02 USD; 24,262.98 USD; 1,197.72 Euro. Këto vlera do ti shtohen vlerës së principalit të vendosur në vendimin e arbitrazhit.

<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr.10018 datë 13.11.2018 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar;</li> <li>- Rregullore e Brendshme e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr.68 datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit;</li> <li>- Kodi i procedurës Civile, i azhornuar;</li> <li>- Vendimi i datës 06.07.2020 i Tribunalit të Arbitrazhit;</li> <li>- Vendimi nr.49 datë 04.05.2021 i Gjykatës së Apelit.</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Interesat e shtuara vlerës së principalit të vendosur në vendimin e arbitrazhit, të cilat kanë filluar të llogariten pas vendimit për njohje nga Gjykata e Apelit, në mënyrë të tillë duke rritur detyrimin kontigjent që duhet të paguhet nga M. I. E., A. K. B. N. dhe A..
<b>Shkaku:</b>	Mospagimi në kohë i detyrimit të vendosur nga Tribunali i Arbitrazhit, pas njohjes në Gjykatën e Apelit.
<b>Rekomandimi:</b>	M. I. E., A. K. B. N. dhe A. të marrin masa të menjëhershme pas vendimit të Gjykatës e Apelit, në mënyrë të tillë që totali i interesave të mos vazhdojë të rritet në mënyrë që këto vlera do t’i shtohen vlerës së principalit të vendosur në vendimin e arbitrazhit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Afati i zbatimit:</b>	Menjëherë.

**a) Çështje të cilat janë në proces gjyqësor në arbitrazhin ndërkombëtar.**

Nr	Iniciuar çështja	Titulli	Pala Padiçese	Palë e Paditur	Statusi Aktual	Detyrimi i vendosur nga Tribunali i arbitrazhit
1	2018	ICC Case 24140/MH M	Sh. C. D.	M. I. E., A. K. U. M.	Në proces	Detyrime potenciale: Vlera e kërkuar nga Padiçesi në Padi: 35,000,000 EURO
2	2015	ICC Case 21349/GR	B. P. A.	M. I. E., A. K. B. N., A.	Në proces	Detyrime potenciale: Në këtë rast, nuk bëhet fjalë për kërkesa dëmshpërblimesh apo shumash, por për njohje kostosh të rikuperueshme
3	2018	PCA Case 2018-49	V. I.	R. e Sh. (M. B. ZH.R)	Në proces	Detyrime potenciale: 82,701,000 Euro - detyrim i pretenduar nga Pala Padiçese
4	2020	ICSID Case no.ARB/20 /37	M. C. T. C., A. D. LP, D. K.	M. I. E.,	Në proces	Detyrime potenciale: 63,700,000 Euro - detyrim i pretenduar nga Pala Padiçese
5	2021	SCC Arbitration 2021/155	I. H.	R. e Sh.	Në proces	Detyrime potenciale: 37,224,810 Euro - detyrim paraprak i pretenduar nga Pala Padiçese
6	2021	D. G. shpk/D. E. v M. I. E.	D. G. shpk/D. E.	M. I. E.	Vendase, në proces	Detyrime potenciale: 2,788,933,741 Lekë - detyrim i pretenduar nga Pala Padiçese  14,630,050,747 Lekë - Vlera e kërkuar prej RSH në Kundërpadi.
7	2022	M. N. v. R. e Sh.	M. N.	R. e Sh.	Në proces	Detyrime potenciale: 123,000,000 Euro - detyrim i pretenduar nga Pala Padiçese
					<b>Total i</b>	341,625,810 Euro.



					<b>detyrimet potencial</b>	
--	--	--	--	--	--------------------------------	--

Burimi: Avokatura e Shtetit, përpunoi Grupi Auditimit

**Shënim:** Totali i detyrimit potencial (detyrim ky i pretenduar nga pala paditëse kundër RSH), panvarësisht faktit se nuk ka një vendim të formës së prerë nga Gjykatat e Arbitrazhit Ndërkombëtar është 341,625,810 Euro.

**b) Çështje të cilat janë në proces njohje nga gjykata e apelit vendase.**

Nr	Inicuar çështja	Titulli	Pala Paditëse	Palë e Paditur	Statusi Aktual	Detyrimi i vendosur nga Tribunali i Arbitrazhit
1	2014	ICC Case No. 20564/EMT/GR	H. s.r.l.	R. e Sh.	Vendimi në proces njohje nga Gjykata	Detyrim i R. e Sh. për t'i rimbursuar 142,975.78 Euro H. lidhur me kostot e Fazës II të arbitrazhit Detyrim i Paditësit për t'i paguar RSH si penalitet për vonesat në zhvillimin e kontratës 1,693,157 Euro + interesa të përbëra me bazë 12-mujore Euro Libor +2% nga data 9.1.2018 deri në pagesën e plotë; si dhe -Detyrim i H. që t'i rimbursojë RSH me 325,000 USD kosto ligjore dhe të arbitrazhit.
2	2017	ICC Case no.22919/GR	H. s.r.l.	R. e Sh. M. I. E.	Në proces njohje vendimi	H. detyrohet t'i paguajë RSH 731,280 Euro + 1795.60 GBP kosto ligjore dhe të arbitrazhit. Procesi i anulimit: H. i detyrohet R. e Sh. 60.000 Euro shpenzime ligjore.
3	2015	ICSID ARB/15/28	H. s.r.l, C. srl, F. B., M. de R., S. G. L. C.	R. e Sh. (ish-M. e P. P., T. dhe T. dhe ish-M. e E., T. dhe E.)	Pa paguar Detyrim për R. e Sh..	99,487,000 Euro +8,222,238.53 Euro +645,183,42 + interesa Libor+3% tre mujor prej 31.03.2018  Procesi i Anullimit: - detyrim i R. e Sh. të paguajë 1,701,258.71 USD + interes LIBOR(ose SOFR nëse LIBOR nuk ekziston më derisa të bëhet pagesa e plotë)+ 3% tremujor nga data 31 mars 2021. Procesi i Rishikimit:29.03.2023- detyron R. e Sh. të paguajë kostot e procesit 145,169.67 USD (paguar vetëm shpenzimet gjyqësore)
4	Viti 2014	ICC Case No. 20564/ EMT/GR			Procesi i njohjes së vendimit të arbitrazhit para Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë	1,693,157 Euro+ interesa të përbërë me bazë 12 mujore Euro Libor + 2% nga data 16.07.2011 deri në pagesën e plotë; + 5,182,535 Euro + interesa të përbërë me bazë 12 mujore Euro Libor + 2 % nga data 09.01.2018 deri në pagesën e plotë + 325,000 USD.

Burimi: Avokatura e Shtetit, përpunoi Grupi i Auditimit

**a) Çështje të cilat janë pezulluar nga Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar**

Nr	Inicuar çështja	Titulli	Pala Paditëse	Palë e Paditur	Statusi Aktual	Detyrimi i vendosur nga Tribunali i Arbitrazhit
1	2016	ICSID Case no.CONC/1 6/1	X. K.	R. e SH.	Pezulluar	
2	2020	ICSID Case no.ARB/20	A. E. B.V	MIE	Përfunduar (Ndërprerë) në	

		/54			Korrik 2022. Procesi është ndërprerë (Discontinued) për shkak se palët nuk kanë paguar shpenzimet administrative fillestare të Tribunalit.	
--	--	-----	--	--	--	--

Burimi: Avokatura e Shtetit, përpunoi Grupi i Auditimit

Nga auditimi lidhur me *çështjet në gjykim* në Arbitrazhin Ndërkombëtar u konstatua se, nuk ka gjurmë të pranisë së një databaze mbi të dhënat dhe vlerat reale (totale) për të gjitha çështjet të cilat kanë përfunduar dhe ato që janë ende në shqyrtim.

Pavarësisht faktit se çështjet në Gjykatën e Arbitrazhit nuk lidhen drejtpërdrejtë me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dëmi impaktueshëm në buxhetin e shtetit është në vlera të konsiderueshme krahasuar me dëmin e shkaktuar prej vendimeve të GJEDNJ-së.

### 3. Gjetje nga auditimi:

Sa i takon dokumentimin dhe regjistrimit fizik të ndjekjes së çështjeve gjyqësore, u konstatua se,

- ✓ **Sa i takon regjistrimit të Arbitrazhit Ndërkombëtar** ky regjistër ka filluar të plotësohet fizikisht nga viti 2022 dhe nuk ka një databazë zyrtare të çështjeve të trajtuara në Arbitrazhin Ndërkombëtar.

### 4. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi lidhur me çështjet në gjykim në Arbitrazhin Ndërkombëtar u konstatua se, nuk ka gjurmë të pranisë së një databaze mbi të dhënat dhe vlerat reale (totale) për të gjitha çështjet të cilat kanë përfunduar dhe ato që janë ende në shqyrtim.

Pavarësisht faktit se çështjet në Gjykatën e Arbitrazhit nuk lidhen drejtpërdrejtë me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dëmi impaktueshëm në buxhetin e shtetit është në vlera të konsiderueshme krahasuar me dëmin e shkaktuar prej vendimeve të GJEDNJ-së.

*Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Arbitrazhin Ndërkombëtar është mbajtur Akt Konstatim nr.2 me nr.2178/4 prot., datë 23.06.2023 dhe personat e atakuar janë z. O. M. me detyrë Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, me cilësinë e titullarit të Institucionit, znj. M. I. me detyrë Drejtuese e Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar dhe znj. A. H. me detyrë Juriste në Zyrën e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar me cilësinë e personit përgjegjës për mbajtjen e regjistrimit të Arbitrazhit.*

<b>Titulli i gjetjes 3 dhe 4:</b>	<b>Arbitrazhi Ndërkombëtar</b>
<b>Situata:</b>	<b>3. Gjetje nga auditimi:</b> Sa i takon dokumentimin dhe regjistrimit fizik të ndjekjes së çështjeve gjyqësore, u konstatua se,

	<p>✓ <i>Sa i takon regjistrin të Arbitrazhit Ndërkombëtar</i> ky regjistër ka filluar të plotësohet fizikisht nga viti 2022 dhe nuk ka një databazë zyrtare të çështjeve të trajtuara në Arbitrazhin Ndërkombëtar.</p> <p><b>3.1 Gjetje nga auditimi:</b> Nga auditimi lidhur me <i>çështjet në gjykim</i> në Arbitrazhin Ndërkombëtar u konstatua se, nuk ka gjurmë të pranisë së një databaze mbi të dhënat dhe vlerat reale (totale) për të gjitha çështjet të cilat kanë përfunduar dhe ato që janë ende në shqyrtim.</p> <p>Pavarësisht faktit se çështjet në Gjykatën e Arbitrazhit nuk lidhen drejtpërdrejtë me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dëmi impaktueshëm në buxhetin e shtetit është në vlera të konsiderueshme krahasuar me dëmin e shkaktuar prej vendimeve të GJEDNJ-së.</p>
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr.10018 datë 13.11.2018 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar;</li> <li>- Rregullore e Brendshme e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr.68 datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 29 i saj;</li> <li>- Ligji nr.9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat” si dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë;</li> <li>- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Nivel i lartë risku duke u bërë objekt ndryshimi apo humbje në të dhënat sensitive që dokumentet mbartin.
<b>Shkaku:</b>	Mos ushtrim i kujdesit të duhur ndaj dokumenti zyrtar.
<b>Rekomandimi:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Institucioni i ASH të marrë masat për mbajtjen e Regjistrin Modelar (në formë fizike) në kuadrin e një dokumenti zyrtar me një rëndësi të veçantë, i cili duhet të përshtatet dhe rregullohet sipas kërkesave dhe përcaktimeve të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, si dhe të hartohet e mbahet në përputhje me normat tekniko profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, për shkak të rëndësisë që ka ky dokument administrativ në këtë institucion shtetëror.</li> <li>- Nga ana e Avokaturës së Shtetit, të merren masa për plotësimin e dokumentacionit sipërcituar (databazë) në përputhje me kriteret e të qenurit dokument zyrtar.</li> </ul> <p>Të kryhet përshtatja dhe rregullimi sipas Ligjit nr.9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat” duke formatizuar dokumentin për shkak të rëndësisë që ai mbart.</p>
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Afati i zbatimit:</b>	Menjëherë.

➤ ***Mbi çështjet e shqyrtuara në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut***

Ligji nr.10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar, në nenin 9 të tij përcakton se, Avokatura e Shtetit përfaqëson mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtar, të cilat kryhen përmes zyrës përkatëse të përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhin.

Detyrat e kësaj zyre përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të institucionit.

Në Ligjin nr.10018 në nenin 19/1 përcaktohet se ... *Vendimet e formës së prerë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "GJEDNJ"), për çdo çështje ku Republika e Shqipërisë është palë, janë të detyrueshme për zbatim dhe ekzekutohen sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj.*

Në nenet 19/1 – 19/10 përcaktohet njohja e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Konkretisht neni 19/2 "Fillimi i procedurave të ekzekutimit" specifikon se ...

*1. Me marrjen dijeni mbi vendimin e formës së prerë, Avokatura e Shtetit, brenda 10 ditëve pune, përcjell vendimin përkatës për përkthim dhe certifikim pranë Ministrisë së Drejtësisë.*

*2. Ministria e Drejtësisë, brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës së Avokaturës së Shtetit, sipas pikës 1, të këtij neni, dërgon vendimin e përkthyer dhe të certifikuar për publikim në Qendrën e Botimeve Zyrtare, si dhe pranë Avokaturës së Shtetit, me qëllim ndjekjen e procedurave të mëtejshme të ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së.*

*3. Një kopje e vendimit origjinal dhe një kopje e përkthyer dhe e certifikuar nga Ministria e Drejtësisë dërgohet nga Avokatura e Shtetit pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe pran institucioneve të tjera, për efekt të zbatimit të njehsuar të praktikës gjyqësore.*

*4. Brenda 5 ditëve pune nga dërgimi i vendimit të përkthyer nga Ministria e Drejtësisë, sipas pikës 2, të këtij neni, Avokatura e Shtetit paraqet kërkesën pranë Kryeministrit për propozimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave, në lidhje me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, e cila duhet të përmbajë:*

*a) Institucionet që ngarkohen me ekzekutimin e vendimit, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë;*

*b) Llojin e masës që buron nga vendimi i GJEDNJ-së, apo masa të tjera të përshtatshme që duhet të ndërmerren nga autoritetet vendase, në rastet kur vendimi i GJEDNJ-së nuk përcakton në mënyrë të shprehur masat konkrete që duhet të merren nga Republika e Shqipërisë, në kuadër të shkeljeve të konstatuara;*

*c) Mënyrën dhe afatet e ekzekutimit të saj;*

*ç) Sanksionet në rast të mosekzekutimit.*

*5. Vendimi i Këshillit të Ministrave miratohet brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës së Avokaturës së Shtetit, sipas pikës 4 të këtij neni.*

Referuar nenit 17 të Rregullores së Brendshme specifikohet se:

*1. Pranë zyrës së përfaqësimit krijohet, administrohet dhe përditësohet regjistri i posaçëm fizik dhe elektronik i çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatave të huaja, ndërkombëtare apo arbitrazhit ndërkombëtar;*

*2. Regjistri do të plotësohet nga juristi zyrës i ngarkuar me këtë qëllim me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.*

Për periudhën objekt auditimi janë nxjerr dy urdhra për krijimin e tyre, konkretisht:

- Urdhër nr. 375/1 datë 21.10.2022 "Për miratimin e formatit të regjistrit të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të çështjeve në shqyrtim në GJEDNJ";

- Urdhër nr. 375/2 date 11.11.2022 "Për miratimin e formatit të regjistrit fizik dhe elektronik të çështjeve të arbitrazhit dhe përfaqësimit në gjykatat e huaja".

Të dy këto dokumente janë krijuar dhe plotësuar nga ana e personave përgjegjës.

- ✓ Për periudhën Janar – Dhjetor 2021, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka dalë me 13 vendime për Shqipërinë.

Nëpërmjet këtyre vendimeve GJEDNJ ka vendosur mospranimin në 5 vendime si dhe zgjidhjen e çështjes me marrëveshje miqësore dhe pranimin e 8 kërkesave.

Në vendimet në të cilat është pranuar shkelja dhe deklarata e zgjidhjes me pajtim, gjykata ka akorduar shpërblim të drejtë në vlerën 55.300 Euro ose 6,848,950 Lekë. Nga të cilat në total duke përfshirë dhe interesat e vonesës në ekzekutim, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë ekzekutuar të gjitha këto vendime në shumën prej 6,923,563 Lekë.

- ✓ Për periudhën Janar – Dhjetor 2022, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut shqyrtoi 116 kërkesa në lidhje me Shqipërinë, nga të cilat 107 ishin të papranueshme ose u nxorrën nga lista e gjykimit.

Gjatë kësaj periudhe, Gjykata ka dalë me 31 vendime për Shqipërinë, për 50 kërkesa. Nëpërmjet këtyre vendimeve, në 14 prej tyre GJEDNJ i ka shpallur kërkesat të papranueshme, në 8 vendime (për 9 kërkesa) i ka shpallur kërkesat të pranueshme nga të cilat ka vendosur se ka shkelje në 7 vendime dhe nuk ka shkelje në 1 vendim (N. H. k Sh.), në 5 vendime ka vendosur nxjerrjen e çështjeve jashtë listës së gjykimeve duke pranuar deklaratat e zgjidhjes me pajtim të nënshkruar nga palët dhe në 4 vendime ka vendosur nxjerrjen e çështjeve nga lista e gjykimit, duke qenë se kërkesit nuk kanë shprehur interes për ndjekjen e çështjes.

Në vendimet në të cilat është pranuar shkelja dhe deklarata e zgjidhjes me pajtim, gjykata ka akorduar shpërblim të drejtë në vlerën 60.100 Euro ose 7,206,470 Lekë. Nga të cilat në total, duke përfshirë dhe interesat e vonesës në ekzekutim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë ekzekutuar të gjitha këto vendime, në shumën prej 7,306,008 Lekë.

*Nenet e shkelura të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të cilat bëhen objekt padie:*

Vlerësohet se mesatarisht gjysma e kërkesave të paraqitura në gjykatë kanë të bëjnë me shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në përmbajtje të saj ka të drejtën për një proces të rregullt ligjor (44.81%). Aspekti kryesor i shkeljes së një procesi të rregullt ligjor ka të bëjë me tejzgjatjen e proceseve gjyqësore dhe mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Shkelje të tjera të konstatuara nga GJEDNJ janë edhe:

- mbrojtja e pronës 20.78% (neni 1 i Protokollit 1);
- e drejta për një mjet efektiv ankimi 19.88 % (neni 13);
- ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor/poshtërues 5.59% (neni 3);
- e drejta për liri dhe siguri 3.73% (neni 5);
- e drejta për respektim të jetës private dhe familjare 1.30% (neni 8);
- e drejta e jetës 1.24% (neni 2);
- nuk ka dënim pa ligj 0.62% (neni 7);

Në funksion të masave të përgjithshme dhe planeve të veprimit që Avokatura e Shtetit ka ndërmarrë për ekzekutimin e këtyre vendimeve, nga autoritetet shtetërore dhe institucionet përgjegjëse janë marrë masa ligjore dhe administrative për të adresuar këto problematika, të cilat janë cilësuar si probleme strukturore të sistemit të drejtësisë në Shqipëri dhe që një pjesë e tyre kanë të bëjnë dhe me reformën në drejtësi.

Përmenden këtu:

- Planin e Veprimit në kuadër të ekzekutimit të vendimit pilot të GJEDNJ, mbi çështjet e pronave “M. P. kundër Sh.” nëpërmjet të cilit u miratua mekanizmi i ri i kompensimit. Në saj të ndryshimeve ligjore të ndërmarra në kuadër të ekzekutimit të këtij plani, Gjykata Evropiane duke vlerësuar masat e ndërmarra nga autoritetet tona ka shpallur të papranueshme 281 kërkesa të paraqitura në GJEDNJ për çështjet e pronave.

- Sa i përket nenit 3 dhe 5 të Konventës përmendet “Plani i Veprimit për Ekzekutimin e Vendimit S. kundër Sh.”, “Plani i Veprimit për ekzekutimin e vendimit P. kundër Sh.”, “Plani i veprimit për ekzekutimin e vendimit “B. dhe të tjerë kundër Sh.”.
- Lidhur me nenin 2 të Konventës përmendet “Plani i Veprimit për Ekzekutimin e Vendimit Tërshana kundër Shqipërisë”.
- Lidhur me nenin 8 të Konventës përmendim “Plani i Veprimit në kuadër të ekzekutimit të vendimit Sharxhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.

*Ndryshimet në legjislacionin e brendshëm si pasojë e një vendimi të GJEDNJ-së:*

Përveç konstatimit të shkeljes dhe akordimit të shpërblimit të drejtë, në rastet kur GJEDNJ e vlerëson të nevojshme, mund të indikojë dhe marrjen e masave individuale shtesë, që synojnë rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura.

Këto masa përfshijnë veprime, të cilat mund të ndërmerren nga Avokatura e Shtetit së bashku me institucionet përgjegjëse për të rikthyer sa më shumë të jetë e mundur *statusin që mbante kërkuesi përpara cenimit të të drejtave të tij/saj* (restitutio in integrum).

Gjithashtu, Avokatura e Shtetit ka të drejtën të sugjerojë masa të përgjithshme parandaluese, në lidhje me ndryshimet e nevojshme të legjislacionit apo praktikave, të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin, si rezultat i shkeljes së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat përfshijnë ndryshime në legjislacionin në fuqi apo praktikën e zbatimit të tij.

Në këtë kontekst, vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut kanë çuar në ndërmarrjen e disa reformave të rëndësishme në Shqipëri, si vijon:

- a. **Në kuadër të çështjes “Xh. k. Sh.”**, përmenden amendimet në Kodin e Procedurës Penale që kanë të bëjnë me elementet e një procesi të rregullt ligjor në sferën penale si parashikimi i së drejtës së personave të gjykuar në mungesë për të kërkuar rishikim të vendimit dhe rihapje të procesit pas një vendimi që konstaton shkelje nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Ndryshimet ligjore për të forcuar të drejtat e të akuzuarit gjatë marrjes në pyetje dhe aksesin tek avokati që nga momenti i arrestimit, rregulla të qarta për identifikimin e personave ose sendeve, rregulla të forcuara për sigurimin e paraqitjes së dëshmitarëve etj.
- b. **Në kuadër të vendimit “L. k. Sh.”**, sa i përket çështjeve lidhur me nenin 6 të Konventës, janë ndërmarrë një sërë masash legjislative dhe administrative për të reduktuar tej zgjatjen e proceseve gjyqësore dhe ngarkesën e gjykatave:
  1. Ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile të cilat për herë të parë parashikuan një mjet të ri përshpejtues dhe kompensues ankimi, në rast të tej zgjatjes së proceseve gjyqësore (neni 399/1 i Kodit të Procedurës Civile).
  2. Masat administrative të marra nga Gjykata e Lartë apo Këshilli i Lartë Gjyqësor, në kuadër të reformës në drejtësi për të adresuar çështjen e backlogut (çështjeve të prapambetura) në disa gjykata, si shtimi i numrit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë dhe përcaktimi i rasteve kur çështjet duhet shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar.
- c. **Në kuadër të vendimeve “P. Ç. k. Sh.”**, një element që ka të bëjë sërish me nenin 6 të Konventës ka qenë dhe mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë. Në këtë kontekst janë ndërmarrë në zbatim të vendimeve të GJEDNJ një sërë masash që kanë të bëjnë me përmirësimin e situatës lidhur me zbatimin e vendimeve gjyqësore. Si për shembull:
  - Reformimi i shërbimit të përmbartimit për të siguruar zbatimin efektiv të vendimeve gjyqësore, si dhe strategjinë dhe planin e veprimit të miratuar nga Këshilli i Ministrave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të shtetit dhe respektimin e disiplinës financiare.

- Një ndër reformat më të rëndësishme të ndërmarra në kontekst të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ ka qenë përmirësimi i mbrojtjes së të drejtës së pronës me krijimin e një mekanizmi kompensimi për pronat e shtetëzuara gjatë regjimit ish-komunist.

Sfidat kryesore në këtë proces lidheshin me moszbatimin e vendimeve përfundimtare që njihnin të drejtën e kthimit ose kompensimit të pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist. Dështimi për një kohë të gjatë për të kompensuar ose rikthyer pronat e shtetëzuara gjatë regjimit komunist është identifikuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në grupin e çështjeve D. dhe në vendimin e saj pilot M. P. dhe të tjerë. Në funksion të këtij problemi strukturor dhe në përgjigje të vendimit të Gjykatës Evropiane, më 24 prill 2014, autoritetet shqiptare miratuan një plan veprimi që synonte një skemë efektive kompensimi. Në bazë të planit të veprimit, u hartua ligji “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Ligji i cili është miratuar nga më 5 dhjetor 2015 dhe ka hyrë në fuqi më 24 shkurt 2016.

Masat e marra nga autoritetet shqiptare për të adresuar çështjen e kthimit dhe kompensimit të pronave u vlerësuan nga GJEDNJ në tre vendimet e fundit për të drejtat e pronësisë. “B. kundër Sh.” 2020, “Gj. dhe të tjerët kundër Sh. 2020” dhe “R. kundër Sh.” 2021.

**✚ Lidhur me veprimtarinë e GJEDNJ-së nga auditimi dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se,**

- Sa i përket çështjeve **të likujduara** për vitin 2021-2022 referuar ekzekutimit të vendimeve përfundimtare të GJEDNJ për vitet 2021-2022, rezulton si më poshtë vijon:

Nr.	Titulli	Data e vendimit përfundimtar	Data brenda së cilës duhet të paguhej detyrimi	Shpërbli mi drejtë akorduar nga Gjykata në Euro	Shuma e Ekzekutuar në Leke	Interesat në Leke	Totali i paguar në Leke	Statusi aktual	Ekzekutim
1	B. K. Sh.	04.02.2021	04.05.2021	10,700	1,313,960	37,790	1,351,750	Likujduar	28.02.2022
2	Sh. dhe Gj. K. Sh.	23.09.2021	23.12.2021	4,600	568,950	0	568,950	Likujduar	06.12.2021
3	M. K. Sh.	05.10.2021	05.01.2022	5,000	622,000	0	622,000	Likujduar	03.02.2022
4	N. K. Sh.	28.10.2021	28.01.2022	2,300	286,580	0	286,580	Likujduar	21.01.2022
5	Zh. K. Sh.	28.10.2021	28.01.2022	2,300	286,580	6,900	293,480	Likujduar	21.01.2022
6	Z. K. Sh.	09.12.2021	09.03.2022	14,000	1,777,500	21,208	1,798,708	Likujduar	20.07.2022
7	B. dhe K. K. Sh.	12.10.2021/ 28.02.2022	12.04.2022/ 28.05.2022	5,900	294,480 (Bara) 429,450 (Kola)	0 (Bara)  803 (Kola)	294,480 (Bara) 430,253 (Kola)	Likujduar	24.05.2022 16.06.2022
8	L. K. Sh.	19.10.2021	19.04.2022	10,500	1,269,450	7,912	1,277,362	Likujduar	16.06.2022
9	T. K. Sh.	04.11.2020	04.02.2021	14,720	1,812,774	32,797	1,845,571	Likujduar	04.03.2021
	<b>2021</b>			<b>70,020</b>	<b>8,661,724</b>	<b>107,410</b>	<b>8,769,134</b>		
	<b>Pagesa Vogli</b>					<b>1,065,750</b>	<b>1,065,750</b>		
10	Sh. dhe të tjerë k. Sh.								
	<b>Total 2021</b>			<b>70,020</b>	<b>8,661,724</b>	<b>1,173,160</b>	<b>9,834,884</b>		
1	L. dhe të tjerë K. Sh.	29/09/2022	29.12.2023	3,850	464,695	745	464,695	Likujduar	30.12.2022
2	H. K.Sh.	15/09/2022	15.12.2022	1,450	246,000		246,000	Likujduar	07.11.2022
3	B. dhe të tjerë K. Sh.	14/06/2022	14.09.2022	13,500	1,603,800	7,909	1,611,709	Likujduar	20.10.2022
4	X dhe të tjerë K. Sh.	31/05/2022	31.08.2022	22,500	2,605,500	41,115	2,646,615	Likujduar	30.12.2022
5	B. K.Sh.	05/05/2022	05.08.2022	1,200	143,880		143,880	Likujduar	24.08.2022

6	S. K.Sh.	05/05/2022	05.08.2022	5,000	600,000		600,000	Likujduar	26.08.2022
7	P. K.Sh.	05/05/2022	05.08.2022	2,500	299,750		299,750	Likujduar	24.08.2022
8	K. K.Sh.	10/03/2022	10.06.2022	5,000	613,500		613,500	Likujduar	16.06.2022
9	P. K.Sh.	24/02/2022	24.05.2022	2,350	288,345		288,345	Likujduar	26.05.2022
10	M. I.	13.01.2022	13.04.2022	2,750	341,000	0	341,000	Likujduar	15.04.2022
	<b>Total 2022</b>			<b>60,100</b>	<b>7,206,470</b>	<b>49,769</b>	<b>7,256,239</b>		
	<b>Total 2021+2022</b>			<b>130,120</b>	<b>15,868,194</b>	<b>1,222,929</b>	<b>17,091,123</b>		

Burimi: Avokatura e Shtetit, përpunoi Grupi Auditimit

*Shënim:* Vendimi “Sh. k. Sh.”, ka pasur 12 kërkesa për të cilat është akorduar shpërblim për 10 prej tyre, (përpara viteve 2021-2022) dhe ka vendosur ekzekutimin e vendimit vendas për 2 kërkesa “M.” dhe “V.”. Të dyja këto kërkesa janë pa vlerë financiare nga Gjykata.

Nga auditimi rezulton se,

- për vitin 2021 referuar të dhënave nga Avokatura e Shtetit, nga ana e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut janë nxjerrë vendime në disfavor të Republikës së Shqipërisë vlera e të cilave shkon 70.020 Euro, për efekt dëmshpërblimi për të cilat nga buxheti shtetit janë paguar 9,384,884 lekë ku principali ka qenë në vlerën 8,661,724 lekë dhe interesi nga vonesa e pagesave në vlerën 1,173,160 lekë.

Kursi këmbimit i përdorur për efekt konvertimi ka qenë mesatarisht 123,85Euro/all.

- për vitin 2022 referuar të dhënave nga Avokatura e Shtetit, nga ana e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut janë nxjerrë vendime në disfavor të Republikës së Shqipërisë vlera e të cilave shkon 60.100 Euro për efekt dëmshpërblimi, për të cilat nga buxheti shtetit janë paguar 7,256,239 lekë ku principali ka qenë në vlerën 7,206,470 lekë dhe interesi nga vonesa e pagesave në vlerën 49.769 lekë.

Në vijim të sa më sipër, janë zgjidhur me **mirëkuptim 8 çështje të gjitha me vlerë më të vogël se 10.000 Euro** paguar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave pa Vendim të Këshillit të Ministrave:

lekë

Titulli	Ekzekutuar/Vlera
M. I. kundër Sh.	341.000
P. P. kundër Sh.	288.345
A. K. kundër Sh.	613.500
E. B. kundër Sh.	143.880
R. P. kundër Sh.	299.750
S. kundër Sh.	600.000
H. kundër Sh.	246.000
L. kundër Sh.	464.695
<b>Totali</b>	<b>2,997,170</b>

Burimi: Avokatura e Shtetit, përpunoi Grupi i Auditimit

Totali i zgjidhjeve me mirëkuptim rezulton ti ketë kushtuar buxhetit të shtetit rreth 2,997,915 lekë nga 24,100 Euro (2,988,400 lekë) të akorduara sipas shpërblimit të drejtë nga GJEDNJ.



Detyrimet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së mbulohen nga buxheti i shtetit, sipas përcaktimeve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së referuar Ligjit nr.10018, nenit 19/1 të tij.

Sa i takon afatit të ekzekutimit të vendimeve, në referencë të nenit 19/4 “*Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse të Vendimeve të GJEDNJ-së*” që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë.

Nga auditimi u konstatua se, sa i takon afatit të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së jo në të gjithë rastet është zbatuar afati 3 mujor i përcaktuar në zbatim të nenit 19/4 “*Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse të Vendimeve të GJEDNJ-së*”, konkretisht:

- ✓ për vitin 2021 janë 6 raste të ekzekutuara me vonesë;
- ✓ për vitin 2022 janë 6 raste të ekzekutuara me vonesë.

Sa i takon shkaqeve që kanë çuar në këto vonesa, të cilat përkthehen në interesa që i shtohen vlerës së principalit e për rrjedhim penalitete në disfavor të buxhetit të shtetit u analizua situata e cila paraqitet si më poshtë trajtohet.

### ***Pagesa e dëmeve/kompensive***

✚ Nga ana e grupit të auditimit u krye klasifikimi i detyrimeve në referencë dhe mbështetje të Ligjit 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, nenit 19/5 “Pagesa e dëmeve/kompensimeve”, pika 2 ku specifikohet se ...2. *Përrjashtimisht, për detyrimet financiare deri në 10 000 (dhjetë mijë) Euro, pagesa ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ministria përgjegjëse për financat, pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit.*

Ku nga 19 çështjet e evidentuara në tabelën e mësipërme, (19 janë ato çështje të cilat rezultojnë me vlerë financiare pasi 1 prej tyre, konkretisht vendimi “*Sh. k. Sh.*”, është pa vlerë financiare nga Gjykata), rezultoi se për 13 prej tyre pagesa ekzekutohet drejtpërdrejt nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe 6 çështje të tjera kalonte procedura me nxjerrje të VKM respektive.

#### ***A. Çështjet që kalojnë me nxjerrje/miratim të VKM:***

-Për periudhën Janar – Dhjetor 2021, Këshilli i Ministrave ka miratuar një VKM në zbatim të vendimeve të GJEDNJ-së, me një vlerë totale pricipali prej 14,720 Euro, konkretisht:

- ✓ *Është miratuar VKM nr. 78 datë 10.02.2021 për çështjen T. k. Sh.” (kërkesa nr.48756/14) ekzekutimi i vendimit sa i përket pagesës së shpërblimit të drejtë për këtë vendim.*

*Pika 5 e VKM specifikon se ... Mbi shumën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, duke filluar nga data 05.02.2021 deri në ekzekutim do të paguhet interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huas së BQE, gjatë periudhës së mospagimit plus 3%.*

Vlera e paguar prej buxhetit të shtetit ka qenë 1,845,571 lekë, duke përfshirë interesat e krijuara për shkak të vonesës, prej 32,797 lekë

***Konstatim:*** *VKM ka dal në afat më të vonë se afati maksimal i ekzekutimit të detyrimit financiar.*

-Për periudhën Janar – Dhjetor 2022, Këshilli i Ministrave ka miratuar pesë VKM në zbatim të vendimeve të GJEDNJ-së, me një vlerë totale prej 71,200 Euro, konkretisht:

- ✓ *VKM nr.29, datë 19.01.2022 “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 12.01.2021, për çështjen ‘B. kundër Sh.’” (kërkesa nr.75763/17),*

*Pika 5 e VKM specifikon se ... Mbi shumën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, duke filluar nga data e vendimit plus 3 muaj, deri në ekzekutim do të paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huas së BQE, gjatë periudhës së mospagimit plus 3%.*

**Konstatim:** VKM ka dal në afat më të vonë se afati maksimal i ekzekutimit të detyrimit financiar. Vlera e paguar prej buxhetit të shtetit ka qenë 1,351,750 lekë, duke përfshirë interesat e krijuara për shkak të vonesës, prej 37,790 lekë

✓ VKM nr. 290, datë 11.05.2022 “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 19.10.2021, për çështjen ‘L. kundër Sh.’” (kërkesa nr.28142/17)

*Pika 5 e VKM specifikon se ... Mbi shumën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, duke filluar nga data 19.01.2022 deri në ekzekutim do të paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huas së BQE, gjatë periudhës së mospagimit plus 3%.*

**Konstatim:** VKM ka dal në afat më të vonë se afati maksimal i ekzekutimit të detyrimit financiar. Vlera e paguar prej buxhetit të shtetit ka qenë 1,277,362 lekë, duke përfshirë interesat e krijuara për shkak të vonesës, prej 7,912 lekë

✓ VKM nr. 369, datë 01.06.2022 “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 09.12.2021, për çështjen ‘F. Z. kundër Sh.’” (kërkesa nr.45022/16),

*Pika 5 e VKM specifikon se ... Mbi shumën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, duke filluar nga data 09.03.2022 deri në ekzekutim do të paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huas së BQE, gjatë periudhës së mospagimit plus 3%.*

**Konstatim:** VKM ka dal në afat më të vonë se afati maksimal i ekzekutimit të detyrimit financiar. Vlera e paguar prej buxhetit të shtetit ka qenë 1,798,708 lekë, duke përfshirë interesat e krijuara për shkak të vonesës, prej 21,208 lekë

✓ VKM nr. 760, datë 12.12.2022 “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.05.2022, për çështjen ‘X. kundër Sh.’” (kërkesa nr.73548/17),

*Pika 5 e VKM specifikon se ... Mbi shumën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, duke filluar nga data 31.08.2022 deri në ekzekutim do të paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huas së BQE, gjatë periudhës së mospagimit plus 3%.*

**Konstatim:** VKM ka dal në afat më të vonë se afati maksimal i ekzekutimit të detyrimit financiar. Vlera e paguar prej buxhetit të shtetit ka qenë 12,646,615 lekë, duke përfshirë interesat e krijuara për shkak të vonesës, prej 41,115 lekë

**Konstatim:** VKM ka dal në afat më të vonë se afati maksimal i ekzekutimit të detyrimit financiar.

✓ VKM nr. 586, datë 07.09.2022 “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.05.2022, për çështjen ‘B. kundër Sh.’” (kërkesa nr.14800/18),

*Pika 5 e VKM specifikon se ... Mbi shumën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, duke filluar nga data 31.08.2022 deri në ekzekutim do të paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huas së BQE, gjatë periudhës së mospagimit plus 3%.*

**Konstatim:** VKM ka dal në afat më të vonë se afati maksimal i ekzekutimit të detyrimit financiar.

**Konstatim:** VKM ka dal në afat më të vonë se afati maksimal i ekzekutimit të detyrimit financiar. Vlera e paguar prej buxhetit të shtetit ka qenë 1,611,709 lekë, duke përfshirë interesat e krijuara për shkak të vonesës, prej 7,909 lekë.

**Konstatim:** Për shkak se prej Avokaturës së Shtetit nuk kryhet llogaritja e vlerave respektive të interesave për tejkalim të afateve të likuidimit/ekzekutimit, grupi i auditimit i është referuar vlerave të likuidimit rast pas rasti.

✚ për 6 çështjet që kalojnë me VKM u konstatuan këto raste vonesash:

<i>Titulli/çështja</i>	<i>Data e vendimit përfundimtar</i>	<i>Data brenda së cilës duhet të paguhej detyrimi</i>	<i>Data kur ka dal VKM</i>	<i>Data kur është ekzekutuar detyrimi</i>	<i>Vonesa</i>
B. K. Sh.	04.02.2021	04.05.2021	19.01.2022	28.02.2022	9.5 muaj
Z. K. Sh.	09.12.2021	09.03.2022	01.06.2022	20.07.2022	4 muaj
L. K. Sh.	19.10.2021	19.04.2022	11.05.2022	16.06.2022	2 muaj
X. K. Sh.	31.05.2022	31.08.2022	12.12.2022	30.12.2022	1 muaj
T. K. Sh.	04.11.2020	04.02.2021	10.02.2021	04.03.2021	6 ditë

*Burimi: Avokatura e Shtetit, përpunoi Grupi i Auditimit*

Nga auditimi i praktikave lidhur me çështjet ku në vendimet e formës së prerë nxjerr nga GJEDNJ është akorduar shpërblim i drejtë me vlerë principali mbi vlerën 10,000 (dhjetë mijë) Euro, dhe rrjedhimisht pagesa tyre ekzekutohet përmes nxjerrjes së një VKM përkatëse pas njoftimit nga ana e Avokaturës së Shtetit, rezultoi se,

- ✓ Për 5 nga 6 çështje këto ekzekutime janë kryer me vonesë që ka ardhur si rrjedhojë e nxjerrjes së Vendimit të Këshillit të Ministrave në tejkalim të afateve kohore të vendosura në Vendimin e GJEDNJ-së dhe impakti financiar total referuar interesave të shkaktuara prej vonesave rezultojnë rreth 148,731 lekë respektivisht:
  - për 2021 vlera totale e interesave 32,797 lekë;
  - për 2022 vlera totale e interesave 108,025 lekë.
- ✓ Për 1 çështje ekzekutimi është kryer me vonesë për shkak të likuidimit të kryer me vonesë nga ana e MEF-së dhe impakti financiar total referuar interesave të shkaktuara prej kësaj vonese rezultojnë rreth 7,909 lekë.

#### **4. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i praktikave lidhur me ato çështje ku në vendimet e formës së prerë, nxjerrë nga GJEDNJ është caktuar shpërblim i drejtë me vlerë principale **mbi vlerën 10,000 (dhjetë mijë) Euro**, pagesa e të cilave ekzekutohet përmes nxjerrjes së VKM-së përkatëse pas njoftimit nga ana e Avokaturës së Shtetit, rezultoi se, për 5 nga 6 vendime, këto ekzekutime janë kryer me vonesë dhe impakti financiar në trajtën e interesave të shkaktuara nga vonesat ka qenë rreth **148,731 lekë** respektivisht:

- ✓ *Në 5 (pesë) raste*, për shkak se Vendimet e Këshillit të Ministrave kanë dalë përtej afatit të cituar në vendimin e formës së prerë të Gjykatës Ndërkombëtare, që ka përcaktuar datën finale për tu ekzekutuar vlera financiare prej 140,822 lekë, (megjithëse nga ana e ASH shkresat janë nisur në përputhje të afateve kohore të caktuara) dhe;
- ✓ *Në 1 (një) rast*, vonesa është shkaktuar si rrjedhojë e MFE-së, pra ekzekutimi i vlerës ka ndodhur me vonesë, (me vlerë totale prej 7,909 lekë).

<b>Titulli i gjetjes 4:</b>	<i>Pagesa e detyrimeve ekzekutohet përmes nxjerrjes së një VKM</i>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i praktikave lidhur me ato çështje ku në vendimet e formës së prerë, nxjerrë nga GJEDNJ është caktuar shpërblim i drejtë me vlerë principale <b>mbi vlerën 10,000 (dhjetë mijë) Euro</b> , pagesa e të cilave ekzekutohet përmes nxjerrjes së VKM-së përkatëse pas njoftimit nga ana e Avokaturës së Shtetit, rezultoi se, për 5 nga 6 vendime, këto ekzekutime janë kryer me vonesë dhe impakti financiar në trajtën e interesave të shkaktuara

	nga vonesat ka qenë rreth <b>148,731 lekë</b> respektivisht: <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Në 5 (pesë) raste, për shkak se Vendimet e Këshillit të Ministrave kanë dalë përtej afatit të cituar në vendimin e formës së prerë të Gjykatës Ndërkombëtare, që ka përcaktuar datën finale për tu ekzekutuar vlera financiare prej 140,822 lekë, (megjithëse nga ana e ASH shkresat janë nisur në përputhje të afateve kohore të caktuara) dhe;</li> <li>✓ Në 1 (një) rast, vonesa është shkaktuar si rrjedhojë e MFE-së, pra ekzekutimi i vlerës ka ndodhur me vonesë, (me vlerë totale prej 7,909 lekë).</li> </ul>
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr.10018 datë 13.11.2018 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar;</li> <li>- Vendim i GJEDNJ-së dhe VKM nr. 760, datë 12.12.2022 për kërkesën nr.75763/17 çështja ‘X kundër Sh.’</li> <li>- Vendim i GJEDNJ-së dhe VKM nr. 290, datë 11.05.2022 për kërkesën nr. 28142/17çështja ‘L kundër Sh..’</li> <li>- Vendim i GJEDNJ-së dhe VKM nr. 78 datë 10.02.2021 për kërkesën nr. 45756/14 çështja ‘T kundër Sh.’</li> <li>- Vendim i GJEDNJ-së dhe VKM nr. 29 datë 19.01.2021 për kërkesën nr. 75763/17 çështja ‘B kundër Sh.’</li> <li>- Vendim i GJEDNJ-së dhe VKM nr. 369, datë 01.06.2022 për kërkesën nr. 45022/16 çështja ‘F Z kundër Sh.’</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Impakt financiar në trajtën e interesave të shkaktuara nga vonesat që rrit peshën e efekteve negative në buxhetin e shtetit.
<b>Shkaku:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- VKM respektive nxjerr përtej afatit të cituar në vendimin e formës së prerë si datë finale për tu ekzekutuar vlera financiare si dhe</li> <li>- Ekzekutimi vlerave financiare përtej afatit.</li> </ul>
<b>Rekomandimi:</b>	Avokatura e Shtetit, në koordinim dhe bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, si Këshilli Ministrave, Ministria për Ekonominë dhe Financat etj., të marrin masa për njohjen dhe zbatimin e Vendimeve të nxjerra nga gjykatat e huaja ndërkombëtare, konkretisht nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, vendime që janë të detyrueshme për zbatim dhe të ekzekutohen sipas procedurës së parashikuar në ligj dhe brenda afateve kohore të shprehura në këto vendime, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë në ngarkim të buxhetit të shtetit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Afati i zbatimit:</b>	Menjëherë dhe në vijimësi.

*Detajuar:*

*1. B. k. Shqipërisë (kërkesa nr.75763/17)*

- Me shkresën nr.355/10 datë 25.06.2020 është kërkuar shtyrje afati për shkak të kushteve të pandemisë, drejtuar ASH nga F.. B.. përfaqësuar nga Studio C. L. Firm;
- Me shkresën nr.355/23 datë 04.02.2021 është dërguar Vendimi në ASH;
- Me shkresën nr.355/24 datë 10.02.2021 është dërguar nga ASH kërkesa për përkthim në Ministri të Drejtësisë;

- Me shkresën nr.355/27 datë 12.03.2021 është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në Kryeministri, bashkangjitur relacioni me draft Projektvendim.

*Konstatim: Referuar dokumentacionit vendimi është bërë përfundimtar në datë 12.01.2021 dhe data brenda së cilës duhej paguar detyrimi (afati 3 mujor) rezulton data 12.04.2021. Sikundër specifikuar edhe në VKM.*

- VKM nr. 29 datë 19.01.2022 ekzekutimi i vendimit sa i përket pagesës së shpërblimit të drejtë për këtë vendim.

Titulli/çështja	Data e vendimit përfundimtar	Data brenda së cilës duhet të paguhej detyrimi	Data kur ka dal VKM	Data kur është ekzekutuar detyrimi	Vonesa
B. K Sh.	04.02.2021	04.05.2021	19.01.2022	28.02.2022	9.5 muaj
Vendimi B.	12.01.2021	12.04.2021			

Burimi: Avokatura e Shtetit, përpunoi Grupi i Auditimit

*Konstatim: Vlen të theksohet se, praktikat dokumentare përmbanin vetëm draft Vendimin e KM dhe jo VKM eksplicite të rastit.*

#### 2. Z.k. Sh. (45022/16)

- Vendimi është bërë final në datën 09.12.2021 ka dal VFP dhe duhet të ekzekutohej brenda datës 09.03.2022.

- Me shkresën nr.445 datë 02.02.2022 është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në Kryeministri.

*Konstatim: Mungon shkresa përcjellëse dërguar nga ASH kërkesa për përkthim në Ministri të Drejtësisë.*

- VKM nr. 369 datë 01.06.2022 ekzekutimi i vendimit sa i përket pagesës së shpërblimit të drejtë për këtë vendim.

#### 3. L. k. Sh. (28142/17)

- Vendimi është bërë final në datën 19.10.2021 ka dal VFP dhe duhet të ekzekutohej brenda datës 19.01.2022.

- Me shkresën nr.319/1 datë 02.02.2022 është dërguar nga ASH kërkesa për përkthim në Ministri të Drejtësisë.

- Me shkresën nr.319/4 datë 01.03.2022 është dërguar nga ASH kërkesa për ekzekutim të vendimit në Kryeministri, bashkangjitur relacioni me draft Projektvendim.

- Me shkresën nr.319/12 datë 30.06.2022 është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në MFE.

- Me shkresën nr.2791/4 datë 12.10.2022 është dërguar nga ASH dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në Kryeministri.

- VKM nr. 290 datë 11.05.2022 ekzekutimi i vendimit sa i përket pagesës së shpërblimit të drejtë për këtë vendim.

#### 4. X. k. Sh. (73548/17)

- Vendimi është bërë final në datën 31.05.2022 ka dal VFP dhe duhet të ekzekutohej brenda datës 31.08.2022.

- Me shkresën nr.2790/1 datë 15.09.2022 është dërguar nga ASH kërkesa për përkthim në Ministri të Drejtësisë.

- Me shkresën nr.2790/5 datë 19.10.2022 është dërguar nga ASH kërkesa për ekzekutim të vendimit në Kryeministri.

*Konstatim: Mungon shkresa përcjellëse e kërkesës për ekzekutim të vendimit në MFE.*

- Me shkresën nr.2790/4 datë 17.10.2022 është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në Kryeministri, bashkangjitur relacioni me draft Projektvendim.

- VKM nr. 760, datë 12.12.2022 ekzekutimi i vendimit sa i përket pagesës së shpërblimit të drejtë për këtë vendim.

#### 5. "T. k. Sh." (kërkesa nr.48756/14)

- Vendimi është bërë final në datën 04.11.2020 dhe duhet të ekzekutohej brenda datës 04.02.2021.

- Me shkresën nr.4421/1 datë 05.11.2020 është dërguar nga ASH kërkesa për përkthim në Ministri të Drejtësisë.

- Me shkresën nr.4421/4 datë 24.11.2020 është dërguar nga ASH kërkesa për ekzekutim të vendimit në Kryeministri.

- VKM nr. 78 datë 10.02.2021 ekzekutimi i vendimit sa i përket pagesës së shpërblimit të drejtë për këtë vendim.

#### 6. I. V. k. Sh. (kërkesa nr.48756/14)

- Vendimi "V. kundër Sh.", datë 15.10.2013 dhe është ekzekutuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë datë 04.08.2014, në vlerën totale 1,065,750 ALL (kursi i këmbimit ka qenë 142.1 Lekë).

*Duke qenë se nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk ishin paguar interesat mbi këtë çështje, Avokatura e Shtetit me ndryshimin e ligjit organik të saj paraqiti kërkesë për pagesën e interesave nga ana e MFE, duke qenë se çështja rezultonte e pa ekzekutuar Pranë Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës.*

Në datën 16.11.2021, MFE ka bërë ekzekutimin e interesave në shumë 15.313 lekë.

### **B. Çështjet që kalojnë me ekzekutim të drejtpërdrejtë nga MFE:**

*Ndërkohë, MFE ka ekzekutuar:*

- ✓ 1 vendim të GJEDNJ-së për vitin 2021 vlerat përkatëse të të cilave janë nën 10.000 Euro. Totali i pagesave për këto vendime rezulton në vlerën 568,950 lekë.
- ✓ 11 vendime të GJEDNJ-së për vitin 2022 vlerat përkatëse të të cilave janë nën 10.000 Euro. Totali i pagesave për këto vendime rezulton në vlerën 4,923,963 lekë.

✚ Për rastet që kalojnë me procedurë nga MFE:

- për 12 çështjet totale (viti 2021-2022) ku vlera e detyrimit financiar ishte deri 10 mijë Euro dhe ekzekutoheshin drejtpërdrejt nga MFE u konstatuan vonesa në 8 raste.

Titulli/çështja	Data e vendimit përfundimtar	Data brenda së cilës duhet të paguhej detyrimi	Data kur është ekzekutuar detyrimi	Vonesa
M. K. Sh.	05.10.2021	05.01.2022	03.02.2022	4 javë
B. & K. K. Sh.	12.10.2021	12.04.2022	24.05.2022 16.06.2022	6 javë 9 javë
B. K.Sh.	05.05.2022	05.08.2022	24.08.2022	3 javë

S. K. Sh.	05.05.2022	05.08.2022	26.08.2022	3 javë
P. K. Sh.	05.05.2022	05.08.2022	24.08.2022	3 javë
K. K. Sh.	10.03.2022	10.06.2022	16.06.2022	6 ditë
P. K. Sh.	24.02.2022	24.05.2022	26.05.2022	1 ditë
M. I.	13.01.2022	13.04.2022	15.04.2022	2 ditë

Burimi: Avokatura e Shtetit, përpunoi Grupi i Auditimit

### Detajuar:

#### 1. M. k. Sh. (kërkesa nr.616/16)

- Me shkresën nr.152/20 datë 12.11.2021 është dërguar nga A.SH kërkesa për përkthim në Ministri të Drejtësisë;
- Me shkresën nr.592/1 datë 01.12.2021 është dërguar përkthimi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, bashkangjitur vendimi i përkthyer;
- Me shkresën nr.152/23 datë 15.12.2021 nga A.SH është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në MFE.

#### 2. B. dhe K. k. Sh. (kërkesa nr.43391/18 dhe 17766/19)

- Me shkresën nr.180 prot., datë 12.10.2022 GJEDNJ ka dal me Vendim të Formës së Prerë;
- Me shkresën nr.180/4 prot., datë 15.03.2022 dërguar nga A.SH kërkesa për përkthim në Ministri të Drejtësisë; (viti bërë 2021 dhe më pas korrektuar me stilolaps 2022);
- Me shkresën nr.180/6 prot., datë 13.04.2022 është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në MFE.

*Përditësim:* Në lidhje me ekzekutimin e vendimit "B.. dhe K.. k. Sh..", Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në datën 12.10.2021 ka publikuar vendimin "B.. dhe K.. k. Sh.." kërkesa nr. 43391/18 dhe 17766/19. Ky vendim është bërë përfundimtar në datën 28.02.2022, sepse nga ana e A.SH është bërë ankim në Dhomën e Madhe (datë 12.01.2022), ankim i cili nuk është pranuar në datë 28.02.2022.

Bazuar në nenin 44/2 të Konventës, ky vendim bëhet i formës së prerë në këtë datë (28.02.2022). Afati për ekzekutimin financiar të tij është data 28.08.2022.

#### 3. B. k. Sh. (kërkesa nr.10893/09)

- Me shkresën nr.256/2 prot., datë 01.06.2022 është dërguar nga A.SH kërkesa për përkthim në Ministri të Drejtësisë;
- Me shkresën nr.256/4 prot., datë 23.06.2022 është dërguar përkthimi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë "Mbi publikimin e vendimeve të GJENDNJ-së, çështjet B., S., P..";
- Me shkresën nr.3223 prot., datë 23.08.2022 është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në MFE.

#### 4. P. k. Sh. (kërkesa nr.1235/1)

- Me shkresën nr.1235/1 prot., datë 30.03.2022 është dërguar nga A.SH kërkesa për përkthim në Ministri të Drejtësisë;
- Me shkresën nr.1772/1 prot., datë 20.04.2022 është dërguar përkthimi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë "Mbi publikimin e vendimeve të GJENDNJ-së, çështjen P..";
- Me shkresën nr.1235/3 prot., datë 28.04.2022 është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në MFE.

5. *P. k. Sh. (kërkesa nr.20127/16)*

- Me shkresën nr.1235/1 prot., datë 30.03.2022 është dërguar nga A.SH kërkesa për përkthim në Ministri të Drejtësisë;
- Me shkresën nr.256/4 prot., datë 23.06.2022 është dërguar përkthimi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë “Mbi publikimin e vendimeve të GJENDNJ-së, çështjen P.”;
- Me shkresën nr.1235/3 prot., datë 28.04.2022 është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në MFE;
- Me shkresën nr.3223 prot., datë 23.08.2022 është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në MFE (P., S., B.).

6. *M. I. k. Sh. (kërkesa nr.7469/17)*

- Me shkresën nr.326/1 prot., datë 01.02.2022 është dërguar nga A.SH kërkesa për përkthim në Ministri të Drejtësisë;
- Me shkresën nr.614/1 prot., datë 17.02.2022 është dërguar përkthimi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë “Mbi publikimin e vendimeve të GJENDNJ-së, çështjen M. I.”;
- Me shkresën nr.326/3 prot., datë 25.01.2022 dërguar është kërkesa për ekzekutim të vendimit në MFE.

7. *S. k. Sh. (kërkesa nr.60275/10)*

- Me shkresën nr.326/1 prot., datë 01.02.2022 është dërguar nga A.SH kërkesa për përkthim në Ministri të Drejtësisë;
- Me shkresën nr.256/4 prot., datë 23.06.2022 është dërguar përkthimi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë “Mbi publikimin e vendimeve të GJENDNJ-së, çështjen S.”;
- Me shkresën nr.326/3 prot., datë 25.01.2022 është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në MFE.
- Me shkresën nr.3223 prot., datë 23.08.2022 është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në MFE (P., S., B.).

8. *K. k. Sh. (kërkesa nr.62986/09)*

- Me shkresën nr.255/4 prot., datë 13.04.2022 është dërguar nga A.SH kërkesa për përkthim në Ministri të Drejtësisë;
- Me shkresën nr.2125/1 prot., datë 27.04.2022 është dërguar përkthimi nga ana e Ministrisë së Drejtësisë “Mbi publikimin e vendimeve të GJENDNJ-së, çështjen K.”;
- Me shkresën nr.255/6 prot., datë 10.05.2022 është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në MFE.

**5. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i praktikave gjyqësore, ku vlera e detyrimit financiar të vendosur në trajtën e shpërblimit të drejtë me vendim të GJEDNJ-së ishte **deri 10 mijë Euro**, pagesa e të cilave ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ministria përgjegjëse për financat (MFE) pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit, u konstatuan 2 raste të ekzekutimit të vlerave me penalitete, në shumën **7,703 lekë**, ku pavarësisht se likuidimi është kryer brenda afatit maksimal brenda së cilit duhet të paguhej detyrimi (*vendosur nga GJEDNJ*), rasti ka marr penalitet në trajtën e interesit i cili rezulton të jetë 6,900 lekë (*Zh.. k. Sh..*) dhe në një rasti vonesa është krijuar për shkak të likuidimit të kryer pas përfundimit të afatit brenda të cilit duhej shlyer dhe vlera totale (*K. k. Sh.*), në kundërshtim me



përcaktimet e nenit 19/5 “Pagesa e dëmeve/kompensimeve”, pika 2, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

<b>Titulli i gjetjes 5:</b>	<i>Pagesa e detyrimeve ekzekutohet drejtpërdrejt nga MEF</i>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i praktikave gjyqësore, ku vlera e detyrimit financiar të vendosur në trajtën e shpërblimit të drejtë me vendim të GJEDNJ-së ishte <b>deri 10 mijë Euro</b> , pagesa e të cilave ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ministria përgjegjëse për financat (MFE) pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit, u konstatuan 2 raste të ekzekutimit të vlerave me penalitete, në shumën <b>7,703 lekë</b> , ku pavarësisht se likuidimi është kryer brenda afatit maksimal brenda së cilit duhet të paguhej detyrimi ( <i>vendosur nga GJEDNJ</i> ), rasti ka marr penalitet në trajtën e interesit i cili rezulton të jetë 6,900 lekë ( <i>Zh. k. Sh.</i> ) dhe në një rasti vonesa është krijuar për shkak të likuidimit të kryer pas përfundimit të afatit brenda të cilit duhej shlyer dhe vlera totale ( <i>K. k. Sh.</i> ), në kundërshtim me përcaktimet e nenit 19/5 “Pagesa e dëmeve/kompensimeve”, pika 2, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.
<b>Kriteri:</b>	- Ligji nr.10018 datë 13.11.2018 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar; - Vendim i GJEDNJ-së për kërkesën nr.43391/18 dhe 17766/19; - Vendim i GJEDNJ-së për kërkesën nr.3824/16.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Impakt financiar në trajtën e interesave që rëndon buxhetin e shtetit.
<b>Shkaku:</b>	Likuidimi i kryer pas përfundimit të afatit brenda të cilit duhej shlyer.
<b>Rekomandimi:</b>	Në kuadër të detyrimit të institucioneve shtetërore për njoftimin e Avokaturës së Shtetit, të kërkojë nga institucionet përgjegjëse shtetërore, ministri dhe institucione varsie etj., jo më vonë se një muaj nga momenti kur ngarkohen për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, në bazë të nenit 19/6, pika 2 e ligjit organik për Avokaturën e Shtetit, të informohet në përputhje me ligjin , lidhur me faktin nëse: a) ekzekutimi po kryhet brenda afateve ligjore; b) procesi i ekzekutimit është bllokuar, duke shpjeguar arsyet, si dhe në janë duke u marrë masa institucionale për ekzekutimin e vendimit; c) procesi i ekzekutimit nuk ka filluar ose nuk mund të fillojë, duke sqaruar arsyet përkatëse,, me qëllim që, të ndikojë në menaxhimin sa më me efektivitet të parasë publike lidhur me pagesat e shpërblimit të drejtë të dhënë sipas vendimeve të GJEDNJ-së, për të evituar pagesat e penaliteteve në trajtën e interesave të shkaktuara nga vonesat, nga mos likuidimi i detyrimeve sipas afatit të përcaktuar.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Afati i zbatimit:</b>	Menjëherë dhe në vijimësi.

- Sa i përket çështjeve të mbartura dhe të pa ekzekutuara deri në 31.12.2022, të cilat kanë dal me Vendim të Formës së Prerë nga ana e GJEDNJ, por nuk janë ekzekutuar ende, vijojnë të jenë 5 të tilla:

	Titulli	Data e vendimit përfundimtar	Data brenda së cilës duhet të paguhej detyrimi	Shpërblimi drejtë akorduar nga Gjykata në Euro	Shuma e Ekzekutuar në Lek	Interesat në Lek	Totali i paguar në Lek	Statusi aktual	Data e pagesës/ Arsyeya e mosekzekutimit
1	D. k. Sh.	14.09.2015	14.12.2015	15.600				Proces	Në proces për miratimin e VKM.
2	Sh. k. Sh.	28.05.2018	28.08.2018	13.447.300				Proces	Mungesë fondesh në Buxhetin e

									Shtetit.
3	Dh. k. Sh.	17.03.2016	17.06.2016	4.417.750				Proces	Ka dalë VKM për ekzekutim. Kërkesit janë në proces gjyqësor vendas
4	S. k. Sh.	21.04.2021	21.07.2021	17.500	2.063.250	196.404	2.259.654		Likuiduar 26.01.2023
5	P. k. Sh.	17.09.2019	17.12.2019	13.450	1.585.755	173.337	1.759.092		Likuiduar 26.01.2023
	<b>Total</b>			<b>17.911.600</b>	<b>3,649,005</b>	<b>369,741</b>	<b>4,018,746</b>		

Burimi: Avokatura e Shtetit, përpunoi Grupi i Auditimit

Tabela e mësipërme paraqet gjendjen e vendimeve gjyqësore të pa ekzekutuara ose në proces deri më datë 31.12.2022 për të cilat buxheti shtetit ekspozohet.

Vihen re çështje të cilat datojnë qysh prej 2015 dhe 2016, si edhe 2 vendimeve të viteve 2019-2021.

### **Konstatim:**

Kostot financiare potenciale nga moszbatimi i vendimeve të GJEDNJ-së deri më 31.12.2022:

Në total evidentohen 5 vendime të pa ekzekutuara me një vlerë financiare (vetëm principal) prej 17.911.600 Euro, vlerë e cila pritet të rritet edhe më për shkak të penaliteteve të shtuara si rrjedhojë e vonesave.

Në referencë të Ligjit 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndyshuar, nëni 19/5 pika 3 e tij specifikohet se ...Në rast të moskryerjes së pagesës brenda afateve kohore, të parashikuara në nenin 19/4, të këtij ligji, mbi masën e detyrimeve përkatëse financiare paguhet interesi, sipas përcaktimeve në vendimin e GJEDNJ-së.

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se, të 5 vendimet janë me penalitet të shtuar, nga të cilët 3 vijojnë të shtojnë ende vlerën e penalitetit.

Dy çështje ajo S. k. Sh. dhe P. k. Sh. janë ekzekutuar me buxhetin e vitit 2023, për buxhetin e vitit 2022, ndërkohë 3 çështjet e tjera situata paraqitet si më poshtë vijon:

#### *1. Çështja “D. kundër Sh.”*

Me shkresën Nr.192/13 prot., datë 18.09.2015, Avokatura e Shtetit ka dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë, kërkesën për përkthimin, publikimin dhe ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, Relacionin dhe Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për ekzekutimin e Vendimit të GJEDNJ-së “D. kundër Sh.”, datë 14.09.2015.

- Me shkresën nr.773/19 prot., datë 16.10.2020 Avokatura e Shtetit, në vijim të takimit me deputetët e Komisionit të Ligjeve, ka ri paraqitur pranë Kryeministrisë kërkesën për marrjen e masave për miratimin e VKM për ekzekutimin e vendimit.

- Me shkresën nr.3150 prot., datë 24.06.2022 Avokatura e Shtetit, ka nisur pranë Kryeministrisë shkresë për marrjen e masave për miratimin e VKM për ekzekutimin e vendimit, bashkangjitur relacioni draft për Projektvendim.

#### *2. Çështja “Sh. k. Sh.”*

Me shkresën nr.151/3prot., datë 14.06.2018 i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë, materialet lidhur me ekzekutimin e masave individuale, përkthimin, publikimin dhe ekzekutimin financiar të vendimit.

-Me shkresën nr. 151/6prot., datë 31.08.2018 i janë dërguar Ministrisë së Financave dokumentet e përfituesve dërguar nga përfaqësuesi i tyre me shkresën datë 01.08.2018.

-Me shkresën nr.6852/9 prot., datë 26.10.2018, Ministria e Drejtësisë ka dërguar bashkëlidhur komunikimin e Ministrisë së Financave lidhur me sugjerimin për të negociuar me përfituesit për pagesën me këste sipas mundësive të buxhetit.

-Me shkresën nr.151/12 prot., datë 13.11.2018, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Avokatura ka shprehur dakordësinë që të negociohet me përfituesin, duke propozuar që të bëhet me grup negocimi, me anëtarë nga MD, MFE dhe ASH.

- Me shkresën nr. 6852/11 prot., datë 07.12.2018, Ministria e Drejtësisë, në përgjigje të shkresës nr.151/12, është shprehur lidhur me negocimin.

- Me shkresën nr. 564 prot., datë 10.05.2019, Avokatura ka paraqitur pranë Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ, Planin e Veprimit mbi masat individuale dhe të përgjithshme.

- Me shkresën nr. 15671/1prot., datë 10.07.2019 i është dërguar Kryeministrisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, komunikimi i Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ, lidhur me ankesën e paraqitur nga përfaqësuesi i kërkuësve, ku ndër të tjera nuk bien dakord me shlyerjen e pagesës me këste.

- Me shkresën nr. 15783/1prot., datë 27.09.2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vlerëson dhe sugjeron negocimin juridik me përfituesit, për shkak të vlerës së madhe të detyrimit.

- Vendim i Këshillit Konsultativ për çështjet e GJEDNJ nr. 9, datë 26.12.2019 - vendosi shtyrjen e diskutimit për marrjen e masave individuale për çështjen Sh., pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme.

- Me shkresën nr. 1795/1prot., datë 22.06.2020 i është dërguar Kryeministrisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, komunikimi i Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ, lidhur me një ankesë të paraqitur nga përfaqësuesi i kërkuësve pranë Komitetit të Ministrave të KIE.

#### *Përditësim:*

Me shkresën nr. 1795/7 prot., datë 05.02.2021 Avokatura e Shtetit i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë shkresën e Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ-së, me të cilën vihet në vëmendje çështja e ekzekutimit të masave individuale për rastin “Sh. dhe të tjerë k. Shqipërisë”.

Me shkresën 2554/1 prot., datë 10.02.2021, Ministria e Financave informon se ka marrë të gjitha masat për ekzekutimin e VKM 1015/2013 të ndryshuar, si dhe thekson nevojën e skedulimit të shumës për ekzekutimin e vendimit “Sh.”, duke qenë se nuk mund të përballohet nga Buxheti i Shtetit.

Me shkresën nr.655prot., datë 15.2.2022, Avokatura e Shtetit i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shkresën e Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ-së, me të cilën vihet në vëmendje çështja e ekzekutimit të masave individuale për rastin “Sh. k. Sh.”.

Me shkresën nr. 2978/2 prot., datë 04.05.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të planifikimit buxhetor ka kërkuar listën e plotë (duke iu referuar konkretisht vendimit Sh.) të të gjitha vendimeve të GJEDNJ-së në pritje të ekzekutimit dhe shumat e tyre përkatëse të shpërblimit të drejtë.

Në datën 6 maj 2022, Avokatura e Shtetit i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë listën e vendimeve dhe vlerën financiare përkatëse, duke përfshirë edhe vendimin Sh. kundër Sh.

### **Konstatim:**

Çështja Sh. vijon të mbetet në proces prej vitit 2018, dhe referuar korrespondencës së fundit Ministria e Financave informon se ka marrë të gjitha masat për ekzekutimin e VKM 1015/2013 të ndryshuar, si dhe thekson nevojën e skedulimit të shumës për ekzekutimin e vendimit “Sh.”, duke qenë se nuk mund të përballohet nga Buxheti i Shtetit.

Ajo që përbën non-sens është fakti që në vitet në vijim nga ana e MEF janë shlyer vlera/detyrime të tjera të lindura pas kësaj periudhe.

### *3. Çështja “Dh. k. Sh.” (vijon në proces, në gjykatat vendase)*

- Me shkresën nr.503/21 prot., datë 29.03.2016, Avokatura e Shtetit ka përcjellë pranë MD, shkresën lidhur me ekzekutimin e masave individuale, përkthimin, publikimin dhe ekzekutimin financiar të vendimit datë 17.03.2016, të GJEDNJ-së, për çështjen "R. kundër Sh.";

- Me shkresën nr.384/9 prot., datë 01.09.2021 është dërguar kërkesa për ekzekutimin e vendimit R. k. Sh.” dhe çështjes “Dh. N.” në MFE;

- Në datën 31.08.2016 është miratuar VKM nr.613 datë 31.08.2016 “Për ekzekutimin e vendimit R. k. Sh.”. Nga ana e MFE ky vendim nuk është zbatuar vetëm sa i takon çështjes “Dh. N.”.

- Me shkresën nr. 22882/1prot., datë 17.01.2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë shprehet se vazhdimi me procedurat e ekzekutimit lidhur me aplikimin nr. 48522/10 “Dh. dhe N. k. Sh.”, duhet të bëhet pas qartësimit të situatës ligjore nga të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor vendas;

- Me shkresën nr. 384/1prot., datë 03.04.2019, Avokatura në përgjigje të shkresës nr. 22882/1 prot, ka kërkuar nga MFE kopje të dokumentacionit të parashtruar, që ka pezulluar ekzekutimin;

- Me shkresën nr. 4313/2prot, datë 08.10.2021 si dhe shkresën nr.13675/2 prot, datë 31.08.2021 respektivisht nga ana e MD dhe MEF është përcjell informacioni se... *VKM përcakton se, efektet financiare të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi përballohen nga ...” Fondi i Kontigjencës së buxhetit të shtetit.”* në këto kushte nga ana e MFE nuk mund të bëhet ekzekutim i vendimit të mësipërm përse kohë që burimi përkatës i financimit i referohet ... *Fondi i Kontigjencës së buxhetit të shtetit.”*, i cili nuk figuron më si zë/nocion në ligjin e buxhetit të vitit 2021.

- Me shkresën nr. 384/13 prot., datë 19.10.2021, është dërguar kërkesa për ekzekutim të vendimit në MD dhe MFE, për dijeni Kryeministritë.

### **Përditësim:**

Në datën 12 gusht 2021, Për shkak të zhvillimeve që kanë ndodhur në juridiksionin e brendshëm, në lidhje me çështjen “R. k. Sh.”, kërkesa nr. 48522/10 - “Dh. dhe N. k. Sh.”, Avokatura e Shtetit ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit “Dh. N. k. Sh.”. Ndërsa, në datën 10.11.2022, Avokatura e Shtetit ka paraqitur disa komente shtesë pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sa i takon kërkesës për rishikimin e këtij vendimi. Gjykata nuk ka dalë akoma me vendim.

### **Konkluzion:**

Sa më sipër si dhe nga auditimi praktikave të plota të vendosura në dispozicion u konstatua se, nga ana e ASH janë ndërmarrë nismat dhe hapat e nevojshëm për zgjidhje të situatave dhe minimizimin e efekteve negative në buxhet si rrjedhojë e shtimit të interesave nga penalitetet e mos përmbushjes së afateve. Megjithatë këto hapa nuk janë mbështetur nga MFE e cila ka vijuar

me zgjatjen e procedurave, megjithëse VKM e nxjerra rast pas rasti detyrojnë për zbatimin e vendimeve dhe ekzekutimin e tyre brenda afatit 3 mujor të parashikuar.

*Mosveprimi apo veprimi me vonesë nga ana e Institucioneve respektive lidhur me këto çështje krijon risk të lartë për efekte të tjera shtesë në dëm të buxhetit të shtetit.*

#### 4. *Kërkesa nr. 29309/16 “P. k. Sh.”*

- Me shkresën nr.3011/1prot., datë 18.09.2019 Avokatura e Shtetit ka përcjellë pranë MD kërkesë për përkthim të vendimit;

- Me shkresën nr.3011/2 prot., datë 21.10.2019 Avokatura e Shtetit ka përcjellë ri kujtesë për përkthim të vendimit;

- Me shkresën nr.3011/4 prot., datë 29.10.2019 Avokatura e Shtetit ka përcjellë pranë KM Projekt vendimin e KM “Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së P. k. Sh.”.

- Me shkresën nr.3150 prot., datë 24.06.2022 Avokatura e Shtetit, ka nisur pranë Kryeministrisë shkresë për marrjen e masave për miratimin e VKM për ekzekutimin e vendimit, bashkangjitur relacioni draft për Projektvendim.

*Konstatim:* Mungon shkresa dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

#### 5. *Kërkesa nr. 34602/16 “S. k. Sh.”*

- Me shkresën nr. 773/2prot., datë 22.04.2020 është dërguar Ministrisë së Drejtësisë për përkthim dhe publikim vendimi i GJEDNJ.

- Me shkresën nr. 1863/4 prot., datë 28.05.2020 është dërguar pranë KM shkresa lidhur me ekzekutimin e masave individuale dhe ekzekutimin financiar të vendimit datë 20.01.2020 të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut “S. k. Shqipërisë”, kërkesa nr.34602/16.

-Me shkresën nr. 18454/1 prot., datë 09.10.2020 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka shprehur gatishmërinë për ekzekutimin e vendimit.

-Me shkresën nr. 773/16 prot., datë 14.10.2020 drejtuar Kryeministrisë, Avokatura ka ri kërkuar marrjen e masave për miratimin e VKM për ekzekutimin e vendimit.

-Me shkresën nr. 773/19 prot., datë 16.10.2020 Avokatura e Shtetit, në vijim të takimit me deputetët e Komisionit të Ligjeve, ka ri paraqitur pranë Kryeministrisë kërkesë për miratimin e VKM për ekzekutimin e vendimit.

*Përditësim për të treja vendimet e sipërcituara:*

*Me shkresën nr.3150 prot, datë 24.06.2022 Avokatura e Shtetit i është drejtuar Këshillit të Ministrave dhe ka kërkuar miratimin e Vendimeve të Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (1) kërkesa nr. 6858/11 “D. k. Sh.”, (2) Kërkesa nr.29309/16 “P. k. Sh.” dhe (3) kërkesa nr. 34602/16 “S. k. Sh.”.*

*Në vijim, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr.172, datë 22.12.2022 për ekzekutimin e vendimit “S. k. Shqipërisë dhe VKM nr.860, datë 27.02.2022 për ekzekutimin e vendimit “P. k. Shqipërisë”.*

*Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ekzekutuar këto dy vendime në datën 26.01.2023, në shumën totale prej 4.018.746 Lekë.*

## 6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi rezultoi se, nga ana e institucioneve shqiptare përgjegjëse, pjesë e procesit të zbatimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), që kanë vendosur kompensimin e drejtë, në 5 raste, nuk rezulton të jenë ekzekutuar nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda afatit 3 mujor nga momenti kur vendimi i gjykatës ka marrë formën e prerë, në kundërshtim me përcaktimin e këtyre vendimeve gjyqësore përkatëse si dhe nenin 19/4, të Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

- a. Vendimet e pazbatuar datojnë prej vitit **2015 deri në vitin 2021**, ku 2 (dy) prej tyre përbëjnë dhe peshën kryesore me vlerë 13,447,300 Euro, analizuar nga kostot financiare që ngarkohen për tu përballuar nga buxheti i shtetit dhe përkatësisht:
- Peshën më të lartë e mban çështja “*Sh. k. Sh.*” mbartur prej vitit 2018, (75% të totalit të vlerës), e cila vijon të jetë në proces me arsyetimin e mungesës së fondeve të buxhetit të shtetit, ku vetëm vlera e shpërblimit të drejtë të akorduar rezulton të jetë 13,447,300 Euro, vlerë e cila pritët të shtohet për shkak të interesave.
  - Çështja “*D. k. Sh.*” mbartur prej vitit 2015, vijon në proces pritje të miratimit të VKM-së ku vetëm vlera e shpërblimit të drejtë të akorduar rezulton të jetë 15.600 Euro, vlerë e cila pritët të shtohet për shkak të interesave.

b. Në total gjatë periudhës nën auditim **vitet 2021-2022** evidentohen 5 vendime të pa ekzekutuara me një vlerë financiare (vetëm principal) prej 17.911.600 Euro, pa përfshirë këtu interesat e pagueshëm në rast vonesash referuar pikës 3, të nenit 19/5, në ligjin e sipërcituar, vlerë e cila pritët **të rritet edhe më tej për shkak të penaliteteve të shtuara si rrjedhojë e vonesave në likuidimin e detyrimeve.**

Referuar likuidimit të dy çështjeve përgjatë vitit 2023, kosto aktuale potenciale, e vitit 2023, që ekspozohet buxheti i shtetit nga moszbatimi i 3 prej vendimeve të GJEDNJ-së rezulton të jetë **17,880,650 Euro, e cila do të vijoj të rritet edhe më për shkak të penaliteteve të shtuara si rrjedhojë e këtyre vonesave.** Sa më sipër, mos marrja e masave për ekzekutimin në afat të këtyre vendimeve dhe likuidimit të detyrimeve nga ana e institucioneve respektive, krijon risk për aplikim interesash të pagueshme në vlera të konsiderueshme që përbëjnë dëm të fondeve të buxhetit të shtetit.

<b>Titulli i gjetjes 6:</b>	<i>Afatet 3 mujore për zbatimin dhe ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së</i>
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi rezultoi se, nga ana e institucioneve shqiptare përgjegjëse, pjesë e procesit të zbatimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), që kanë vendosur kompensimin e drejtë, në 5 raste, nuk rezulton të jenë ekzekutuar nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda afatit 3 mujor nga momenti kur vendimi i gjykatës ka marrë formën e prerë, në kundërshtim me përcaktimin e këtyre vendimeve gjyqësore përkatëse si dhe nenin 19/4, të Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.</p> <p>b. Vendimet e pazbatuar datojnë prej vitit <b>2015 deri në vitin 2021</b>, ku 2 (dy) prej tyre përbëjnë dhe peshën kryesore me vlerë <u>13,447,300 Euro</u>, analizuar nga kostot financiare që ngarkohen për tu përballuar nga buxheti i shtetit dhe përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ Peshën më të lartë e mban çështja “<i>Sh. k. Sh.</i>” mbartur prej vitit 2018, (75% të totalit të vlerës), e cila vijon të jetë në</li></ul>

	<p>proces me arsyetimin e mungesës së fondeve të buxhetit të shtetit, ku vetëm vlera e shpërblimit të drejtë të akorduar rezulton të jetë 13,447,300 Euro, vlerë e cila pritet të shtohet për shkak të interesave.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Çështja “D. k. Sh.” mbartur prej vitit 2015, vijon në proces pritje të miratimit të VKM-së ku vetëm vlera e shpërblimit të drejtë të akorduar rezulton të jetë 15.600 Euro, vlerë e cila pritet të shtohet për shkak të interesave.</li> </ul> <p>b. Në total gjatë periudhës nën auditim <b>vitet 2021-2022</b> evidentohen 5 vendime të pa ekzekutuara me një vlerë financiare (vetëm principal) prej <u>17.911.600 Euro</u>, pa përfshirë këtu interesat e pagueshëm në rast vonesash referuar pikës 3, të nenit 19/5, në ligjin e sipërcituar, vlerë e cila pritet <b>të rritet edhe më tej për shkak të penaliteteve të shtuara si rrjedhojë e vonesave në likudjimin e detyrimeve.</b></p> <p>Referuar likuidimit të dy çështjeve përgjatë vitit 2023, kosto aktuale potenciale, e vitit 2023, që ekspozohet buxheti i shtetit nga moszbatimi i 3 prej vendimeve të GJEDNJ-së rezulton të jetë <b>17,880,650 Euro, e cila do të vijoj të rritet edhe më për shkak të penaliteteve të shtuara si rrjedhojë e këtyre vonesave.</b> Sa më sipër, mos marrja e masave për ekzekutimin në afat të këtyre vendimeve dhe likuidimit të detyrimeve nga ana e institucioneve respektive, krijon risk për aplikim interesash të pagueshme në vlera të konsiderueshme që përbëjnë dëm të fondeve të buxhetit të shtetit.</p>
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr.10018 datë 13.11.2018 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar</li> <li>- Vendim i GJEDNJ-së për kërkesën nr.75763/17</li> <li>- Vendim i GJEDNJ-së për kërkesën nr. 28142/17</li> <li>- Vendim i GJEDNJ-së për kërkesën nr. 73548/17</li> <li>- VKM nr. 78 datë 10.02.2021 për kërkesën nr. 75763/17</li> <li>- VKM nr. 290, datë 11.05.2022 Për çështjen ‘L. kundër Sh.’</li> <li>- VKM nr. 369, datë 01.06.2022 Për ç ‘F. Z. kundër Sh.’</li> <li>- VKM nr. 760, datë 12.12.2022 Për ç ‘X. kundër Sh.’</li> <li>- VKM nr. 586, datë 07.09.2022 Për çështjen ‘B. kundër Sh.’</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Risk për aplikim interesash të pagueshme në vlera të konsiderueshme.
<b>Shkaku:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mungesë fondesh në buxhetin e shtetit.</li> <li>- Proces pritje për miratim të VKM-së.</li> </ul>
<b>Rekomandimi:</b>	<p><b>1.1.</b>Institucioni i Avokaturës së Shtetit, në rolin e njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së si dhe rolin e përfaqësuesit kombëtar përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës lidhur me ekzekutimin e kësaj kategorie të vendimeve, të informojë Këshillin e Ministrave për vendimet ende të pa ekzekutuara si dhe të intensifikojë marrëdhënien me Ministrinë përgjegjëse për Financat, për sa i takon koordinimit të procesit të ekzekutimit dhe prezantimit të vlerës së interesave financiare që vijnë nga moszbatimi i afatit të likuidimit të vendimeve, të cilat e ekspozojnë buxhetin e shtetit ndaj detyrimeve shtesë e në vlera të konsiderueshme.</p> <p><b>2.2.</b> Për shkak të impaktit të lartë të çështjes, (pasi preket fondi i kontigjencës</p>

	<p>së buxheti i shtetit) me qëllim ndërtimin dhe funksionimin e një <i>sistemi proaktiv të menaxhimit financiar</i> dhe nga ana tjetër mirë menaxhimin me sa më efektivitet të parasë publike, ASH të ndjekë procesin nëpër të gjitha hallkat me qëllim finalizimin me sukses të tij, duke evidentuar shkeljet dhe mosveprimet e institucioneve respektive vendase, të cilat duhen adresuar me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse. Në këtë kuadër:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ndërmarrë në <b>mënyrë urgjente</b> masa për shlyerjen e vlerës së vendimeve gjyqësore që mbartet prej vitit 2018, të cilat kanë peshën më të lartë ndër këto detyrime, qoftë edhe përmes dakodësimit mbi nevojën e skedulimit të shumës për ekzekutimin e vendimit shlyerjes pjesore të këtyre detyrimeve.</li> <li>✓ Ministrinë e linjës administrative në bashkëpunim Kryeministrinë të marrin masa urgjente për nxjerrjen e VKM me qëllim shlyerjen e vlerës që mbartet prej vitit 2015, kjo në kuadër të detyrimit të institucioneve shtetërore për njoftimin e Avokaturës së Shtetit jo më vonë se një muaj nga momenti kur ngarkohen për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, në bazë të nenit 19/6, pika 2 e ligjit organik për Avokaturën e Shtetit.</li> </ul>
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Afati i zbatimit:</b>	Menjëherë dhe në vijimësi.

✚ Nga ana e GJEDNJ-së paraqiten edhe 30 çështje me statusin “**kërkesa në shqyrtim, por pa vendim**” ku më e hershja daton prej vitit 2011.

Për këto çështje Gjykata **nuk është shprehur** akoma e për pasojë **nuk dihet** një datë për daljen e këtyre vendimeve.

***Vlera ekonomike sipas pretendimit të palëve paditëse rezulton të jetë rreth 151,914,617 Euro dhe 115,300,417 ALL, por kjo vlerë është në varësi të ecurisë së çështjes në gjykim.***

Nëse del vendimi kundër R. e Sh. (*pra pala shqiptare humbet*), vlerës së principalit i shtohen interesa apo penalitete rast pas rasti.

Nr.	Kërkesa	Data e kërkesës	Pretendimi palës	Statuti
1.	D. k. Sh.	19.07.2011	1,269,470 Euro	Në shqyrtim
2.	B. k. Sh.	12.01.2016	530,000 Euro	Në shqyrtim
3.	I. srl k. Sh.	28/05/2015	121,000 Euro	Në shqyrtim
4.	I. srl L. k. Sh.	15.02.2018	149,183,146 Euro	Në shqyrtim
5.	G. k. Sh.	25.08/2020	463,800 Euro	Në shqyrtim
6.	Th. k. Sh.	22/11/2019	212,896 Euro 2,015,889 ALL	Në shqyrtim
7.	C. k. Sh.	25/5/2020	110,886,180 ALL	Në shqyrtim
8.	N. v. A.	21/04/2021	113,840 Euro	Në shqyrtim
9.	B. v. A.	19.05.2021	2,398,348 ALL	Në shqyrtim
10.	G. v. A.	19.05.2021	14,115 Euro	Në shqyrtim
11.	S. k. Sh.	01.04.2021	3.850 Euro	Në shqyrtim
12.	M. k. Sh.	01.04.2021	2.500 Euro	Në shqyrtim
	<b>Totali</b>		<b>262,800,797 Euro 115,300,417 ALL</b>	
<b><i>Çështje të cilat janë propozuar zgjidhje me pajtim nga Gjykata</i></b>				
1	H. M. k. Sh.	26.01.2021	4,045 Euro	Në shqyrtim
2	I. R.	26.01.2021	4,045 Euro	Në shqyrtim
3	M. Rr.	26.01.2021	4,045 Euro	Në shqyrtim
4	F. B.	26.01.2021	4,045 Euro	Në shqyrtim



5	R. K.	26.01.2021	4,045 Euro	Në shqyrtim
6	B. S.	26.01.2021	4,045 Euro	Në shqyrtim
7	S. G.	22.04.2021	Nuk ka kërkuar shpërblim financiar	Në shqyrtim
8	G. N. (Ortak)	19.05.2021	169,895,010 ALL	Në shqyrtim
9	E. Rr.	29.06.2021	6,000 Euro	Në shqyrtim
10	N. Sh.	08.07.2021	4,700 Euro	Në shqyrtim
11	S. K.	08.07.2021	3,600 Euro	Në shqyrtim
12	V. B.	08.07.2021	12,150 Euro	Në shqyrtim
13	A. M.	06.12.2021	6,549,000 Euro	Në shqyrtim
14	S. F B.	06.12.2021	95,936 Euro	Në shqyrtim
15	P. V. 2	13.12.2021	143,956,977 ALL	Në shqyrtim
16	P./T. k. Sh.	01.04.2015	3,850 Euro	Në shqyrtim
	<b>Totali</b>		<b>6,699,506 Euro</b> <b>313,851,987 ALL</b>	
<b>Çështje të cilat janë dhënë zgjidhje nga Gjykata në vitin 2023</b>				
1	Dh. L.	12.10.2021	Vendim mospranimi	30.03.2023
2	A. H.	15.02.2021	Akorduar nga Gjykata 8,000 Euro	23.02.2023

Burimi: Avokatura e Shtetit, përpunoi Grupi i Auditimit

### **Konstatim:**

Referuar raportit të buxhetit faktik të vitit 2022 publikuar nga Ministria për Financat dhe Ekonominë, faqet 59-60 ku janë trajtuar detyrimet faktike dhe kontigjente për vendimet e GJEDNJ-së, rezultojnë se:

Nga ana e MFE specifikohet vlera 21,717,665 Euro si vlerë e detyrimeve kontigjente dhe faktive për vendimet e nxjerra nga GJEDNJ:

<i>Vendim GJEDNJ</i>	<i>Detyrimi Faktik</i>	<i>Detyrimi Kontigjent</i>	<i>Total i detyrimit faktik dhe kontigjent</i>
D. k.Sh.	15,600		15,600
R. k. Sh. (Dh. N. k. Sh.)	4,417,750		4,417,750
Sh. k. Sh.	13,447,300		13,447,300
Sh. k. Sh.		3,811,365	3,811,365
Çështjet M. k. Sh; K. k. Sh, J. k. Sh., I. M. S k. Sh., S. K. Sh.		16,800	16,800
D. k. Sh.		5,000	5,000
P. dhe T. k. Sh.		3,850	3,850
Total	17,880,650	3,837,015	21,717,665

Burimi: MFE, ASH (2023)

Ndërkohë referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e Avokaturës së Shtetit rezultojnë se, një pjesë e vendimeve të sipërcituara nga ana e MFE-së ( 4 prej tyre) mbajnë statusin e “çështje në shqyrtim” për të cilat Gjykata **nuk është shprehur** akoma e për pasojë **nuk dihet** një datë për daljen e këtyre vendimeve dhe vlerë ekzakte e tyre për tu likuiduar (marr në konsideratë kamatvonesat), 1 çështje përmban 12 kërkesa ku 10 janë likuiduar përpara viteve 2021-2022 dhe 2 që janë ekzekutuar së fundmi nuk kanë patur vlerë financiar dhe 3 çështje nuk rezultojnë me gjurmë dokumentare të vendosura në dispozicion grupit të auditimit të cilat janë J., K. dhe I.M.S kundër Shqipërisë.

### **Detajuar:**

- Çështja Sh. k. Sh., ka pasur 12 kërkesa për të cilat është përcaktuar shpërblim për 10 prej tyre, (përpara viteve 2021-2022) dhe ekzekutuar vendimin vendas për 2 kërkesa “M.” dhe “V.”. Të dyja këto kërkesa janë pa vlerë financiare nga Gjykata.

- 3 çështje prej totalit të tabelës sipërcituar janë në shqyrtim, konkretisht:

- 1- Çështja M. k. Sh. me vlerë 2.500 Euro në shqyrtim
- 2- Çështja S. k. Sh. me vlerë 3.850 Euro në shqyrtim
- 3- Çështja P. dhe T. k. Sh. me vlerë 3,850 Euro në shqyrtim

#### 4- Çështja D. k. Sh. me vlerë 5,000 Euro në shqyrtim

Sa i takon çështjeve me peshën më të madhe, sikundër trajtuar në material rezulton se:

D. k. Sh. prej vitit 2015 vijon në proces për miratim VKM;

Sh. k. Sh. prej 2018 vijon në proces për mungesë fondesh në buxhetin e shtetit;

Dh. k. Sh. vijon në proces pasi palët janë në proces gjyqësor vendas.

#### 7. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, mes të dhënave të vendosura në dispozicion nga Avokatura e Shtetit dhe atyre të pasqyruara në raportin vjetor mbi zbatimin e buxhetit të shtetit publikuar MFE për vitin 2022 rezulton mospërputhje në totalin e vlerës së detyrimit faktik.

Referuar të dhënave të ASH kjo vlerë rezulton 17,911,600 Euro, ndërkohë në raportin e MFE-së rezulton 17,880,650 Euro.

Diferencë e ardhur si rrjedhojë e mospasqyrimin në raportin e MFE-së të dy vendimeve, konkretisht P. k. Shqipërisë me vlerë 13,450 Euro dhe S. k. Sh. me vlerë 17,500 Euro.

<b>Titulli i gjetjes 7:</b>	<i>Mosrakordim i vlerave mes ASH dhe raportit vjetor të buxhetit MFE</i>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi u konstatua se, mes të dhënave të vendosura në dispozicion nga Avokatura e Shtetit dhe atyre të pasqyruara në raportin vjetor mbi zbatimin e buxhetit të shtetit publikuar MFE për vitin 2022 rezulton mospërputhje në totalin e vlerës së detyrimit faktik. Referuar të dhënave të ASH kjo vlerë rezulton 17,911,600 Euro, ndërkohë në raportin e MFE-së rezulton 17,880,650 Euro. Diferencë e ardhur si rrjedhojë e mospasqyrimin në raportin e MFE-së të dy vendimeve, konkretisht P. k. Sh. me vlerë 13,450 Euro dhe S. k. Sh. me vlerë 17,500 Euro.
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Ligji nr.10018 datë 13.11.2018 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar;</li><li>- Rregullore e Brendshme e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 29 i saj;</li><li>- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.</li></ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Pasqyrim jo real i situatës së detyrimeve faktike që përballat buxheti shtetit
<b>Shkaku:</b>	Jo koherencë mes të dhënave ndërinstitucionale.
<b>Rekomandimi:</b>	Nga ana e institucioneve përgjegjëse, Avokatura e Shtetit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë të marrin masa të menjëherëshme për rakordim të saktë dhe korrekt të vlera faktike të detyrimeve të ardhura nga vendimet e GJEDNJ-së.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Afati i zbatimit:</b>	Menjëherë.

#### 8. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi u konstatua se, nga ana e GJEDNJ-së janë depozituar e regjistruar edhe 30 çështje me statusin “*kërkesa në shqyrtim, por pa vendim*”, ku çështja më e hershmja e regjistruar daton prej vitit 2011, për të cilat Gjykata nuk është shprehur ende më një vendim përfundimtar. Vlera financiare e kërkuar sipas pretendimit të palëve paditëse në lidhje me sa më sipër, rezulton të jetë rreth 151,914,617 Euro dhe 115,300,417 ALL, por kjo vlerë ndryshon në varësi të ecurisë së çështjes në gjykim.

<b>Titulli i gjetjes 8:</b>	<i>Vendime për të cilat Gjykata nuk është shprehur ende</i>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi u konstatua se, nga ana e GJEDNJ-së janë depozituar e regjistruar edhe 30 çështje me statusin “ <i>kërkesa në shqyrtim, por pa vendim</i> ”, ku çështja më e hershme e regjistruar daton prej vitit 2011, për të cilat Gjykata nuk është shprehur ende më një vendim përfundimtar. Vlera financiare e kërkuar sipas pretendimit të palëve paditëse në lidhje me sa më sipër, rezulton të jetë rreth 151,914,617 Euro dhe 115,300,417 ALL, por kjo vlerë ndryshon në varësi të ecurisë së çështjes në gjykim.
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr.10018 datë 13.11.2018 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar;</li> <li>- Rregullore e Brendshme e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 29 i saj;</li> <li>- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Risk për aplikim penalitetesh dhe interesash të pagueshme në vlera të konsiderueshme.
<b>Shkaku:</b>	Për këto çështje Gjykata nuk është shprehur akoma e për pasojë nuk dihet një datë për daljen e këtyre vendimeve.
<b>Rekomandimi:</b>	Avokatura e Shtetit, në rolin e njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së si dhe rolin e përfaqësuesit përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës lidhur me ekzekutimin e këtyre lloj vendimeve, në cilësinë e përfaqësuesit dhe mbrojtësit të interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë GJEDNJ-së, të ndjekë në vijimësi përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar pranë kësaj Gjykate dhe informojë Këshillin e Ministrave për vendimet e pa ekzekutuara si dhe të intensifikojë marrëdhënien me MEF përsa i takon vlerës së interesave financiare për moszbatim të afatit të likuidimit të vendimeve që ekspozojnë buxhetin e shtetit në vlera të konsiderueshme.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Afati i zbatimit:</b>	Menjëherë dhe në vijimësi.

✚ Përgjatë vitit 2022 referuar formatit zyrtar të regjistrimit ku mbahen dhe evidentohen kërkesat e marra për çdo çështje rezultojnë 4 çështje të hyra përgjatë këtij viti.

Nga këto 4 (katër) çështje është arritur zgjidhja e njërës prej tyre me pajtim, më datë 16.09.2022 dhe 3 (tre) të tjerat kanë statusin aktual “*kërkesa në shqyrtim, por pa vendim*” si më poshtë vijon:

1. *Kërkesa nr. 18175/12 “N. C., S. k. Sh.” është komunikuar më datë 02.06.2022 nga GJEDNJ.*

*Pretendimi: cenim i neneve 6,13 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut konkretisht:*

*neni 6: shkelje e të drejtës që çështja të dëgjohet drejtë si dhe shkelje e të drejtës që çështja të dëgjohet nga një gjykatë e krijuar me ligj;*

*neni 13: shkelje e së drejtës së aksesit, shkelje e rëndë e procedurës, gjykimin brenda një afati të arsyeshëm,*

*neni 13: shkelje e së drejtës së pronës dhe mos qasjen e një mjeti efektiv ankimi.*

- Më datë 20.07.2022 është vendosur që çështja të zgjidhet me pajtim, duke u ofruar kërkuessve 1.450 Euro si shpërblim të drejtë. Më datë 16.09.2022 është përcjellë Deklarata e Njëanshme.

*Statusi i çështjes:* Në pritje të vendimit të Gjykatës.

2. *Kërkesa nr. 51830/16 "M. R. k. Sh." është komunikuar më datë 15.09.2022 me shkresën nr.2032 prot, datë 10.05.2022 është dërguar aplikimi për M. R. K. Sh.*

*Pretendimi: cenim i neneve 6 paragrafi 1 dhe 3 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut konkretisht:*

*neni 6 paragrafi 1: shkelje e të drejtës që çështja të dëgjohet drejtë si dhe shkelje e të drejtës që çështja të dëgjohet nga një gjykatë e krijuar me ligj;*

*neni 6 paragrafi 3 pika c: mohim i të drejtës për tu rigjykuar dhe mbrojtur vet apo me ndihmës ligjor të zgjedhur prej tij;*

- me shkresat nr.2032/1prot., nr.2032/2 prot, datë 26.05.2022 është dërguar informacion nga ASH drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për çështjen në fjalë.
- me shkresën nr.2032/3 prot, datë 06.06.2022 është dërguar nga ana e Gjykatës
- Kushtetuese informacion me kopje të dosjeve gjyqësore;
- me shkresën nr.2032/4 prot., datë 14.06.2022 është dërguar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që dosja e vendimit përkatës është bërë pjesë e dosjes gjyqësore nr.1217 Akti, datë 16.11.2016 që ndodhet në Gjykatën e Lartë Tiranë e për rrjedhim Gjykata e Rrethit nuk ka dijeni nëse ka vendimmarrje në lidhje me atë çështje;
- me shkresën nr.2032/5 prot., datë 16.06.2022 është dërguar nga ana e ASH kërkesë drejtuar Gjykatës së Lartë për vendosje në dispozicion të dosjeve gjyqësore;
- me shkresën nr.2032/6 prot., datë 05.07.2022 është dërguar nga ana e Gjykatës së Lartë informacion mbi dosjet gjyqësore;
- me shkresën nr.2032/6 prot., datë 19.07.2022 është dërguar nga ana e ASH kërkesë drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për vendosje në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm lidhur me çështjen;
- me shkresën nr.2032/7 prot., datë 19.07.2022 është dërguar nga ana e ASH kërkesë drejtuar Gjykatës së Lartë për plotësim me dokumentacion;
- me shkresën nr.2032/9 prot., datë 19.07.2022 është dërguar nga ana e ASH kërkesë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për plotësim me dosjen e procedurave të ekstradimit/deportimit të këtij shtetasi;
- me shkresën nr.2032/10 prot., datë 19.07.2022 është dërguar nga ana e ASH kërkesë drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për plotësim me dosjen e procedurave të ekstradimit/deportimit të këtij shtetasi;
- me shkresën nr.2032/11 prot., datë 22.07.2022 është dërguar nga ana e Gjykatës së Lartë përgjigje;
- me shkresën nr.2032/12 prot., datë 26.07.2022 është dërguar nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme përgjigje;
- me shkresën nr.2032/13 prot., datë 27.07.2022 është dërguar kërkesë nga ASH drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për dokumentacion mbështetës;
- me shkresën nr.2032/14 prot., datë 26.07.2022 është dërguar nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme përgjigje;
- me shkresën nr.2032/15 prot., datë 15.09.2022 është dërguar nga ana Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përgjigje;

- me shkresën nr.2032/16 prot., datë 15.09.2022 është dërguar nga ana e ASH komente dhe observacione në lidhje me pretendimet e kërkuarit R. K. Sh.;
- me shkresën nr.2032/17 prot., datë 15.09.2022 është dërguar nga ana e ASH komente dhe observacione në lidhje me pretendimet e kërkuarit R. K. Sh. (anglisht)
- me shkresën nr.2032/18 prot., datë 22.09.2022 është dërguar nga GJEDNJ komunikim lidhur me çështjen;
- me shkresën nr.2032/19 prot., datë 22.09.2022 është dërguar nga GJEDNJ përgjigje mbi observimet;
- me shkresën nr.2032/20 prot., datë 09.11.2022 është dërguar nga GJEDNJ komunikim lidhur me çështjen;
- me shkresën nr.2032/21 prot., datë 06.12.2022 është dërguar nga ASH vëzhgime shpesh lidhur me pretendimet për shpërblim të drejtë.
- me shkresën nr.2032/22 prot., datë 13.12.2022 është dërguar nga GJEDNJ komunikim lidhur me çështjen;

*Statusi i çështjes:* Kanë përfunduar diskutimet dhe kërkimet e palëve. Kërkuari ka kërkuar vetëm rishqyrtimin e çështjes në prani të tij dhe nuk ka kërkuar shpërblim financiar. Në pritje të vendimit të Gjykatës.

3. *Kërkesa nr. 683931/17 “D. Gj. k. Sh.” është komunikuar më datë 17.11.2022 nga GJEDNJ.*

*Pretendimi: cenim i neneve 6 paragrafi 1 dhe 3 dhe neni 2 paragrafi 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut konkretisht:*

*neni 6 paragrafi 1: shkelje e të drejtës që çështja të dëgjohet drejtë si dhe shkelje e të drejtës që çështja të dëgjohet nga një gjykatë e krijuar me ligj;*

*neni 6 paragrafi 3 pika c: mohim i të drejtës për tu rigjykuar dhe mbrojtur vet apo me ndihmës ligjor të zgjedhur prej tij;*

- me shkresën nr.5812 prot., datë 24.11.2022 është dërguar aplikimi për G. K. Sh.
- me shkresat nr.5812/1 prot., nr.5812/2 prot, 5812/3 prot datë 27.12.2022; është dërguar informacion nga ASH drejtuar Gjykatës së Lartë për çështjen në fjalë.

*Statusi i çështjes:* Kanë përfunduar diskutimet dhe kërkimet e palëve, kërkuari ka kërkuar vetëm rishqyrtimin e çështjes në prani të tij dhe nuk ka kërkuar shpërblim financiar. Në pritje të vendimit të Gjykatës.

4. *Kërkesa nr. 55159/16 “K. K. k. Sh.” është komunikuar më datë 17.11.2022.*

*Pretendimi: cenimi i neneve 8 dhe neneve 3 dhe 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

*Ankuesi ankohet se heqja e mandatit të tij si deputet shkeli të drejtën e tij për të kryer mandatin e tij parlamentar (nenit 3 i Protokollit nr. 1 të Konventës) dhe përbën një ndërhyrje të paligjshme dhe jo propocionale në reputacionin e tij të garantuar sipas nenit 8 të Konventës.*

*Nenit 3 i Protokollit nr. 1 të Konventës - shkelje e së drejtës për zgjedhje të lira.*

*Neni 8: shkelje e së drejtës për respektim e jetës private dhe familjare.*

- me shkresën nr.5621 prot., datë 15.11.2022 është dërguar aplikimi për K. K. K. Sh.
- me shkresat nr.5812/1 prot., nr.5812/2 prot, 5812/3 prot datë 27.12.2022 është dërguar informacion nga ASH drejtuar Gjykatës së Lartë për çështjen në fjalë.

Kërkesa ka të bëjë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 3 qershor 2016, sipas të cilit kërkuari kishte vepruar në kundërshtim me nenin 70 § 3 të Kushtetutës, i cili parashikon se

anëtarët e Kuvendit nuk mund të angazhohen në asnjë aktivitet fitimprurës që përfiton (gjenerojë të ardhura) nga pasuritë publike. Kërkuksi ankohet se largimi i tij nga detyra shkeli të drejtën e tij për të përfunduar mandatin e tij parlamentar, sipas nenit 8 të Konventës dhe nenit 3 të Protokollit nr.1 të Konventës.

*Statusi i çështjes:* Kanë përfunduar komentet e palëve dhe vijohet në pritje të kërimit financiar për shpërblimin e drejtë.

### **Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së.**

Avokatura e Shtetit në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që i burojnë nga zbatimi Ligjit nr.10018 datë 13.11.2002 “Për Avokaturën e Shtetit”, në referencë të nenit 19/7, të këtij ligji, konsultohet me *Këshillin Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së.*

Këshilli Konsultativ ushtron veprimtarinë e tij nën drejtimin dhe bashkërendimin e Avokaturës së Shtetit, për sa i përket:

- a) Gjetjes së një zgjidhjeje miqësore ndërmjet palëve, që ka për qëllim t’i japë fund çështjes;
- b) Shqyrtimit të të gjitha materialeve/dokumenteve që disponojnë organet shtetërore, në lidhje me çështjen e shqyrtuar nga GJEDNJ;
- c) Përcaktimit të një plani pune/veprimi me afate konkrete për realizimin e detyrave konkrete, në kuadër të ekzekutimit të një vendimi;
- ç) Paraqitjes së rekomandimeve/zgjidhjeve të mundshme, në kuadër të planit të punës/veprimit;
- d) Komunikimeve për informimin e publikut dhe mediave, në lidhje me ekzekutimin e vendimit.

3. Këshilli Konsultativ përbëhet nga 5 anëtarë të emëruar nga Kryeministri, me propozim të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, ndërmjet juristëve me përvojë dhe të njohur në ushtrimin e funksioneve e veprimtarive profesionale juridike.

4. Anëtarët e Këshillit Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së ushtrojnë këtë funksion për një periudhë 2 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Nga auditimi u konstatua se, ky Këshill është krijuar më 04.02.2019 dhe nuk ka gjurmë të rikrijimit të tij.

Këshilli Konsultativ luan rolin e një kolegji të posaçëm për orientimin dhe konsultimin e ASH mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së KEDNJ, si dhe realizimin e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së në mënyrë të plotë nga institucionet e ngarkuara për kryerjen e tyre.

### ***Observacion i ardhur nga subjekti me shkresën nr.2178/7 prot., datë 25.08.2023 protokolluar me tonën nr.384/5 datë 28.08.2023***

*Mungesa e gjurmës së rikrijimit të Këshillit Konsultativ për çështjet e GJEDNJ.*

#### **Shpjegimet e Avokaturës së Shtetit:**

Sikurse kemi parashtruar në kundërshtimet e akt kontrollit Avokatura e Shtetit ka qenë në vështirësi për propozimin për rikrijimin e Këshillit Konsultativ të Çështjeve në GJEDNJ, por kjo nuk ka qenë për shkak të neglizhencës së saj, sikurse ka gjetur Projekt Raporti. Për këtë arsye, në këtë gjetje kundërshtojmë vetëm shkakun “neglizhencë nga ana e institucionit”.

Përveç shkaqeve të parashtruara nga ana jonë, shkakun kryesor të mosformimit të tij ka qenë pamundësia për të identifikuar anëtarë të rinj të Këshillit, duke qenë se anëtarët e këtij Këshilli duhet të kenë njohuri specifike në fushën e së drejtës vendase (kryesisht Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë), por në mënyrë të veçantë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vështirësia në identifikimin e profesionistëve për të plotësuar këtë Këshill, ecën në unison me

vështirësitë e konstatuara në formimin e organeve të rëndësishme të drejtësisë, kur në jo pak raste janë hasur vështirësi në përcaktimin e kandidatave edhe në këto organe, aq më tepër, kur anëtarët e këtyre organeve e kanë të ndaluar të marrin pjesë në organe të tjera, qoftë këto edhe këshillimore si është ky Këshill.

Sa sqaruar më sipër, ju lutem të merrni në konsideratë këto shpjegime në hartimin e raportit tuaj përfundimtar.

***Qëndrimi Grupit të Auditimit:***

Sjellim në vëmendjen Tuaj se, gjetja e grupit të auditimit ashtu sikundër edhe Ju dakortësoni është *mungesa e Këshillit Konsultativ*, nga ana e grupit të auditimit u specifikua mungesa e gjurmëve justifikuese të ndërmarrjes së nismave për ringritjen e Këshillit.

Përsa më sipër, duke qenë se nuk ndryshohet gjetja por listohen arsye të mos ngritjes së këtij këshilli observacioni mësipërm ***merret në konsideratë.***

***9. Gjetje nga auditimi:***

Nga auditimi u konstatua se, mungon gjurma e rikrijimit të Këshillit Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së për periudhën 2021-2022, i cili është një organ që ka si objekt orientimin dhe konsultimin e ASH-së mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së KEDNJ për këtë arsye të gjitha çështjet me impakt financiar trajtuar në këtë material duhen shqyrtuar pranë këtij Këshilli, i cili evidentohet të ketë ka ushtruar veprimtarinë e tij deri në shkurt të vitit 2021.

<b><i>Titulli i gjetjes 9:</i></b>	<i>Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së</i>
<b><i>Situata:</i></b>	Nga auditimi u konstatua se, mungon gjurma e rikrijimit të Këshillit Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së për periudhën 2021-2022, i cili është një organ që ka si objekt orientimin dhe konsultimin e ASH-së mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së KEDNJ për këtë arsye të gjitha çështjet me impakt financiar trajtuar në këtë material duhen shqyrtuar pranë këtij Këshilli, i cili evidentohet të ketë ka ushtruar veprimtarinë e tij deri në shkurt të vitit 2021.
<b><i>Kriteri:</i></b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr.10018 datë 13.11.2018 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar;</li> <li>- Ligji nr.8480 datë 27.05.1999,” Për funksionimin e organeve kolegjiale”;</li> <li>- Rregullore e Brendshme e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 29 i saj;</li> <li>- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.</li> </ul>
<b><i>Ndikimi/Efekti:</i></b>	Mungesë orientimi dhe konsultimi të ASH-së mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së KEDNJ.
<b><i>Shkaku:</i></b>	Mos marrje e nismave ndërvepruese.
<b><i>Rekomandimi:</i></b>	Për shkak të rolit që ka Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së, si dhe faktit që organi dhe funksionimi i tij në bazë të nenit 19/7, të Ligjit nr.10018 datë 13.11.2018, është rregulluar me akte nënligjore, kërkohet që Avokati i Përgjithshëm i Shtetit pas një procesi përzgjedhës transparent të kandidatave për në Këshillin Konsultativ, të dërgojë propozimet Kryeministrit me qëllim vënien në funksion të tij dhe përmbushjen e qëllimit të parashikuar nga ligjvënësi si dhe përcaktimit të një plani pune/veprimi me afate konkrete për realizimin e detyrave konkrete, në kuadër të ekzekutimit të

	vendimeve gjyqërore të GJEDNJ si dhe paraqitjes së rekomandimeve/zgjidhjeve të mundshme, në kuadër të planit të punës/veprimit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Afati i zbatimit:</b>	Menjëherë.

*Observacion mbi rekomandimin e mësipërm:*

***Observacion i ardhur nga subjekti me shkresën nr.2178/7 prot., datë 25.08.2023 protokolluar me tonën nr.384/5 datë 28.08.2023***

***b.4 Rekomandimi 9:***

Për shkak të rolit që ky Këshill Konsultativ ka, si dhe faktit që domosdoshmëria e pranisë së tij është rregulluar me bazë ligjore (neni 19/7 i Ligjit nr.10018 datë 13.11.2018) gjykohet e nevojshme që, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit pas një procesi përzgjedhës transparent të kandidaturave për në Këshillin Konsultativ, të dërgojë propozimet e tij pranë Kryeministrit të Shqipërisë me qëllim vënien në funksion të tij dhe përmbushjen e qëllimit të parashikuar nga ligjvënësi.

Ky Këshill është një organ që ka si objekt orientimin dhe konsultimin e ASH-së mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së KEDNJ për këtë arsye të gjitha çështjet me impact financiar trajtuar në këtë material duhen shqyrtuar pranë këtij Këshilli.

***Menjëherë***

***Koment i Avokaturës së Shtetit:***

Avokatura e Shtetit në vijimësi po vlerëson kandidaturat e mundshme, të cilat plotësojnë kriteret që kërkon konstituimi i këtij organi, por deri më tani, për arsyet që ka parashtruar në kundërshtimet për gjetjen 9, nuk ka mundur të identifikojë kandidaturat e mundshme. Në çdo rast, e kemi në objektivat tona afatshkurtra konstituimin e Këshillit Konsultativ.

***Qëndrimi Grupit të Auditimit:***

Sjellim në vëmendjen Tuaj se, gjetja e grupit të auditimit ashtu sikundër edhe Ju dakortësoni është *mungesa e Këshillit Konsultativ*, nga ana e grupit të auditimit u specifikua mungesa e gjurmëve justifikuese të ndërmarrjes së nismave për ringritjen e Këshillit.

Përsa më sipër, referuar komenteve tuaja, nuk rezulton bashkangjitja e dokumentacionit të ri justifikues (gjurmë justifikuese e ndërmarrjes së nismave për vlerësimin e kandidaturave të mundshme, të cilat plotësojnë kriteret që kërkon konstituimi i këtij organi).

***Përsa më sipër, duke qenë se nuk rezultojnë bashkangjitur të dhëna dhe fakte të reja justifikuese, observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë.***

***10. Gjetje nga auditimi:***

Sa i takon dokuemtimin dhe regjistrimit fizik të ndjekjes së çështjeve gjyqësore, u konstatua se,

- ✓ ***Sa i takon regjistrin të GJEDNJ-së*** ky regjistër ka filluar të plotësohet fizikisht nga viti 2022 dhe nuk ka një databazë zyrtare të çështjeve të trajtuara në GJEDNJ.

Nga auditimi i formatit fizik të tij, u konstatua se:

- Regjistri në trajtën e një dokumenti zyrtar përmban korrektive, specifikisht në çështjen nr.4 në pretendim dhe objekt.



***Observacion i ardhur nga subjekti me shkresën nr.2178/7 prot., datë 25.08.2023 protokolluar me tonën nr.384/5 datë 28.08.2023***

Sipas Projekt Raportit: Sa i takon regjistrin të GJEDNJ-së, ky regjistër ka filluar të plotësohet fizikisht nga viti 2022 dhe nuk ka një database zyrtare të çështjeve të trajtuara në GJEDNJ..... Nivel i lartë risku duke u bërë ndryshimi apo humbja e të dhënave sensitive që ai mban..... Mosushtrim i kujdesit të duhur ndaj këtij dokumenti zyrtar (fq.53 - 54 e Raportit)

Rekomandohet: Regjistri duhet të përshtatet dhe rregullohet sipas Ligjit nr.9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe specifikisht të hartohet dhe mbahet në përputhje me normat tekniko profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë për shkak të rëndësisë që ai mbart. (fq.54 e Raportit)

***Komentet e Avokaturës së Shtetit:***

Sikurse është parashtruar nga ana jonë, në kundërshtimet e akt konstatimeve, regjistri elektronik dhe fizik, i cili mbahet konform Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, nr. 68, datë 28.03.2019, rekomandimeve të mëparshme të KLSH-së, Urdhrit nr.375/2 prot, datë 16.11.2022 i Avokatit të Përgjithshëm, nuk i nënshtrohet mënyrës dhe procedurës së mbajtjes së Ligjit “Për Arkivat”. Ai është një regjistër informues dhe lehtësues, i cili përmbledh të dhëna dhe ka informacion të përpunuar, në mënyrë që këto të përdoren lehtësisht nga avokatët e shtetit, me qëllim ecurinë e punës në këtë institucion.

I gjithë informacioni për çështjet në GJEDNJ apo ekzekutimin e tyre mbahet konform Ligjit “Për Arkivat”, në mënyrë të rregullt në protokollin e Avokaturës së Shtetit, ku regjistrohen të gjitha shkresat/dokumentat hyrëse dhe dalëse. Është e pamundur që ky informacion të humbasë, sikurse përcaktohet tek ndikimi/efekti i kësaj gjetjeje.

Dëshirojmë të theksojmë se, të gjitha shkresat e referuara në projekt raport janë të regjistruara në protokollin e institucionit. Regjistrat që mbahen sipas Urdhrit të Avokatit të Përgjithshëm dhe Rregullores së Institucionit, vetëm marrin pjesë nga informacioni që kanë regjistrat e protokollit apo dokumentacioni i palëve dhe i vendosin në një tabelë, në mënyrë të pëmbledhur, për të pasur një pasqyrë lakonike të ecurisë së ekzekutimit të vendimeve dhe trajtimit të çështjeve në GJEDNJ. Asnjë shkresë apo dokumentacion nuk regjistrohet në këta regjistra që kanë formë tabelare.

Mënyra e mbajtjes së tyre sipas ligjit “Për Arkivat” vetëm do të vështirësonte, publikonte dhe treplikonte punën, duke kërkuar punonjës të tjerë specifik për mbajtjen e tyre, dhe pa asnjë përfitimin në rritjen e cilësisë së punës. Aq më tepër ligji “Për Arkivat” nuk e parashikon mbajtjen e një regjistri të tillë.

Për të materializuar sa sqaruar më lart, në rast se GJEDNJ do na komunikojë një ankim apo parashtrim të kërkuesve, i cili menjëherë sa komunikohet regjistrohet në protokollin e institucionit, si çdo shkresë hyrëse, duke marrë një numër protokollit dhe datë, atëherë kjo shkresë do të vijojë të regjistrohet në regjistrin elektronik që juristi mban duke marrë numër protokollit tjetër??? Apo do rregjistrohet edhe një herë në regjistrin fizik që juristi mban, duke marrë një numër tjetër protokollit??? Pasi, nëse do t’i referohemi ligjit “Për Arkivat” çdo shkresë që hyn apo del në institucion duhet të regjistrohet. Dhe cili do ta mbajë origjinalin në fund, pasi juristi i institucionit e ka tej funksioneve të tij mbajtjen e një arkive të vogël brenda arkivës së institucionit.

Për gjithë sa sqaruar, duke respektuar dhe gjetjet e mëprashtme të KLSH është vlerësuar, duke u

sanksionuar në aktet rregullatore të sipërcituara, mënyra e mbajtjes së këtyre dy regjistrave, në të cilin shënohen vetëm si referencë nr. e shkresave që përmbajnë informacionin më të rëndësishëm për një çështje dhe që ndihmojnë më pas avokatët e shtetit, por dhe organet kontrolluese si KLSH të përftojnë informacionin që duhet.

Gjithashtu, dëshirojmë të rivendosim në vëmendjen tuaj, se vet GJEDNJ ka një regjistër elektronik, sa i takon komunikimeve që mban me Avokaturën e Shtetit në emër të Qeverisë Shqiptare, por dhe me kërkuesit që i drejtohen kësaj gjykate, në të cilën janë të hedhura dhe ruhen të gjitha komunikimet midis palëve dhe Gjykatës, gjë e cila minimizon në zero mundësinë e ndryshimit apo humbjes së të dhënave sensitive.

Në mënyrë të veçantë, dëshirojmë të theksojmë se nga institucioni ynë, në hartimin e regjistrave respektivë, janë mbajtur në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Konkretisht, me shkresën nr. 1114/9 Prot., datë 14.10.2021, protokolluar në Avokaturën e Shtetit me nr. 4425/16, datë 15.10.2021, ka dërguar Raportin Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin me objekt “Auditim Përputhshmërie“, ushtruar në Avokaturën e Shtetit. Një nga Rekomandimet e lëna nga KLSH (ky rekomandim është lënë dhe në auditimet e mëparshme të kryera nga KLSH) është: 7.2 Nga ana e Avokaturës së Shtetit të miratohet formati tip i regjistrat fizik dhe elektronik të çështjeve gjyqësore në gjykatat e huaja, ku RSH është palë, me qëllim regjistrimin e plotë të të gjithë hapave proceduriale të ndërmarra në këto procese si dhe ecurinë e njohjes dhe zbatimit të këtyre vendimeve në vendin tonë. Urdhri i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për miratimin e formatit Nr.375/2, datë 16.11.2022 (i ndryshuar) dhe mbajtja e regjistrat ka dalë pikërisht në zbatim të këtij rekomandimi.

Sa sqaruar më sipër, ju lutem të merrni në konsideratë këto shpjegime në hartimin e raportit tuaj përfundimtar.

#### ***Qëndrimi Grupit të Auditimit:***

Fillimisht risjellim në vëmendjen Tuaj se, ashtu sikundër edhe verbalisht u diskutua, ky regjistër përmbante mangësi në hartim dhe nevojitej rishikimi i mënyrës së plotësimit të tij, pasi ashtu sikundër ju vet shpreheni ky regjistër shërben si referencë gjatë punës së përditshme.

Si një dokument tek i cili Ju bazoheni për punën tuaj nevojitet të plotësoj kriteret e dokumentit zyrtar si dhe të shmang gabimet përgjatë plotësimit.

Grupit të auditimit të dhënat ju vendosën në dispozicion në formatin elektronik, të dërguara në e-mail si dhe ky regjistër fizik për të cilin është ngritur edhe konstatimi i grupit, i cili përmbante korrigjime me zbardhues dhe gabime në plotësim.

Sa i takon regjistrat të hyrje/daljeve të protokollit nuk jemi dhe nuk mund të shprehemi, pasi ky dokument nuk ka qenë pjesë e dokumenteve të audituara.

Po ashtu, në kushtet se shpreheni për auditimet e shkuara, sjellim në vëmendjen tuaj se ky është një auditim i cili ka patur fokus specifik dhe nuk mund dhe nuk është shprehur grupi auditimit mbi regjistrin e protokollit. Sa i takon shprehjes tuaj se *...Është e pamundur që ky informacion të humbasë, sikurse përcaktohet tek ndikimi/efekti i kësaj gjetjeje* nuk gjykojmë se është një frazë e cila mund të përdoret dhe të merret si bazë për të rrëzuar gjetjen pasi ngelet për tu verifikuar rast pas rasti. *Nga ana jonë, kërkohet prej jush që regjistri fizik të shmang gabimet në plotësimin e tij. Përsa më sipër, duke qenë se nuk rezultojnë bashkangjitur të dhëna dhe fakte të reja justifikuese, observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë.*

<b>Titulli i gjetjes 10:</b>	<i>Regjistri i GJEDNJ-së</i>
<b>Situata:</b>	Sa i takon dokumentimit dhe regjistrimit fizik të ndjekjes së çështjeve

	<p>gjqësore, u konstatua se,</p> <p>✓ <b>Sa i takon regjistrin të GJEDNJ-së</b> ky regjistër ka filluar të plotësohet fizikisht nga viti 2022 dhe nuk ka një databazë zyrtare të çështjeve të trajtuara në GJEDNJ.</p> <p>Nga auditimi i formatit fizik të tij, u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Regjistri në trajtën e një dokumenti zyrtar përmban korrektime, specifikisht në çështjen nr.4 në pretendim dhe objekt.</li> </ul>
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr.10018 datë 13.11.2018 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar;</li> <li>- Rregullore e Brendshme e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 29 i saj;</li> <li>- Ligji nr.9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat” si dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë;</li> <li>- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Nivel i lartë risku duke u bërë objekt ndryshimi apo humbjen e të dhënave sensitive që ai mban.
<b>Shkaku:</b>	Mos ushtrim i kujdesit të duhur ndaj këtij dokumenti zyrtar.
<b>Rekomandimi:</b>	Institucioni i ASH të marrë masat për mbajtjen e Regjistrin Modelar (në formë fizike) në kuadrin e një dokumenti zyrtar me një rëndësi të veçantë, i cili duhet të përshtatet dhe rregullohet sipas kërkesave dhe përcaktimeve të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, si dhe të hartohet e mbahet në përputhje me normat tekniko profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, për shkak të rëndësisë që ka ky dokument administrativ në këtë institucion shtetëror.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Afati i zbatimit:</b>	Menjëherë.

**Observacion i ardhur nga subjekti me shkresën nr.2178/7 prot., datë 25.08.2023 protokolluar me tonën nr.384/5 datë 28.08.2023**

**b.6 Rekomandimi 12:**

Nga ana e Avokaturës së Shtetit, të merren masa për plotësimin e dokumentacionit të sipërcituar (databazë) në përputhje me kriteret e të qenurit dokument zyrtar.

Të kryhet përshtatja dhe rregullimi sipas Ligjit nr.9154 datë 06.11.2003 "Për Arkivat" duke formatizuar dokumentin për shkak të rëndësisë që ai mbart.

**Menjëherë**

**Koment i Avokaturës së Shtetit:**

Në lidhje me këtë rekomandim ne kemi bërë kundërshtimet tona sa i takon gjetjes (3, 4 dhe 9) të Projekt Raportit. Regjistrat modelar në formë fizike dhe elektronike, mbahen sipas rekomandimeve të mëparshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregullores së Brendshme të Institucionit dhe Urdhrave respektive të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Mbajtja e regjistrave të posaçëm, i cili shpesh herë nuk është thjesht dokumentim i shkresave por dhe përpunim i tyre (pasi nxirret nga shkresat e ardhura apo të dërguara) nuk plotëson kushtet e një dokumenti zyrtar, nuk zgjidh asnjë problematikë, si shprehet grupi i punës për “shmangien e humbjes së dokumentave” edhe pse nuk ka rezultuar dokumentacion i humbur gjatë kontrollit, dhe do të sillte vetëm dublikimin apo treplikimin e mbajtjes së informacionit dhe pa asnjë rezultat.

**Qëndrimi Grupit të Auditimit:**

Fillimisht risjellim në vëmendjen Tuaj se, ashtu sikundër edhe verbalisht u diskutua, ky regjistër përmbante mangësi në hartim dhe nevojitej rishikimi i mënyrës së plotësimit të tij, pasi ashtu sikundër ju vet shpreheni ky regjistër shërben si referencë gjatë punës së përditshme.

Si një dokument tek i cili Ju bazoheni për punën tuaj nevojitet të plotësoj kriteret e dokumentit zyrtar si dhe të shmang gabimet përgjatë plotësimit.

Grupit të auditimit të dhënat ju vendosën në dispozicion në formatin elektronik, të dërguara në e-mail si dhe ky regjistër fizik për të cilin është ngritur edhe konstatimi i grupit, i cili përmbante korrigjime me zbardhues dhe gabime në plotësim.

Sa i takon regjistrin të hyrje/daljeve të protokollit nuk jemi dhe nuk mund të shprehemi, pasi ky dokument nuk ka qenë pjesë e dokumenteve të audituara.

Po ashtu, në kushtet se shpreheni për auditimet e shkuara, sjellim në vëmendjen tuaj se ky është një auditim i cili ka patur fokus specifik dhe nuk mund dhe nuk është shprehur grupi auditimit mbi regjistrin e protokollit. Sa i takon shprehjes tuaj se *...Është e pamundur që ky informacion të humbasë, sikurse përcaktohet tek ndikimi/efekti i kësaj gjetjeje nuk gjykojmë se është një frazë e cila mund të përdoret dhe të merret si bazë për të rrëzuar gjetjen pasi ngelet për tu verifikuar rast pas rasti. Nga ana jonë, kërkohet prej jush që regjistri fizik të shmang gabimet në plotësimin e tij. Përsa më sipër, duke qenë se nuk rezultojnë bashkangjitur të dhëna dhe fakte të reja justifikuese, observacioni mësipërm nuk merret në konsideratë.*

**11. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i dosjeve fizike të vendimeve të GJEDNJ-së u konstatua se, në tërësi këto dosje mbartnin parregullsi në mënyrën e mbajtjes së tyre, mungonte fleta e inventarit për çdo dosje respektive, e për pasojë nuk është bërë numërimi i fletëve dhe numërim total i tyre sipas ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, Normat Tekniko-Ligjore dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor, neni 30 “Inventari i brendshëm i dosjes”, që për shkak të sensitivitetit të informacionit, gjykohet si risk i shtuar dhe duhet vlerësuar nga ASH.

<b>Titulli i gjetjes 11:</b>	<i>Dosjet e GJEDNJ-së</i>
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i dosjeve fizike të vendimeve të GJEDNJ-së u konstatua se, në tërësi këto dosje mbartnin parregullsi në mënyrën e mbajtjes së tyre, mungonte fleta e inventarit për çdo dosje respektive, e për pasojë nuk është bërë numërimi i fletëve dhe numërim total i tyre sipas ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, Normat Tekniko-Ligjore dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor, neni 30 “Inventari i brendshëm i dosjes” që për shkak të sensitivitetit të informacionit, gjykohet si risk i shtuar dhe duhet vlerësuar nga ASH.
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr.10018 datë 13.11.2018 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar;</li> <li>- Rregullore e Brendshme e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr. 68 datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 29 i saj;</li> <li>- Ligji nr.9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat” si dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë;</li> <li>- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Nivel i lartë risku duke u bërë objekt ndryshimi apo humbje në të dhënat sensitive që ai mban.

<b>Shkak:</b>	Mos ushtrim i kujdesit të duhur ndaj këtij dokumenti zyrtar.
<b>Rekomandimi:</b>	Avokatura e Shtetit të marr masa për inventarizimin e dosjeve për të gjitha vendimet e GJEDNJ-së dhe të mbaj ënë konsideratë që ruajtja dhe dokumentimi i tyre duhet të përshtatet dhe rregullohet sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe normave tekniko profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Afati i zbatimit:</b>	Brenda datës 31.12.2023.

### **12. Gjetje nga auditimi:**

Në përfundim të proceseve gjyqësore në GJEDNJ të cilët kanë rezultuar me penalitete nga auditimi u konstatua se mungonte një analizë e çështjeve gjyqësore të humbura, e për pasojë në asnjë rast nuk konstatohet adresimi i problematikave të tyre, shkaqet, masat që duhet të merren ndaj shkaktarëve, apo sugjerimet/propozimet për Këshillin e Ministrave mbi hapat e nevojshëm për tu ndërmarrë në të ardhmen, me qëllim evitimin e veprimeve të padrejta dhe/ose abuzive në të ardhmen.

### **Observacion i ardhur nga subjekti me shkresën nr.2178/7 prot., datë 25.08.2023 protokolluar me tonën nr.384/5 datë 28.08.2023**

Sipas Projekt Raportit: Në përfundim të proceseve gjyqësore në GJEDNJ, të cilët kanë rezultuar me penalitete nga auditimi u konstatua se, mungonte një analizë e çështjeve gjyqësore të humbura e për pasojë në asnjë rast nuk konstatohet adresimi i problematikave të tyre, shkaqet, masat që duhet të ndërmerren ndaj shkaktarëve, apo sugjerimet/propozimet për Këshillin e Ministrave mbi hapat e nevojshëm për tu ndërmarrë në të ardhmen, me qëllim evitimin e veprimeve të padrejta dhe abuzive në të ardhmen. (Fq.56 e auditimit)

#### **Komentet e Avokaturës së Shtetit:**

Sikurse është parashtruar nga ana jonë në kundërshtimet e akt kontrolleve, por edhe gjatë kontrollit të ushtruar, Avokatura e Shtetit në respektim të detyrimeve ligjore, sipas afateve të parashikuara në ligj, pasi vendimi mer formë të prerë, një kopje e vendimit së bashku me një shkresë përcjellëse, e cila përmbledh në mënyrë analitike të gjitha shkeljet e evidentuara në vendim i dërgohet nga Avokatura e Shtetit, Gjykatës Kushtetuese, Gykatës së Lartë, Shkollës së Magjistraturës dhe të gjitha institucioneve përgjegjëse, që sipas vendimit janë të përfshira në çështjen konkrete. Në faqen 23 dhe 24 të Projekt Raportit, pasqyrohen disa nga ndryshimet e praktikës dhe ligjore që kanë ndodhur pas vendimmarrjes së GJEDNJ-së, të cilat janë iniciuar nga Avokatura e Përgjithshme. Edhe në aneksin shoqërues të Projekt Raportit nga faqja 70 - 84, pasqyrohet puna e Avokaturës së Shtetit, në hartimin dhe ekzekutimin e masave të përgjithshme, në mënyrë që shkelje të tilla të mos përsëriten në të ardhmen. Dëshirojmë të theksojmë se, jo çdo vendim i GJEDNJ-së përmban domosdoshmërisht shkelje që kërkojnë ndryshime ligjore apo që duhen analizuar në mënyrë specifike.

Nga gjithë masat e përgjithshme të sugjeruara nga ana jonë, në bashkëpunim me institucionet zbatuese, na lejoni të përmendim disa prej tyre, si psh. Për ekzekutimin e vendimit “Z. k. Sh.” ka komunikime sa i takon masave të përgjithshme dhe individuale me Spitalin Universitar të Traumës, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve (fq.75 e Projekt Raportit). Për çështjen “B. k. Sh.”, ka komunikime të vazhdueshme me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, sa i takon masave që duhen ndërmarrë për ndryshimet në rregulloren

për sjelljen e policisë së burgjeve, masat ndërgjegjësuere, trajnimin e oficerëve të burgjeve në respektim të të drejtave dhe lirive të të burgosurve. Për çështjen “X. k. Sh.” Avokatura e Shtetit ka pasur bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Arsimit, Bashkinë Korçë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me qëllim identifikimin e masave të përshtatshme për ndalimin e diskriminimit të pakicave romë në shkollat 8 vjeçare. Një bashkëpunim që vijon akoma me sukses edhe me pjesmarrjen e Këshillit të Europës në Tiranë dhe ekspertëve të tij.

Për më tepër, dëshirojmë të theksojmë se vet Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut bën një analizë të saktë të shkeljes së konstatuar, analizë që përcillet nga Avokatura e Shtetit tek institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre dhe pranë Këshillit të Ministrave kur kërkohet ndërhyrja e këtij të fundit. Gjithashtu, planet e veprimit që hartohen për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, hartohen nga Avokatura e Shtetit në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ-së pranë Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, si dhe institucionet vendase.

Në përfundim, dëshirojmë të theksojmë se Avokatura e Shtetit ndjek ekzekutimin e masave individuale dhe të përgjithshme të parashikuara në vendimet e GJEDNJ-së, pas një analize të kujdesshme me institucionet përgjegjëse vendase dhe Departamentin e Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ-së, në respektim të nenit 19/7 të Ligjit Për Avokaturën e Shtetit.

Duke qenë se procesi i ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së monitorohet nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës me anë të Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve, i cili kërkon hartimin e planit të masave për ato vendime që kanë të tilla (pasi jo të gjitha vendimet kanë plan masash) është e pamundur që mos të bëhet një analizë e gjithë situatës vendase, praktike dhe ligjore, që ka çuar në shkeljen e konstatuar, me qëllim identifikimin e masave konkrete që duhen ndërmarrë që ato mos të përsëriten më në të ardhmen, pasi ky është dhe qëllimi final i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe parashikimeve ligjore në ligjin “Për Avokaturën e Shtetit”.

Sa sqaruar më sipër, ju lutem të merrni në konsideratë këto shpjegime në hartimin e raportit tuaj përfundimtar.

#### ***Qëndrimi Grupit të Auditimit:***

Risjellim në vëmendjen tuaj se, ashtu sikundër Ju vet shpreheni, *vendimi i Gjykatës evidenton veprimet/mosveprimet dhe elementet e shkeljes së Konventës dhe në raste të caktuara tregojnë dhe udhëzojnë për marrjen e masave konkrete individuale por dhe të përgjithshme, për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhme, pra praktikisht evidentoni praninë e pjesës së asaj çka grupi auditimit insinuan të shpreh.*

*Ju shpreheni se ...Duke qenë se procesi i ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së monitorohet nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës me anë të Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve, i cili kërkon hartimin e planit të masave për ato vendime që kanë të tilla (pasi jo të gjitha vendimet kanë plan masash) është e pamundur që mos të bëhet një analizë e gjithë situatës vendase, praktike dhe ligjore, që ka çuar në shkeljen e konstatuar, me qëllim identifikimin e masave konkrete që duhen ndërmarrë që ato mos të përsëriten më në të ardhmen, pasi ky është dhe qëllimi final i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe parashikimeve ligjore në ligjin “Për Avokaturën e Shtetit”.*

Por grupi auditimit nuk ka patur në dispozicion një dokument të tillë, pra gjurmë të një analize të të gjithë situatës vendase, praktike dhe ligjore

Për shkak të impaktit të drejtpërdrejtë në paranë publikë, grupi auditimit, ashtu sikundër e ka diskutuar këtë çështje me në rolin e personit të kontaktit, i referohet si të efektshme vlerësimi të

mundësisë së kryerjes së një analize të mirëfilltë në fund të çdo vit, ku të jenë të detajuara çështjet e trajtuara, ato të fituara dhe ato të humbura. Si dhe problematikat që kanë çuar në humbje të çështjeve. Në këto kushte do të kontribuohet në ndërtimin e një sistemi proaktiv menaxhimi financiar.

Përsa më sipër, duke qenë se nuk rezultojnë bashkangjitur të dhëna dhe fakte të reja justifikuese, observacioni mësipërm **nuk merret në konsideratë.**

<b>Titulli i gjetjes 12:</b>	<i>Analizë e çështjeve gjyqësore të humbura</i>
<b>Situata:</b>	Në përfundim të proceseve gjyqësore në GJEDNJ të cilët kanë rezultuar me penalitete nga auditimi u konstatua se, mungonte një analizë e çështjeve gjyqësore të humbura, e për pasojë në asnjë rast nuk konstatohet adresimi i problematikave të tyre, shkaqet, masat që duhet të merren ndaj shkaktarëve, apo sugjerimet/propozimet për Këshillin e Ministrave mbi hapat e nevojshëm për tu ndërmarrë në të ardhmen, me qëllim evitimin e veprimeve të padrejta dhe/ose abuzive në të ardhmen.
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr.10018 datë 13.11.2018 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar;</li> <li>- Rregullore e Brendshme e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhër nr. 68 datë 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 29 i saj;</li> <li>- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Nivel i lartë risku duke u bërë objekt ndryshimi apo humbje në të dhënat sensitive që ai mban.
<b>Shkaku:</b>	Mos ushtrim i kujdesit të duhur ndaj këtij dokumenti zyrtar.
<b>Rekomandimi:</b>	Nga ana e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit të vlerësohet mundësia e realizimit të një analize të thelluar të rasteve gjyqësore të humbura për të identifikuar shkaqet që kanë sjellë për pasojë humbjen e çështjeve gjyqësore dhe dëmtim të interesave shtetërore, meqë në sipas ligjit organik, Avokatura e Shtetit ka të drejtën të sugjerojë masa të përgjithshme parandaluese, në lidhje me ndryshimet e nevojshme të legjislacionit apo praktikave, të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Afati i zbatimit:</b>	Menjëherë.

***Observacion i ardhur nga subjekti me shkresën nr.2178/7 prot., datë 25.08.2023 protokolluar me tonën nr.384/5 datë 28.08.2023***

*Observacion mbi rekomandimin e mësipërm*

***b.3 Rekomandimi 4:***

*Nga ana e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit të vlerësohet mundësia e realizimit të një analize të thelluar të rasteve gjyqësore të humbura për të identifikuar shkaqet që kanë sjellë për pasojë humbjen e çështjeve gjyqësore dhe dëmtim të interesave shtetërore.*

***Menjëherë***

**Shpjegimet e Avokaturës së Shtetit:**

*Në lidhje me këtë rekomandim, sikurse kemi sqaruar edhe në kundërshtimet tona në gjetjen nr.11, Avokatura e Shtetit për çdo vendim apo grup vendimesh në fazë ekzekutimi, në bashkëpunim me Departamentin e Ekzekutimeve të Vendimeve të GJEDNJ-së pranë Komitetit të Ministrave të KE si dhe institucionet kompetente për shkëlqen e konstatuar, bën analizë dhe*

identifikon masat e nevojshme që duhen ndërmarrë për zbatimin e tyre, dhe mospërsëritjen e shkeljeve të tilla në të ardhmen. Masa të cilat janë pasqyruar dhe në Projekt Raport.

**Qëndrimi Grupit të Auditimit:**

Risjellim në vëmendjen tuaj se, ashtu sikundër Ju vet shpreheni, vendimi i Gjykatës evidenton veprimet/mosveprimet dhe elementet e shkeljes së Konventës dhe në raste të caktuara tregon dhe udhëzon për marrjen e masave konkrete individuale por dhe të përgjithshme, për të parandaluar shkelje të ngjashme në të ardhme, pra praktikisht evidentoni praninë e pjesshme të asaj çka grupi auditimit insinuo të shpreh.

Ju shpreheni se ...Duke qenë se procesi i ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së monitorohet nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës me anë të Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve, i cili kërkon hartimin e planit të masave për ato vendime që kanë të tilla (pasi jo të gjitha vendimet kanë plan masash) është e pamundur që mos të bëhet një analizë e gjithë situatës vendase, praktike dhe ligjore, që ka çuar në shkeljen e konstatuar, me qëllim identifikimin e masave konkrete që duhen ndërmarrë që ato mos të përsëriten më në të ardhmen, pasi ky është dhe qëllimi final i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe parashikimeve ligjore në ligjin “Për Avokaturën e Shtetit”.

Por grupi auditimit nuk ka patur në dispozicion një dokument të tillë, pra gjurmë të një analize të të gjithë situatës vendase, praktike dhe ligjore

Për shkak të impaktit të drejtpërdrejtë në paranë publikë, grupi auditimit, ashtu sikundër e ka diskutuar këtë çështje me në rolin e personit të kontaktit, i referohet si të efektshme vlerësimin të mundësisë së kryerjes së një analize të mirëfilltë në fund të çdo vit, ku të jenë të detajuara çështjet e trajtuara, ato të fituara dhe ato të humbura. Si dhe problematikat që kanë çuar në humbje të çështjeve. Në këto kushte do të kontribuohet në ndërtimin e një sistemi proaktiv menaxhimi financiar.

Përsa më sipër, duke qenë se nuk rezultojnë bashkangjitur të dhëna dhe fakte të reja justifikuese, observacioni mësipërm **nuk merret në konsideratë.**

*Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Gjykatën Evropiane të Njeriut është mbajtur Akt Konstatim nr.1 me nr.2178/3 prot., datë 23.06.2023 dhe personat e atakuar janë z. O. M. me detyrë Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, me cilësinë e titullarit të Institucionit, znj. M. I. me detyrë Drejtuese e Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar, znj. E. D. me detyrë Avokate Shteti në Zyrën e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar dhe znj. J. Z. me detyrë Juriste në Zyrën e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar me cilësinë e personit` përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të GJEDNJ-së.*



*Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:*

## **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

#### ***1. Gjetje nga auditimi:***

Nga auditimi ka rezultuar se, për proceset gjyqësore të përfunduara në GJEDNJ dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar, nga të cilat kanë rezultuar detyrime e pagesa të fondeve të buxhetit të shtetit, si dhe në disa raste penalitete për mos likuidimin e detyrimeve në afatet e parashikuara, ka munguar një analizë e çështjeve gjyqësore të humbura nga ana e institucioneve shtetërore pjesë e këtyre proceseve dhe Avokatura e Shtetit. Për pasojë, në asnjë rast nuk konstatohet adresim i problematikave të rezultuara prej tyre, mungon analiza e thelluar e shkaqeve dhe e masave që duhet të ndërmerren ndaj shkaktarëve, apo sugjerime/propozime për Këshillin e Ministrave mbi hapat e nevojshëm me qëllim kryerjen me korrektësi të procedurave të përfaqësimit ligjor dhe shmangies, për atë që është e mundur, e ngarkimit të kostove abuzive shtesë për financat publike, të cilat impaktojnë buxhetin e shtetit gjatë periudhave të ardhshme.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe 62 - 66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

#### **1.1. Rekomandimi:**

Nga ana e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit dhe institucioneve shtetërore përgjegjëse, (pjesë në proceset e ngritura pranë gjykatave ndërkombëtare dhe të huaja), të merren masat për:

- koordinimin, bashkërendimin e punës dhe mbikëqyrjen dhe kryerjen e një analize të thelluar të çështjeve gjyqësore të humbura nga ana e institucioneve shtetërore, për të identifikuar shkaqet që kanë sjellë për pasojë humbjen e tyre dhe dëmtimin e interesave shtetërore;
- programimin në këtë kuadër të masave që duhet të ndërmerren ndaj shkaktarëve, si dhe hartimin e propozimeve për Këshillin e Ministrave për ndërmarrjen e nismave ligjore për plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi, apo
- hapat e nevojshëm që duhen ndërmarrë me qëllim mbrojtjen interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave ndërkombëtare dhe të huaja, dhe evitimin e veprimeve të pakoordinuara dhe/ose kostot abuzive shtesë, që impaktojnë financat publike në të ardhmen.

*Menjëherë e në vijimësi*

#### ***2. Gjetje nga auditimi:***

Nga auditimi rezulton se, për periudhën 2021-2022, mungon gjurma e rikrijimit dhe e funksionimit të Këshillit Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së.

Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së evidentohet të ketë ushtruar veprimtarinë e tij deri në shkurt të vitit 2021, ndonëse ai ka si funksion orientimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë me Avokaturën e Shtetit mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), përcaktimin e planit të punës/veprimit me afate konkrete për realizimin e detyrave në kuadër të ekzekutimit të vendimeve, apo paraqitjes së rekomandimeve/zgjidhjeve të mundshme, në kuadër të këtij plani, etj. Sa më sipër, nuk kanë gjetur zbatim përcaktimet e nenit 19/8, “Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së”, Kreu V/I, i Ligjit nr.10018, datë 13.11.2018 “Për avokaturën e shtetit, i ndryshuar me ligjin Nr. 86/2018.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe 56 - 60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### **2.1. Rekomandimi:**

Për shkak të rolit që ka Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së, si dhe faktit që domosdoshmëria e funksionimit të tij është përcaktuar në kuadrin ligjor përkatës, (neni 19/8, i Ligjit nr.10018, datë 13.11.2018, i ndryshuar), kërkohet që, të merren masat nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, që, pas një procesi transparent të përzgjedhjes së kandidaturave për në Këshillin Konsultativ, të dërgohen propozimet e tij pranë Kryeministrit të Shqipërisë, me qëllim kompozimin e këtij organi dhe përmbushjen e funksioneve dhe qëllimit të parashikuar nga ligjvënësi.

*Menjëherë e në vijimësi*

### **3. Gjetje nga auditimi:**

Sa i takon dokumentimit dhe regjistrimit fizik të çështjeve gjyqësore, si dhe informacionit mbi ndjekjen e tyre, u konstatua se,

- ✓ ***Sa i takon regjistrin të GJEDNJ-së*** ky regjistër ka filluar të plotësohet fizikisht nga viti 2022 dhe nuk ka një databazë zyrtare të çështjeve të trajtuara në GJEDNJ. Nga auditimi i formatit fizik të tij, u konstatua se Regjistri në trajtën e një dokumenti zyrtar përmban korrektime, *(specifikisht në çështjen nr.4, në pretendim dhe objekt);*
- ✓ ***Sa i takon regjistrin të Arbitrazhit Ndërkombëtar*** ky regjistër ka filluar të plotësohet fizikisht nga viti 2022 dhe mungon një databazë zyrtare të çështjeve të trajtuara në Arbitrazhin Ndërkombëtar, nuk ka gjurmë mbi të dhënat dhe vlerat reale (totale) të efekteve financiare për të gjitha çështjet që kanë përfunduar shqyrtimin e Arbitrazhit Ndërkombëtar dhe ato që janë ende në proces shqyrtimi.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe 26 – 29 dhe 59 - 62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### **3.1. Rekomandimi:**

Institucioni i Avokaturës së Shtetit të marrë masat për miratimin dhe mbajtjen e Regjistrin Modelar (në formë fizike) si një dokument zyrtar me rëndësi të veçantë në garantimin e vijueshmërisë së ndjekjes së çështjeve dhe përfaqësimit por dhe garantimin e një gjurme auditimi sipas kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Këto regjistra duhet të përshtaten dhe modifikohen sipas kërkesave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr.10018, datë 13.11.2018 i ndryshuar, si dhe përcaktimet e Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” i ndryshuar dhe normat tekniko profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, për shkak të rëndësisë që ka ky dokument administrativ për këtë institucion shtetëror.

*Menjëherë e në vijimësi*

### **4. Gjetje nga auditimi:**

***-Në lidhje me 4 (katër) çështjet në proces gjyqësor në Arbitrazhin Ndërkombëtar,*** nga auditimi rezulton se, janë 3 (tre) padi të nisura për 2021 dhe 1 (një) e nisur në vitin 2022 të cilat vijojnë të kenë këtë status. Efektet potenciale të tyre rezultojnë të jenë, 3 (tre) me dëm të mundshëm për buxhetin e shtetit në vlerën 160,224,810 EURO, dhe 2,788,933 lekë, si dhe 1 (një) me të ardhura të mundshme potenciale të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 2,405,682.4 EURO dhe 14,630,050,747 lekë.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe 19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

*-Në lidhje me 2 (dy) çështjet e përfunduara në Arbitrazhin Ndërkombëtar me një vendim, ku kanë lindur detyrime dhe të drejta për institucionet e shtetit shqiptar, por nuk kanë vijuar kërkesat për njohje vendimi në Gjykatën e Apelit Vendas, rezultoi përkatësisht:*

- ✓ Në 1 (një) rast me efektin e dëmit të mundshëm për buxhetin e shtetit (ku palë e paditur është “A. R. Sh.” me një detyrim të shtetit shqiptar sipas Tribunalit të Arbitrazhit në vlerën 44,262,681.77 USD dhe 573,081,13 Euro, si dhe
- ✓ Në 1 (një) rast me efektin e të ardhurave të munguara për buxhetin e shtetit (ku palë e paditur është “M. T. dhe M.” me një detyrim të palëve të treta sipas Tribunalit të Arbitrazhit kundrejt R. së Sh. në vlerën 2,407,000 Euro, 427,488.72 USD dhe 106,755 £.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe 19 - 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

#### **4.1. Rekomandimi:**

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit të koordinojë veprimet me drejtuesit e institucioneve shtetërore-palë në proceset gjyqësore, për mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave ndërkombëtare dhe të huaja, ndjekjen e procedurës së ekzekutimit për njohjen e vendimit në Gjykatën e Apelit Vendas, në mënyrë të tillë të përfitohet në kohë vlera e të ardhurave të përcaktuara në vendimin e Tribunalit të Arbitrazhit, si dhe të tregohet kujdesi i duhur për minimizimin e efekteve negative në buxhet që shkaktohen prej interesave nga penalitetet e mos përmbushjes së afateve të ekzekutimit të këtyre vendimeve.

***Menjëherë***

#### **5. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi rezultoi se, nga ana e institucioneve shqiptare pjesë e procesit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), nuk rezulton të kenë gjetur zbatim afatet 3 (tre) mujore për zbatimin e këtyre Vendimeve, sipas parashikimeve të dispozitivit të këtyre vendimeve si dhe të nenin 19/4, të Ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, që shpreh se “Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë”.

Në total gjatë periudhës nën auditim, (vitet 2021-2022), evidentohen **5 (pesë) vendime të pa ekzekutuara** me një vlerë financiare (vetëm principal) prej **17.911.600 Euro**, pa përfshirë këtu interesat e pagueshëm në rast vonesash, referuar pikës 3, të nenit 19/5 në ligjin e sipërcituar. **Vlera e referuar më lartë mund të rritet për shkak të penaliteteve si rrjedhojë e vonesave dhe mosrespektimit të afateve të ekzekutimit të vendimit.**

*(Referuar likuidimit të dy çështjeve përgjatë vitit 2023, kosto aktuale potenciale, e vitit 2023, që ekspozohet buxheti shtetit nga moszbatimi i 3 (tre) prej vendimeve të GJEDNJ-së rezulton të jetë **17,880,650 Euro** e cila do të vijojë të rritet edhe më për shkak të penaliteteve të shtuara si rrjedhojë e vonesave).*

**Vendimet e pazbatuara datojnë që prej vitit 2015 deri në vitin 2021**, dy prej tyre përbëjnë dhe peshën kryesore të vlerës financiare për tu përballuar nga buxheti i shtetit, përkatësisht:

- Peshën më të lartë e mban çështja “Sh. k. Sh.”, mbartur prej vitit 2018, (me 75% të totalit të vlerës), e cila vijon të jetë në proces për shkak të mungesës së fondeve të buxhetit të shtetit, ku vetëm vlera e shpërblimit të drejtë të akorduar rezulton të jetë **13,447,300 Euro**, vlerë e cila pritet të shtohet për shkak të interesave.

- Çështja “D. k. Sh.” mbartur prej vitit 2015, vijon në proces pritje të miratimit të VKM-së ku vetëm vlera e shpërblimit të drejtë të akorduar rezulton të jetë **15.600 Euro**, vlerë e cila pritet të shtohet për shkak të interesave.

***Mosekzekutimi në afat i këtyre detyrimeve krijon risk për aplikim interesash të pagueshme në vlera të konsiderueshme.***

Mosveprimi ose veprimet me vonesë nga ana e institucioneve respektive në këtë çështje krijojnë risk të lartë për efekte të tjera shtesë në dëm të buxhetit të shtetit, gjë që kërkon vëmendje të shtuar në vijim nga ana e ASH-së si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre vendimeve, por veçanërisht nga MFE e cila vijon në mospërputhje me qëndrimet ligjore të njëjësive të specializuara, siç është Avokatura e Shtetit.

*(Më hollësisht në faqe nr. 40 - 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1.Rekomandimi:**

✓ Avokatura e Shtetit, edhe në rolin e njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së si dhe rolin e përfaqësuesit përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës lidhur me ekzekutimin e këtyre lloj vendimeve, të informojë Këshillin e Ministrave për vendimet ende të pa ekzekutuara si dhe të intensifikojë marrëdhënien me MEF-në për sa i takon vlerës së interesave financiare që vjen për moszbatim të afatit të likuidimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë që ekspozojnë buxhetin e shtetit në vlera të konsiderueshme.

✓ Për shkak të impaktit të lartë të çështjes (pasi preket buxheti i shtetit), me qëllim ndërtimin dhe funksionimin e një sistemi proaktiv të menaxhimit financiar dhe nga ana tjetër mirë menaxhimin me sa më efektivitet të parashë publikë, ASH të ndjekë procesin nëpër të gjitha hallkat me qëllim finalizimin me sukses të tij, duke evidentuar shkeljet dhe mosveprimet e institucioneve respektive vendase, të cilat duhen adresuar me qëllim nxjerrjen e përgjegjësisë përkatëse.

*Në këtë kuadër, ASH të koordinojë veprimet me institucionet e mëposhtme për sa vijon:*

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ndërmarrë në mënyrë urgjente masa për programimin dhe shlyerjen e vlerave të detyrimeve që mbarten prej vitit 2015 e 2018, dhe që zënë peshë të lartë në këto detyrime, qoftë edhe përmes shlyerjeve pjesore të tyre.
- Kryeministria në bashkëpunim me Këshillin e Ministrave të marrin masa urgjente për nxjerrjen e VKM me qëllim shlyerjen e vlerës së detyrimeve të mbartura prej vitit 2015, me qëllim frenimin e pagesës së mëtejshme të interesave nga buxheti i shtetit.

***Menjëherë e në vijimësi***

***6. Gjetje nga auditimi:***

Nga auditimi i dosjeve fizike të vendimeve të GJEDNJ-së u konstatua se, në tërësi këto dosje mbartnin parregullsi në mënyrën e mbajtjes së tyre, mungonte fleta e inventarit për çdo dosje respektive, e për pasojë nuk është bërë numërimi i fletëve dhe inventarizimi/numërimi total i tyre, sipas ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, Normat Tekniko-Ligjore dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor, neni 30 “Inventari i brendshëm i dosjes” që për shkak të sensitivitetit të informacionit, gjykohet si risk i shtuar dhe duhet vlerësuar nga ASH.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe 62 - 63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### **6.1 Rekomandimi:**

Avokatura e Shtetit të marrë masa, për inventarizimin e dosjeve për të gjitha vendimet e GJEDNJ-së dhe të mbajë në konsideratë që ruajtja dhe dokumentimi i tyre duhet ti nënshtrohet kërkesave të Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe Normave Tekniko Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

*Menjëherë e në vijimësi*

### **7. Gjetje nga auditimi:**

Procesi i arbitrazhit, i regjistruar me nr. “*ICSID ARB/14/26*” ka përfunduar me Vendimin e Tribunalit të datës 3 mars 2020, i cili i ka dhënë të drejtë pretendimeve të RSH dhe ka rrëzuar të gjitha kërkesat e paditësve. Kjo çështje ka përfunduar në Arbitrazh Ndërkombëtar me vendim, por nuk ka ende asnjë kërkesë për njohje vendimi në Gjykatën e Apelit Vendas. Detyrimi i vendosur nga Tribunali i Arbitrazhit është në vlerën e 2,407,000 Euro; 427,488.72 USD dhe 106,755 £.

Dispozitivi ka përcaktuar njohjen e llogaritjeve si penalitet, nëse do të ketë vonesa në pagimin e këtyre kostove dhe interesi do të shtohet mbi shumat që mbeten të papaguara në normën prej 2% të interesit të përbërë, derisa të paguhen kostot, duke filluar nga dita e 28-të e dorëzimit të vendimit.

*Si pasojë e mosveprimit në kohë nga autoritetet shtetërore si palë të interesuara, për njohje të vendimit nga Gjykata e Apelit, nuk janë arkëtuar për llogari të buxhetit të shtetit shumat prej 2,407,000 Euro; 427,488.72 USD dhe 106,755 £. (Më hollësisht trajtuar në faqe 19 - 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### **7.1 Rekomandimi:**

*Në këtë kuadër, ASH të koordinojë veprimet me institucionet e mëposhtme për sa vijon:*

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa të menjëhershme si palë në proces për ndjekjen e procedurës së ekzekutimit për njohjen e vendimit në Gjykatën e Apelit Vendas, në mënyrë të tillë të përfitojë në kohë vlerën e të ardhurave të përcaktuara në vendimin e Tribunalit të Arbitrazhit.

*Menjëherë*

### **8. Gjetje nga auditimi:**

Në lidhje me çështjen e iniciuar në vitin 2017, me nr.22676/ GR “*G. O.*” dhe palë të paditur MIE, AKBN dhe A. sha, vendimi i arbitrazhit është lëshuar më datë 06.07.2020 dhe i është përcjellë MIE dhe AKBN me shkresën nr. 1526/3 Prot., datë 29.07.2020 të Avokaturës së Shtetit. Avokatura e Shtetit përmes shkresës nr. 2886/1 Prot., datë 07.06.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë është njohur me vendimmarrjen e kësaj gjykate e cila me vendimin nr.49 datë 04.05.2021 ka vendosur të pranojë kërkesën e Shoqërisë “*G. O. C.*” për njohjen dhe dhënien fuqi juridike të vendimit të arbitrazhit. Avokatura e Shtetit ka informuar MIE me shkresën nr. 1526/23 Prot., datë 07.07.2021 dhe Avokatura e Shtetit ka paraqitur në Gjykatë të Lartë Rekursin ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit.

Vendimi i Gjykatës së Apelit nr.49 datë 04.05.2021 në dispozitivin e tij urdhëron që MIE dhe AKBN duhet ti paguajë paditësit **12,557,852 USD** si dëmshpërblim për shkeljen e detyrimeve, po ashtu urdhëron që të paditurit të paguajnë shumat **prej 292,760 USD dhe 14,451.68 EURO**, me interes me normën 5% që nga data e këtij vendimi deri sa të bëhet pagesa e plotë.

Totali i interesave të pagueshme deri në 31.12.2022 sipas përlogaritjeve të grupit të auditimit rezulton të jenë **1,042,411 USD; 24,263 USD; 1,198 Euro**, që i shtohen vlerës së principalit të vendosur në vendimin e arbitrazhit.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe 24 - 25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### **8.1.Rekomandimi:**

*Në këtë kuadër, ASH të koordinojë veprimet me institucionet e mëposhtme për sa vijon:*

MIE, AKBN dhe A. sha të vlerësojnë dhe marrin masat për provigjonimin e shumave sipas vendimit të Gjykatës së Apelit, dhe planifikimin e fondeve në PBA dhe Buxhetin Vjetor për likuidim e tyre, në mënyrë të tillë që të shmanget rritja e interesave sipas vendimit të arbitrazhit.

***Menjëherë***

### **9. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi u konstatua se, pranë GJEDNJ-së janë edhe 30 çështje me statusin “*Kërkesa në shqyrtim, por pa vendim*”, ku praktika më e hershme daton prej vitit 2011, për të cilat Gjykata nuk është shprehur ende. Vlera ekonomike sipas pretendimit të palëve paditëse rezulton të jetë rreth **151,914,617 Euro** dhe **115,300,417 ALL**, por këto vlera mund të jenë të ndryshueshme në varësi të ecurisë së çështjes në gjykim, rast pas rasti.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe 49 - 53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### **9.1 Rekomandimi:**

Avokatura e Shtetit, në rolin e njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së si dhe rolin e përfaqësuesit përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës të marrë masat në vijim, që:

- ✓ Të intensifikohen veprimet me zyrat e avokatëve dhe të përfaqësive të saj, me qëllim fitimin e çështjeve dhe mbrojtjen e interesave pasurorë të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë publikë.
- ✓ Të informojë Këshillin e Ministrave për ecurinë e çështjeve si dhe të intensifikojë marrëdhënien me MEF përsa i takon provigjonimit të vlerave që ekspozojnë buxhetin e shtetit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

### **10. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i praktikave lidhur me ato çështje ku në vendimet e formës së prerë të nxjerrë nga GJEDNJ është akorduar shpërblim i drejtë me vlerë principali *mbi vlerën 10,000 (dhjetë mijë) Euro*, e rrjedhimisht pagesa e të cilave ekzekutohet përmes nxjerrjes së një VKM përkatëse pas njoftimit nga ana e Avokaturës së Shtetit, rezultoi se, ***për 5 nga 6 çështjet e trajtuara, këto ekzekutime janë kryer me vonesë dhe impakti financiar në trajtën e interesave të shkaktuara nga vonesat ka qenë rreth 148,731 lekë***, respektivisht:

- ✓ 5 prej tyre për shkak se VKM respektive kanë dalë përtej afatit të cituar në vendimin e formës së prerë si datë finale për tu ekzekutuar vlera financiare, megjithëse nga ana e ASH shkresat janë nisur në përputhje të afateve kohore të caktuara) dhe
- ✓ 1 rast vonesa është shkaktuar si rrjedhojë e MFE-së, ngaqë ekzekutimi i vlerës ka ndodhur me vonesë.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe 35 - 40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

### **10.1 Rekomandimi:**

Këshilli Ministrave, Ministria për Financat dhe Ekonominë si dhe institucionet e tjera bashkëpunuese me Avokaturën e Shtetit, të marrin masa për njohje dhe zbatim të Vendimeve të nxjerra nga gjykatat e huaja, konkretisht nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut brenda afateve kohore të shprehura në këto vendime, në mënyrë që të shmangët rëndimi i buxhetit të shtetit me kosto të tepërta.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

### **11. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i praktikave ku vlera e detyrimit financiar të vendosur në trajtën e shpërblimit të drejtë me vendim të GJEDNJ-së ishte *deri 10 (dhjetë) mijë Euro*, pagesa e të cilave ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ministria përgjegjëse për financat (MFE) pas njoftimit nga Avokatura e Shtetit, u konstatuan 2 (dy) raste të ekzekutimit të vlerave me penalitet, sipas nenit 19/5 “Pagesa e dëmeve/kompensimeve”, pika 2 të ligjit nr.10018, datë 13.11.2018, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në faqe 39 – 43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

### **11.1 Rekomandimi:**

Avokatura e Shtetit, të koordinojë punë me institucionet e shtetit pavarësisht në përmbushje të detyrave funksionale, me qëllim menaxhimin sa më me efektivitet të fondeve publike, duke ndjekur në vijimësi procesin e finalizimit të likuidimit të vendimeve gjyqësore nga Gjykatat Ndërkombëtare e të huaja me qëllim realizimin në kohë të shpërblimit të drejtë dhënë në vendimet e GJEDNJ-së.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

### **12. Gjetje nga auditimi:**

a. Nga auditimi i ekzekutimit dhe shlyerjes së *detyrimeve që rrjedhin nga Arbitrazhi Ndërkombëtar* rezulton se, sipas Raportit Vjetor për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2022, të hartuar nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, (fq.61):

- Qeveria ka regjistruar totalin e detyrimit fillestar më 1.1.2022 për 12 institucione shpenzuese, në vlerën 192.6 milionë Euro; Detyrimet e faturuara janë për 62,6 milionë Euro; Likuiduar gjithsej 18,2 milionë Euro, (nga e cila, pjesa e likuiduar gjatë vitit 2022 është vetëm 7,9 milionë Euro); Detyrimi i mbetur 63 milionë Euro; Detyrimet kontigjente janë vendosur për 111 milionë Euro, duke arritur në totalin e detyrimit të mbetur dhe kontigjent (së bashku) për 174 milionë Euro, gjë që tregon për një nivel shumë të lartë të këtyre detyrimeve me impakt ndaj buxhetit të shtetit.

Nga ana e MFE në këtë raport është vendosur shënimi se, “*informacioni bazohet në të dhënat më të fundit që janë të muajit maj 2023, të raportuara nga Avokatura e Shtetit dhe Ministrinë e Linjës/ institucionet buxhetore. Për pasojë, vlerësimet tona janë të sakta për aq sa informacion disponojmë. Tagrin për validimin e tyre e ka vetëm Avokatura e Shtetit*”.

- *Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave për totalin e detyrimit të mbetur/faktik dhe kontigjent për vendimet e Tribunalit të Arbitrazhit, sipas Raportit të Mesvitet të Buxhetit, ato evidentohen për 161,938,494 EURO, ndërsa më datën 31.12.2022 për 173,914,609 EURO, ose me një rritje prej 11.976.115 EURO.*
- *Në vlerësimin e grupit të auditimit të KLSH-së, në përlllogaritjen e kontigjencave nuk janë përfshirë interesat e pagueshme në vlera të konsiderueshme pas njohjes së*

*vendimit nga Gjykata e Apelit, por që rezultojnë të jenë pjesë e stokut të detyrimeve të papaguara në ngarkim të buxhetit të shtetit.*

*b. Nga auditimi u konstatua se, mes të dhënave të vendosura në dispozicion nga Avokatura e Shtetit dhe atyre të pasqyruara në raportin vjetor mbi zbatimin e buxhetit të shtetit, publikuar nga MFE për vitin 2022 rezultojnë **mospërputhje në totalin e vlerës së detyrimit faktik** më 31.12.2022 nga **vendimet e GJEDNJ-së** (për **30,950** EURO). *Më konkretisht:**

- **“Detyrimet faktike** nga vendimet e GJEDNJ-së (në EURO)” sipas ASH rezultojnë për **17,911,600 Euro**, ndërkohë në raportin e MFE-së (*raporti zbatimit të buxhetit të shtetit 2022, fq. 59*), janë evidentuar për **17,880,650 Euro**, me një diferencë prej **30,950 Euro**, (si rrjedhojë e mos pasqyrimin në raportin e MFE-së të dy vendimeve, konkretisht “P. k. Sh.” me vlerë 13,450 Euro dhe “S. k. Sh.” me vlerë 17,500 Euro, të cilat janë likuiduar më datën 26.1.2023 dhe nga MFE janë konsideruara të likuiduara gjatë v.2022).
- *Nga shqyrtimi dhe krahasimi i të dhënave për totalin e detyrimit të mbetur/faktik dhe kontigjent për vendimet e GJEDNJ, sipas Raportit të Mesvitet të Buxhetit të MFE, ato evidentohen për 21,796,565 EURO, ndërsa me 31.12.2022 për 21,717,665 EURO, ose me një pakësim prej vetëm 78.900 EURO.*

#### **12.1 Rekomandim:**

Nga ana e institucioneve përgjegjëse, Avokatura e Shtetit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë të merren masa për rakordim me saktësi të vlerave faktike të detyrimeve në mbyllje të çdo viti kalendarik përsa u takojnë vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar dhe GJEDNJ-së.

*Menjëherë*

## **KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT**



